



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë më 03.07.2018, ora 15:00

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi dhe votimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimi dhe realizmi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar" (*komision për dhënie mendimi*).

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhambulla, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Nora Malaj, Genc Pollo (zëvendësues) dhe deputetë të tjerë të grupit parlamentar të PD.

Mungojnë: Kejdi Mehmetaj, Shezai Rrokaj.

Të ftuar:

Valbona Shujaku – Zëvendësministre e Kulturës,

Edmond Ahmeti - drejtor në Drejtorinë e Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve, në Ministrinë e Kulturës,

Oltjon Muzaka – sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës,

Fatmir Hoxhaj – drejtor i Administrimit të Pronës në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave,

Stefan Koçollari – përgjegjës sektori në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

HAPET MBLEDHJA

Albana Vokshi – Mirëdita!

Meqenëse kuorumin e kemi, fillojmë mbledhjen e komisionit për diskutimin nen për nen të projektligjit “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar””.

Para se të kalojmë në diskutimin nen për nen, zoti sekretar, dje ju kërkuam një informacion në lidhje me projektin, studimin dhe analizën. Zonja zëvendësministre, meqenëse sekretari na e premtoi, iu drejtova dje.

Oltion Muzaka- Fillimisht ju kërkojmë ndjesë për ardhjen me vonesë, por nga angazhimet për mbledhjen e qeverisë me qeverinë e Malit të Zi, vetëm tani mundëm të vinim.

Në lidhje me kërkesën tuaj, në fakt, ne prisnim një kërkesë me shkrim se çfarë kërkonit, megjithatë, ne insistojmë te fakti se nuk është asgjë jotransparente, pra mund t’jua vëmë në dispozicion. Dua të theksoj se shprehja e interesit e kompanisë “Fusha” do të negociohet te kontrata bazë, e cila do të vijë sërish te ju. Megjithatë, ne jemi të gatshëm t’jua vëmë në dispozicion, por me sinjeritet po ju them se është faji im që nuk dija procedurat e Rregullores së Kuvendit, por prisnim shkresën zyrtare për këtë shprehje interesi.

Albana Vokshi – Atëherë, në momentin që një komision bën kërkesë, e cila është publike, ku janë edhe mediet, ministritë përgjigjen edhe pa shkresë zyrtare. Ka muaj që, në fakt, ne jua kemi kërkuar projektin. Unë këtë projekt e kam kërkuar prej disa muajsh, por në çdo shkresë më është thënë që nuk ka projekt.

Oltion Muzaka- Nuk ka projekt.

Albana Vokshi – A ka apo nuk ka projekt?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, a është projekt ai? Si e quani ju? Sepse duhet të kemi një terminologji të përbashkët.

Oltion Muzaka - Pa dyshim që do t’jua vëmë në dispozicion, sepse është një korrespondencë midis Bashkisë së Tiranës dhe Ministrisë së Kulturës.

Albana Vokshi – Unë e kam kërkuar që nga muaji mars. E kemi kërkuar në mënyrë të vazhdueshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, mos më ndërprisni fjalën.

E kemi kërkuar që në muajin mars dhe gjithmonë na është thënë që nuk ka, është një projekt që ka shkuar në bashki, por nuk e kemi. A është e mundur që unë të kem shprehjen e interesit të kompanisë “Fusha”? Kjo është kërkesë e komisionit për të pasur përpara çfarë ka propozuar kompania “Fusha”. Ne jemi të ndërgjegjshëm që do të ngrihet grupi i negocimit, i cili do të negociojë një kontratë në bazë të termave që ka paraqitur kompania “Fusha”. Parlamentit duhet t’i jepnit çdo informacion që ju kërkohet, çdo lloj informacioni; është me status deputeti dhe nuk ia mohoni dot.

Oltion Muzaka- Pa dyshim, do t’ju vihet në dispozicion.

Albana Vokshi - Duhej të ishte sot, sepse mbi bazën e tij do të bënim diskutimet tona.

Oltion Muzaka- Ishte keqkuptim nga ana ime, mendoja se duhej të vinte me shkresë zyrtare. Unë po e verifikoj nëse ju thoni se e keni kërkuar edhe në mars. Do të bëj verifikimet.

Albana Vokshi - E kam kërkuar në mars, e kam kërkuar në prill, e kam kërkuar në maj në mënyrë të vazhdueshme. Nuk keni se çfarë të verifikoni, sepse unë e kam kërkuar në mënyrë të vazhdueshme.

Dje thatë se do të na e sillni brenda ditës, tani mos më thoni mua që nuk e keni kuptuar! Ju kam thënë e dua sot dhe keni thënë që po sot do ta keni. Tani të zbardhim procesverbalin? Thuaj që nuk e solla dhe të mos merremi me procedura, sepse po i shkelni në mënyrë të vazhdueshme!

Vazhdojmë diskutimin nen për nen të këtij projektligji, duke theksuar edhe një herë që Partia Demokratike i mbetet qëndrimit që qeveria duhet ta tërheqë këtë projektligj, sepse shkel një pjesë të mirë të legjislacionit aktual, shkel edhe disa nene të Kushtetutës. Arsyeja që ne po vazhdojmë të rrimë në një mbledhje komisioni për të diskutuar nen për nen është bërja transparente e shkeljes sipas çdo neni të këtij projektligji të propozuar, të legjislacionit aktual të Kushtetutës, pra për t’u vërtetuar të gjithë qytetarëve shqiptarë mënyrat si po vidhni pronën publike në qendrën historikë të Tiranës.

Po, Romeo, për procedurë.

Romeo Gurakuqi - Faleminderit!

Unë dua të denoncoj shantazhimin që mbrëmë kryeministri i vendit i ka bërë sistemit parlamentar shqiptar, komisionit gjegjës, parlamentit të Shqipërisë në përgjithësi, me sjelljen e

tij arrogante dhe ultimative në zhvleftësimin e të gjitha diskutimeve që jemi duke bërë prej javësh, sidomos në ditët e fundit në lidhje me çështjen e teatrit.

Dua të tërheq vëmendjen tuaj, të nderuar deputetë të maxhorancës, se dhunimi i të drejtës së parlamentit, si organi sovran, dhe imponimi me urdhër ekzekutiv i të drejtave sovrane të këtij institucioni është një shkelje e parlamentarizmit dhe, mbi të gjitha, është një indikacion shumë i rëndësishëm për të kuptuar një prej arsyeve pse Shqipëria mori notë negative dhe nuk u fut fare në diskutim javën që shkoi në institucionet e Bashkimit Europian.

Gjithashtu, dua t'u tërheq vëmendjen, të paktën disa deputetëve, për të cilët unë kam konsideratë të veçantë, për shkak të përgjegjshmërisë që kanë treguar edhe në punimet e këtij komisioni, por edhe në komisionet e tjera, se po tentohet të përdoret përmes arrogancës dhe kërcënimit në komisionet e këtij parlamenti provincializmi puthadoras socialist i sjellë nga periferia, nga cepat e kooperativizmit komunist në kryeqendrën e sovranit, për të imponuar mbi qytetarinë e këtij qyteti të cilin e kanë themeluar etërit tanë, e kanë themeluar etërit shtetformues, ata që ndërtuan institucionet në vitet 20 -30 -40 dhe që gradualisht u shkatërrua dhe, madje, momentalisht jetojmë në fazën e tretë të shkatërrimit. Unë nuk mund ta konceptoj se si ky përdorim i provincializmit puthadoras politik i së majtës, përdoret për qëllime të një grupi të strukturuar, i cili ka objektiva antiqytetare, objektiva kundër ruajtjes së institucioneve kulturore dhe pjesës monumentale të Tiranës historike dhe, mbi të gjitha, tenton të zhdukë çdo kujtim të Tiranës, të institucioneve që u themeluan në këtë qytet, të shtetit në përgjithësi, duke filluar si gjithmonë sikurse janë mësuar nga data 17 nëntor e vitit 1944, me fillimin e viteve zero, sa herë ish-Partia e Punës e Shqipërisë vjen në pushtet.

Valentina Duka – Në fakt unë mendoj se është problem që nuk është media, sepse nuk e di çfarë diskutimi nën për nën mund të bëjmë pa praninë e medias. Nuk na intereson diskutimi nën për nën, kur ligjin nuk do ta miratojmë. Të marrim pjesë pa media në diskutimin nën për nën, do të thotë që t'i shërbejmë procesit.

Luçiano Boçi – Unë do të flas për procedurë. Duke vazhduar mendimin e Valit. Kam një propozim, meqenëse pak më parë e ndërpremë shqyrtimin nën për nën për shkak të nivelit të prezantimit të qeverisjes, kemi një arsye tjetër për ta ndërprerë dhe për ta shtyrë për ditën e nesërme, pasi një çështje me kaq interes publik, me të cilën kemi dy muaj që merremi, nuk mund të mos përcillet për interesin e publikut. Në fakt, këtu dikush mund të thotë që janë shërbimet e Kuvendit. Për mua janë urdhra politikë që funksionojnë më shumë se shërbimet e Kuvendit në këtë

seancë të diskutimit nën për nën të këtij projektligji, që grabit pronën publike. Atëherë, kërkesa ime është që ne nuk mund të bëjmë një trajtim të kësaj çështjeje me kaq interes, siç e tha edhe profesoresha, kur nuk kemi publikun. Publiku nuk është këtu, është tek ekrani, prandaj ky shqyrtim nuk mund të vazhdojë. Ky diskutim nën për nën është shumë i rëndësishëm. Ne kemi shprehur kundërshtitë tona në parim, por sigurisht do të shprehim kundërshtitë tona nën për nën. Ne jemi Komisioni i Medias, megjithëse, në fakt, kur zihemi, themi se jemi i kulturës, por si ka mundësi që të mos kemi median? Kjo nuk shkon! Nuk ka media, se urdhërohen, se pengohen, se nuk vijnë, atëherë edhe ne të marrim masë. Pse të mos publikohet, që ta dëgjojë dhe ta gjykojë publiku mbrojtjen tuaj dhe kundërshtimin tonë ndaj këtij projektligji? Ne nuk mund të vazhdojmë kështu, ne jemi mbledhur këtu si në ilegalitet. Ne nuk jemi ilegalë, jemi të votuar nga njerëzit. Ne kemi komunikim me njerëzit. Po ç'është kjo që thuhet? Do të mbahet një procesverbal, do të zbardhet dhe, në fund fare, e mbyllim mbledhjen dhe me kaq mbaroi! Kjo nuk shkon. Unë kërkoj ndërprerjen e këtij shqyrtimi, sepse situata është absurde!

Milva Ekonomi- Faleminderit me vëmendjen e shtuar për procedurën, për të qenë publiciteti i mbledhjeve! Sipas pikës 35 të Rregullores, mbledhjet janë të hapura dhe janë të thirrura edhe mediet, edhe grupet e interesit ose vizitorë të jashtëm të lejuar, gjë që ne e kemi bërë gjithmonë. Në këtë rast lajmërimet për medien, kur kemi mbledhje komisioni, në përgjithësi ia kemi lënë kryetares.

Albana Vokshi – Nuk i bëj unë, i bën sekretaria.

Milva Ekonomi- Atëherë i bën sekretaria e komisionit. Vendimin për të bërë mbledhjen në orën 14:30 e morëm bashkërisht për arsye se dy përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës i kishim në mbledhjen e qeverisë me qeverinë e Malit të Zi. Megjithatë, nëse ju nuk mendoni kështu, është shumë e qartë, ne mund ta hedhim në votim.

Luçiano Boçi- Nuk është çështje vote, është çështje dinjiteti të komisionit. Edhe një here, nuk mund të bëjmë mbledhje në ilegalitet. Nuk ka ndodhur në asnjë rast që në një mbledhje komisioni, pavarësisht sa e rëndësishme është tema e diskutimit, media të mos jetë prezent, kjo sipas eksperiencës sime. Media është transparencë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë e bëjnë shërbimet, nuk e bëj unë personalisht. Është rregull.

Atëherë, si e imponojmë ne median? E ndërpresim mbledhjen, kërkojmë praninë e tyre dhe vazhdojmë mbledhjen. Ne nuk do të bëjmë telefonata personale, se ka një rregull. Unë po them

se për dinjitetin e komisionit, nuk ka asnjë gjë të keqe, sepse duket sikur çdo gjë e kundërshtoj. Po bëhet një debat për një projektligj shumë të rëndësishëm, që ka dy muaj që diskutohet, është një çështje shumë publike, si mund ta bëjmë pa medie një gjë të tillë dhe pikërisht në shqyrtimin nen për nen?! Ne nuk duhet ta pranojmë një gjë të tillë. Unë po kërkoj bashkëpunimin tuaj. Nëse ju doni ta bëni ilegale, siç po propozoni me votë, po, bëjeni me votë.

Musa Ulqini - Unë kërkoj që të respektojmë Rregulloren. Ne nuk jemi komisioni përgjegjës, por, edhe po të ishim, Rregullorja e ka parashikuar qartë se kur fillon diskutimi nen për nen, që nuk ka lidhje me diskutimin në parim. Kjo nuk ka lidhje me atë që thoni se maxhoranca kërkon t'i presë fjalën minorancës. Në nenin 38, në pikën 5, thuhet se “në rast se komisioni përgjegjës miraton në parim projektligjin, ai fillon shqyrtimin dhe votimin nen për nen.”. Shqyrtimi dhe votimi nen për nen është një gjë që nuk ka lidhje me diskutimin në parim. Pra, të gjitha diskutimet, opsionet tuaja i keni shprehur qartësisht në diskutimin që ka zgjatur me orë të tëra. Por tani jemi në një fazë të dytë: diskutimi i këtij projektligji nen për nen, shqyrtimi dhe miratimi. Në asnjë pikë të Rregullores nuk thuhet që nuk mund të vazhdojë seanca, nëse nuk ka medie. Mediat janë të lira të jenë ose të mos jenë, RTSH-ja ka disa detyrime, por në rastin në fjalë nuk ka lidhje me atë që i përcakton ligji transmetuesit publik në nenin 108, pika 1, për transmetuesin publik. Nuk ka ndodhur dhe nuk ndodh asnjëherë, që një mbledhje komisioni, kur ka arritur në fazën e shqyrtimit dhe miratimit nen për nen, të mbahet peng. Unë i respektoj të gjitha argumentet që sjellin kolegët, është mendimi juaj, por është në kundërshtim me procedurën. Në qoftë se dikush këtu thotë për procedurën se është i vetmi mekanizëm që na bën të komunikojmë me njëri-tjetrin kur jemi në ekstreme, po ju them se nuk ka asnjë rast e nuk thuhet askund që duhet të pezullohet mbledhja, sepse media nuk është e pranishme. Ato e dinë, axhenda është bërë e njohur. Detyrimi ynë është që gjithçka që thuhet këtu të incizohet, të zbardhet dhe të publikohet në faqen *online* të Kuvendit, në mënyrë që të gjithë qytetarët, media, historianët, sot dhe nesër, të kenë mundësi të njihen me të gjitha gjërat e mençura që kemi thënë.

Ne jemi nëpër media nga mëngjesi deri në darkë çdo ditë. Ky është rregullimi që i ka bërë ligjvënësi me consensus, përmes kësaj Rregulloreje, mënyrës se si e merr informacionin publiku. Ky është detyrimi ynë. Unë po flas dhe gjithçka po regjistrohet. Nesër do të zbardhet dhe do të miratohet në mbledhjen pasardhëse. Ajo do të publikohet në faqen e Kuvendit *online* dhe më pas në botimet parlamentare.

Ndaj, ju lutem, të paktën në pikën ku kemi ardhur, të respektojmë atë çfarë në mënyrën më të qartë të mundshme ka zgjidhur kjo Rregullore, ndryshe, nëse nuk do ta respektojmë Rregulloren për këtë kërkesë, pastaj mund të jetë gjithçka, por vetëm procedurë parlamentare jo.

Jemi në momentin e shqyrtimit dhe votimit nen për nen të projektligjit. Kjo është një çështje tjetër, krahasuar me diskutimet në parim, ku secili ka të drejtën të flasë, edhe kur nuk është anëtar i komisionit. Kjo është procedura.

Do t'i kërkoj kryetarit, nënkryetares dhe sekretarit, që të paktën në këtë pikë të jemi korrektë dhe të respektojmë procedurën.

Faleminderit!

Albana Vokshi - Nuk besoj se nuk është respektuar ndonjëherë Rregullorja dhe procedura, të paktën në këtë komision. Edhe për sot do të zbatohen të dyja.

Nga informacionet që kemi, më rezulton se media nuk është njoftuar në kohë, kështu që kërkojmë të njoftohet media. Nga informacionet që na vijnë nga mediat, ata nuk e kanë marrë njoftimin, sepse ka qenë kohë e shkurtër etj., etj. Ato që kërkojnë kolegët, nuk po them se është faji i zyrës së shtypit, as faji i sekretares dhe i askujt. Meqenëse qeveria e konsideroi që komisioni parlamentar dhe parlamenti nuk qenkan aq të rëndësishëm, të mos sillnin zëvendësministrin, sekretarin e Përgjithshëm, përfaqësuesin e kabinetit, por të sillnin dy drejtorë, të cilët nuk kanë dhënë informacionet e duhura edhe kur i pyetëm më parë.

Pra, pa ia lënë fajin askujt, mendojmë se ky është një projektligj i rëndësishëm, i cili prek një temë shumë sensitive, në këndvështrimin tonë, të paktën. Unë nuk e ndaj pjesën e diskutimit në parim me pjesën e diskutimit nen për nen dhe në tërësi. E diskutuam në parim, thamë pjesën tonë, edhe nen për nen kemi shumë për të diskutuar, sepse aty qëndron edhe krimi që ne konsiderojmë se po bëjnë Edi Rama, Erion Veliaj dhe Mirela Kumbaro, sepse nen për nen ne kemi shumë për të folur.

Cilat nene, të cila ligjeve dhe Kushtetutës po shkelen? Si po e vidhni ju tokën publike për t'ia dhënë një privati, për të pastruar paratë e drogës? Ky është qëllimi ynë. Këto gjëra duam t'i bëjmë transparente, ndaj kemi kërkuar prezencën e medias. Mendoj se është një kërkesë legjitime e deputetëve të opozitës.

Milva Ekonomi – Ndërkohë, mediat janë njoftuar për të ardhur. Është detyrë e...

(Diskutim pa mikrofon.)

Albana Vokshi - Faleminderit!

Nuk e vë në dyshim , por me sa duket ka pasur pak kohë.

Ne kërkojmë që media të jetë prezent. Është kërkesë legjitime, pa shkelur asnjë procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vetëm po sigurohemi që të bëhet lajmërimi në mënyrën dhe kohën e duhur, Milva, sepse mendojmë se duhet bërë transparencë.

Po, Tritan.

Musa Ulqini - E doja fjalën për procedurë, kryetare.

Albana Vokshi - Po, pra, në fillim e ka fjalën Tritani, më pas merreni ju.

Të gjithë do ta merrni fjalën për procedurë.

Tritan Shehu – Faleminderit, kryetare!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja kryetare, të them të drejtën, ai që më çuditi më shumë sot ishte Musai. Musai kampion i medias, lindur e rritur me median, pranon terrin informativ, duke rënë në informalizëm të thellë. Për mua ky është absolutisht terr informativ dhe veçanërisht njerëz si ai, nuk duhej të pranonin, duhet të revolttoheshin dhe t'i thoshin stop këtij diskutimi. Duhej të mblidheshim herën tjetër, duke pasur median prezent, pasi opinionin publik dëshiron...

Milva Ekonomi – E hedhim në votim!

Tritan Shehu – Zonja nënkryetare, unë jap mendimin tim, pastaj ju votoni. Doja të shprehja qëndrimin tim për këtë çështje. Veçanërisht qëndrimi i Musait ishte shumë shqetësues, se si një njeri i medias bie në të tilla pozita formaliste.

Me ke çuditur sot, Musa!

Faleminderit!

Musa Ulqini - Përtej retorikës, për shkak të eksperiencës 25-vjeçare që kam këtu, e respektoj Rregulloren, pasi e kam si Bibël, edhe pse jam ateist.

Në nenin 38, në pikën 3, bëhet fjalë për diskutimin në parim dhe përdoret fjalia: “kryhet diskutimi në parim”. Në pikën 5 thuhet: “shqyrton dhe voton nen për nen”, pra, po të ishte fjala, zonja kryetare, që për çdo nen të bëhej e njëjta gjë si në diskutimin në parim, nuk do të ishte fjala “shqyrton”, por “diskuton”. Ndaj, ju bëj thirrje të respektojmë të vetmin instrument, ku jemi të detyruar të kemi të njëjtin mendim.

Ndërkohë, për diskutime të tjera që janë parapolitike për mua dhe që lidhen me emrin tim, refuzoj të komentoj. Kërkoj të respektohet kjo gjë!

Në mënyrë kategorike, për shkak se jam njeri i medias dhe i njoh parimet e saj, nuk mund të detyroj asnjë komision apo parlamentin, aq më tepër komisionin tonë, që e ka të shenjtë pavarësinë e medias, pra, të detyrojë median të vijë këtu dhe ta transmetojë patjetër, se përndryshe seanca nuk do të zhvillohet.

Parlamenti e ka sanksionuar se si e ka ndërtuar raportin me publikun dhe një nga instrumentet është edhe publikimi *online* në faqen e vet të të gjitha mençurive që themi ne këtu, sepse kemi 3 muaj që themi vetëm gjëra të mençura, të cilat nesër do të mahnisin edhe historianët.

Albana Vokshi - Sidomos me ato që thoni ju, zoti Ulqini, njerëzit do të mahniten!

Musa Ulqini - Po, sidomos me ato që kam thënë unë!

Më lejoni të them edhe një fjali!

Albana Vokshi - Sidomos me ato që keni thënë ju. Jua kam kursyer ankesën për gjuhën që keni përdorur ndaj kryetares së komisionit...

Musa Ulqini – Po ju kërkoj thjesht të respektojmë procedurën!

Albana Vokshi - E kam respektuar në çdo moment dhe në çdo germë procedurën dhe Rregulloren dhe do të vazhdoj ta bëj! Ajo çka nuk bëni ju në këtë komision, sepse ju keni thirrur mbledhjen në shkelje të procedurës dhe të Rregullores, ashtu sikurse Kryetari i Kuvendit në shkelje të çdo neni të kësaj Rregulloreje ka futur me procedurë të përshpejtuar këtë projektligj, që po diskutojmë sot, ashtu sikurse po shkelni shumë nene të Kushtetutës. Ju flisni për Rregulloren, por ndërkohë po shkelni Kushtetutën në sa e sa nene, po shkelni gjithë legjislacionin shqiptar me këtë projektligj dhe vjen e më thua: “Respekto një nen të kësaj Rregulloreje”, që do ta respektojmë patjetër. Unë e kam respektuar Rregulloren në çdo nen, por mos bëni më katolikë se Papa, sepse nuk jeni të tillë! Na e kurseni këtë! Ju lutem, Ungjillin që ti lexon sipas mënyrës tënde, lexoje, por mos na u hiqni më katolikë se Papa këtu në komision!

Luçiano Boçi - Mos na emociononi me këto virgjëritë e shenjtëritë ndaj Rregullores, sepse...

Musa Ulqini – Zonja kryetare, refuzoj të komentoj të gjitha gjërat që thoni për mua! Jemi në skaje ekstreme. Kam 25 vjet që kam dëgjuar gjëra më të tmerrshme se kaq, por po them vetëm një gjë: zonja kryetare, në respekt të institucionit që kryesoni, kërkoj të respektojmë saktësisht këtë gjë.

Luçiano Boçi - Prit, se do ta sqaroj edhe këtë gjë, por nuk e dëgjove pjesën e dytë! O Musa..

Musa Ulqini –Jeni të lirë të thoni çfarë të doni, unë nuk komentoj gjëra, të cilat...

Luçiano Boçi - Po emocionohesh ti me fjalët e tua, sepse unë thashë “mos na emociononi!”.

Ajo që kërkoja është shumë e thjeshtë: nuk e kërkoja dhe nuk iu referova Rregullores...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E di pse?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ku ka si ty! Ti je më i miri këtu, më i virgjëri, më i shenjtëruari! Ne të tjerët jemi të gjithë maskarenj!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë edhe unë po them fjalën time, se nuk iu drejtova qëllimisht Rregullores, por iu drejtova anës morale të funksionimit të komisionit. Sigurisht, ka një Rregullore, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

S’ka moral për ju, po!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A ka mundësi të flas, se po na habisni?!

Pra, iu drejtova dinjitetit të komisionit dhe shtriva dorën njerëzore të bashkëpunimit në bazë të procedurës, jo të letrave. Besoj se këto ligje janë ndonjëherë më të forta nga ato që janë shkruar aty. S’po marr konfliktin e famshëm midis ligjeve të pashkruara dhe të shkruara, se e dini shumë mirë që nga antikiteti se çfarë force kanë, pra moralit njerëzor. Në emër të dinjitetit nuk kam asnjë vërejtje as për pjesën e ministrisë dhe as për ju, por e kam për transparencën me komunikimin me publikun. Kërkoja praninë e medias, që është krejtësisht e domosdoshme për një çështje kaq sensitive.

(Diskutim pa mikrofon.)

Albana, o bëjmë muhabet, o vazhdojmë mbledhjen!

Bujar Çela - Të përfitojmë nga koha që na japin mediat!

A mund të flasim seriozisht si kolegë dhe të heqim dorë nga konferencat e shtypit, se keni kaq muaj që thoni të njëjtën gjë? Duhet ta kemi të qartë se kjo opozitë është dakord vetëm për shkatërrim. Këtu bëhet fjalë për ndërtim dhe nuk ka se si të jeni dakord. Koha e shkatërrimeve që keni bërë për 28 vjet ka marrë fund. Këtu bëhet fjalë për ndërtim dhe unë jam i sigurt që ju do ta duartrokisni këtë vepër të kësaj qeverie...

Albana Vokshi - Çfarë po flet, o burrë?! E kupton që do të shkatërrohet Teatri?! Çfarë është kjo?! Do të shkatërrohet Teatri, do të shkatërrohet historia! Çfarë ndërtimi po bëni?!

Bujar Çela - Nuk të marr dorën ty për çfarë flas! A ka mundësi të bëhesh kryetare e të gjithëve?

Albana Vokshi - Ju do të shkatërmoni historinë! Çfarë ndërtimi do të bëni? Ju të bëni të vësh duart në kokë!

Bujar Çela - Të lutem, zonja kryetare, se sot nuk të shkon fare ngjyra e zezë!

Albana Vokshi - Çfarë jeni ju?! A po shkatërmoni Teatrin? A i dëgjove të gjithë ata që të erdhën? Çfarë ndërtimi po bëni?

Bujar Çela - A ka mundësi të bëhesh vetëm për një moment kryetare e këtij komisioni, se deri tani je vetëm përfaqësuese e opozitës? A ka mundësi të dalësh në rolin e kryetares së komisionit?...

Albana Vokshi - Pse, çfarë roli kam bërë deri tani unë?

Bujar Çela - Deri tani je vetëm përfaqësuese e opozitës.

Albana Vokshi - Kështu ju duket juve?

Bujar Çela - Kemi ardhur në pikën fundore dhe mendoj se jemi bërë të bezdisur për njëri-tjetrin, jo më për konferencat e shtypit dhe mediat.

A ka mundësi ta votojmë dhe të ikim?

Albana Vokshi – Do të mbarojnë të gjithë ata që do ta marrin fjalën për procedurë, siç e morët edhe ju. Ata që e kërkojnë fjalën për procedurë, do ta marrin...

Bujar Çela - S'ka fare nevojë; unë po them fillo punën!

Albana Vokshi – Unë zbatoj Rregulloren!

Bujar Çela -Ju nuk e dini se si votoj unë!

Albana Vokshi – Nëse kjo nuk të duket punë, unë nuk di ç'të them!

Bujar Çela -Jo, pra, puna fillon kur fillojmë diskutimin nen për nen dhe shprehemi me votë pro, kundër apo abstenim. Kjo është punë!

Albana Vokshi – Jo, nuk është ashtu! E ke gabim!

Bujar Çela -Kjo është punë, të gjitha të tjerat janë “llogje Kavaje” dhe histori përrallash!

Albana Vokshi – E ke gabim, pra! Nëse e ke kuptuar kështu detyrën tënde si deputet, ne si opozitë nuk e kuptojmë kështu. Këtu kemi ardhur në mënyrë serioze për të diskutuar nen për nen, për të thënë se si po vidhni në qendër të Tiranës...

Bujar Çela -..në fund fare, është forca e logjikës, është forca e votës që bën progresin...

Albana Vokshi – Çfarë logjike keni ju? Shkelja e Kushtetutës është logjika juaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bujar Çela - Nuk bëhet fjalë fare, se ata që na kanë zgjedhur, na kanë besuar të qeverisim dhe ne do të respektojmë vetëm ata!

Albana Vokshi – Bravo! Kongresi i VII-të i PPSH-së!

Po, Klevis.

Klevis Balliu - Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Po rri tani, mos u fut në një debat që nuk të takon!

Vazhdo, Klevis!

(Diskutim pa mikrofon.)

Cili është mekanizmi? Rregulloren po zbatojmë edhe ne! Cili është neni i Rregullores që është shkelur deri tani?

(Diskutim pa mikrofon.)

Do rrish! A e doni për dy ditë ju? Pse nuk i dhatë kohën e mjaftueshme? E donit për dy ditë, atëherë do të rrini këtu edhe 24 orë, po të jetë e nevojshme! Nuk ju pëlqen, ikni! Ne do t'i shterojmë të gjitha diskutimet...

(Diskutim pa mikrofon)

Klevis Balliu - Sipas Rregullores e kam marrë fjalën për procedurë.

Nga fakti që nuk ka medie, shoh se edhe kolegët e maxhorancës po shqetësohen, përveç shqetësimeve të tjera që kanë ndaj kryetares së komisionit dhe kolegëve të opozitës, prandaj do t'ju ftoj të gjithëve të shkruani në portalin “Shqipëria që dua”, gjë që zgjat vetëm 3 minuta dhe për 10 ditë do të merrni përgjigje, prandaj ankohuni aty dhe ata do t'ju zgjidhin çdo lloj problemi dhe shqetësimi që ju keni.

(Diskutime pa mikrofon.)

A kishit ankesë, shkruani atje...

(Diskutime pa mikrofon.)

Romeo Gurakuqi – Unë kërkoj mirëkuptimin tuaj! Ju fola si koleg, si intelektual, ndërsa ju i lëshoni fjalët pa menduar...

Klevis Balliu – Doja të isha i qartë për kolegët e maxhorancës, po vë re se kemi njëfarë problemi me njëri-tjetrin, nuk e kuptojmë qartë se çfarë kërkojmë ne dhe çfarë kërkon ju. Partia Demokratike ka kërkuar që teatri të rehabilitohet dhe e vërteta është se nga ana e Ministrisë së Kulturës nuk kemi pasur ndonjë shifër ose ndonjë projekt se sa do të kushtojë rehabilitimi i teatrit, i cili mund të jetë më pak se 30 milionë eurot që qeveria nuk i ka, se i ka shpenzuar diku tjetër, nuk e dimë se ku, pasi nuk ka transparencë për atë pjesë, por mund të jetë edhe më lirë dhe ju mund të keni buxhet për ta rehabilituar teatrin, por nuk keni buxhet për të bërë kullat e këto të tjerat. E para.

E dyta, ne kërkojmë vetëm rehabilitimin e teatrit që të ruhet edhe historiku i tij dhe të mos bëhen kullat, sepse kemi mjaft kulla, sepse këtë e ka thënë edhe kryetari i bashkisë, zoti Veliaj. Zoti Veliaj ka thënë: “Në Shqipëri kemi rreth 16 mijë apartamente të pashituara”. Nuk e di nëse zoti Veliaj këto 16 mijë apartamente i ka shitur tani apo jo, sipas statistikave të tij, por kjo është deklarata e tij pasi u zgjodh kryetar bashkie dhe u shpreh se nuk do të ndërtoheshin kulla. Tani këtu po ndërtohen 10 kulla nga 10 kate minimalja....

Adelina Rista – Projektligji ka kaluar dhe ne jemi te shqyrtimi nën për nën...

Përse e keni marrë fjalën?

Klevis Balliu – Për procedurë.

Adelina Rista – Ajo ka kaluar tani...

Albana Vokshi – Adelina, të lutem, mos e ndërprisni deputetin, sepse edhe ju ankoheni kur ju ndërpresin!

Adelina Rista – Unë nuk ndërhyj asnjëherë...

Albana Vokshi – Po e ndërpreve pra...

Klevis Balliu – Ndërhyrje quhet edhe pa mikrofon...

Adelina Rista – Mos e vazhdoni diskutimin...

Klevis Balliu -A doni të vazhdoni ju? A i shprehët të gjitha shqetësimet?

(Diskutime pa mikrofon.)

Lëre ta mbarojë fjalën, nuk ka problem.

(Diskutime pa mikrofon.)

Unë nuk kam punë me mediet, por jam duke folur me ju. E kam kërkuar fjalën për procedurë, zotëri!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Prisni ta mbaroj unë fjalën time, sepse e kam kërkuar për procedurë!

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju nuk lini ta mbaroj fjalën, këtej flisni për Rregulloren dhe nuk e respektoni atë!

Albana Vokshi – Do ta vazhdoj fjalën, sepse jam unë ajo që e drejtoj mbledhjen.

Klevis, të lutem, mos repliko, por vazhdo fjalën aty ku e ke lënë!

Klevis Balliu - Unë kam konstatuar dhe e kam si shqetësim, meqë po e diskutojmë projektligjin nen për nen apo si të doni ju. Në çdo komision që kemi shkuar...

(Diskutime pa mikrofon)

Albana Vokshi – Kur të të vijë rradha, mund të flasësh sa të duash...

Klevis Balliu - Unë nuk do të flas njëkohësisht me zotërinë, të mbaroj ai njëherë.

Pra, për sa i përket çështjes së teatrit, kur kemi diskutuar, përgjithësisht për sa u takon debateve që kemi bërë, nuk është folur aq shumë për teatrin sa ç'është folur për një aferë korruptive. Ne kemi konstatuar që në çdo komision asnjë deputet, qoftë ai i opozitës apo maxhorancës, nuk ka dijeni dhe nuk janë informuar sa metra katrorë janë apo sa metra katrorë ka teatri aktualisht dhe sa do të ketë më vonë; nuk është bërë transparencë se sa lekë do të investojë kompania "Fusha", sa lekë do të merren nga buxheti, a do të merren lekë nga buxheti dhe për sa u takon metrave katrorë, po t'i pyes edhe kolegët që janë të pranishëm, nuk kanë dijeni. Pra, kjo do të thotë se ka një mungesë transparence...

(Diskutime pa mikrofon.)

Të lutem, ta mbaroj fjalën!

Kjo do të thotë se ne nuk jemi informuar. Atëherë si mund ta kalojmë një ligj për të cilin ju nuk jeni informuar, pavarësisht se unë e di se si po e kalojmë, pra po e kalojmë se çështja e teatrit, kjo nuk ju hyn fare ju në punë, teatri nuk ka lidhje fare, por kanë lidhje 6 kullat, të cilat bëhen dhe për to paguhet një shërbim që i bëri djali i xhaxhait i pronarit, Petrit Fusha, Erion Veliajt. Kjo nuk është rastësi, sepse nga 2 mijë kompani vetëm kjo doli aty, por ajo çka është më absurde është se fituesi është përcaktuar me ligj. Si u përcaktuaka fituesi me ligj? Ku jemi këtu ne? Kush jeni ju që e përcaktoni? Hapni një konkurs, të jem i singertë, këtë nuk e dija, por e mësova nga ju hapjen e konkurseve, sepse këtë gjë e bëtë me xhaminë dhe ishte një ide mjaft e mirë. Pse nuk e bëni edhe me punën e teatrit këtë gjë? Justifikimi i Ministrisë së Kulturës, të cilën e kuptoj dhe është mëse e vërtetë që ne kemi mjaft probleme sa u takon monumenteve të kulturës dhe me të vërtetë nuk mund të ketë shumë buxhet Ministria e Kulturës apo buxheti i shtetit, sepse disa fonde

janë vjedhur, i janë bërë 825 milionë euro dëm buxhetit të shtetit në vitin 2017, kështu që normalisht mund të mos keni 30 milionë euro për ta bërë teatrin. Si do ta mbani këtë teatër pasi ta bëni, në qoftë se nuk keni buxhet? Do ta bëni biletën 200, 300, 500, 1000 apo 2000 euro? Si do të mbahet teatri, se ju nuk keni buxhet? E para.

E dyta, Biblioteka Kombëtare është përmbytur, atëherë edhe për atë do të veprojmë njësoj, sepse po e bëjmë këtë, do të krijohet precedent, do të bëhet edhe një kullë te Biblioteka Kombëtare?

Pra, për këto arsye duhet të bëjmë kujdes me ligjet, sepse krijohet precedenti. Nesër mund të jeni ju prapë në qeveri, mund të jemi ne, mund të krijohet një parti që nuk ka qenë në qeveri, por po i krijuam precedent asaj që të bëjë një kullë atje, sepse mua nesër mund të më teket ta prish Kryeministrinë, sepse nuk ka fonde për ta mbajtur dhe të bëjë një kullë dhe ta mbaj Fusha. Kush është Fusha? Fusha është një pronar kompanie, biznesmen, i cili ka fituar 129 tendera, 90 milionë euro, mund të kishte bërë 3 teatro, por nuk i shkoi në mend, sepse nuk ishte problem teatri para 6 muajve, sot u bë problem.

Ky, teatrin ka që para 20 vjetësh që kërkon ta shkatërrojë, i është fiksuar, sepse njerëz që kanë probleme psikike fiksohen me një gjë dhe nuk i ndahen asaj. Ju, në qoftë se doni ta kaloni, në rregull. Ndoshta këto që jam duke ju thënë mund t'ju duken si budallallëqe, ashtu qofshin do Zoti, që ju nuk jeni duke bërë korrupsion dhe nuk doni ta shkatërroni teatrin, ishalla jam gabim. Por të jem i sinqertë, kur shoh një qeveri që cakton fituesin, kur shoh se si një qeveri shkatërron një teatër për të bërë një tjetër dhe ta bëjë me kullë se nuk paska lekë, shpresoj të jem gabim, por nuk besoj se jam...

Në dinjitetin tuaj, të partisë që ju përfaqësoni, të qytetarëve që ju kanë votuar do t'ju kërkoja të mos ta votoni këtë ligj, ta shihnit edhe një herë dhe të mblidhemi bashkërisht, dhe të mendojmë se çfarë mund të bëjmë me çështjen e teatrit.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Po, zonja Rista.

Adelina Rista – Faleminderit, zonja kryetare!

Sot është dita e dytë që kemi përpara projektligjin e qeverisë, duke kaluar sipas Rregullores të gjitha fazat e paraqitjes nga përfaqësuesit e qeverisë në komision: dëgjuesat, seancat e pyetje-përgjigjeve, një seancë mjaft e zgjatur që u zhvillua dje, ndërsa sot përsëri dëgjues me grupet e interesit, një seancë e ndërprerë për t'u vazhduar dhe për t'u paraqitur në komision ashtu siç e do Rregullorja, kur ligji kalon nën për nen nga përfaqësuesit e qeverisë. Tashmë të pranishme në

komision kemi zëvendësministren, të cilën e kërkuam të ishte prezent në seancën e paradites së bashku me përfaqësuesit e tjerë të qeverisë, kemi medien që na mungonte, e cila përsëri është prezent, prandaj mendoj të mos humbasim kohë dhe në bazë të Rregullores të fillojmë diskutimin nen për nen.

Shpresoj, zonja kryetare, që ju të mos e tejzgjasni më dhe ta bëni të bezdisshme seancën edhe për medien. Sinqerisht e them që edhe përfaqësuesit e medis janë mërzhitur me komisionin tonë, për shkak të kakofonisë, të debateve të tejzgjatura pa kuptim, pa bereqet, siç themi andej nga anët tona, prandaj ju ftoj që ju të reflektoni dhe të kaloni direkt në diskutimin e projektligjit nen për nen, sepse nuk kemi pse ta zgjasim më.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Ju, besnikëve të Rregullores, po ju them se ky projektligj ka hyrë në shkelje të Rregullores. Ju dhe ne bashkë, një projektligj që nuk ka asnjë nxitim, nuk ka pse ta kalojmë me procedurë të përshpejtuar, pasi arti dhe kultura në një vend kurrë nuk janë emergjencë. Pra, arsyeja që e keni sjellë me procedurë të përshpejtuar është se ju kërkonit të shmangni pikërisht këtë proces që ne po mundohemi ta bëjmë edhe me orë të tejzgjatura, dhe jam e sigurt që juve ju bezdisin këto mbledhje komisioni me orë të tejzgjatura, por ju siguroj që ne do të vazhdojmë për aq kohë sa të marrim edhe minimumin e informacionit. Kemi dy ditë që kërkojmë informacion dhe ministritë na e refuzojnë. Në mungesë të informacionit ne duhet të abstrajojmë nga ajo që po ndodh realisht, të gjithë ne e dimë, edhe ju e dini, por shtireni sikur nuk e dini se çfarë po ndodh.

Mua më vjen keq që ju bezdiseni, por ne do të vazhdojmë të diskutojmë nen për nen, të parashtrojmë të gjitha ato çështje dhe problematika që ne, si opozitë, i kemi shqetësim shumë të madh, do t'ua transmetojmë shqetësimin ju dhe publikut që po na ndjek apo do të na ndjekë, apo do t'i lexojë edhe procesverbalet, sikurse e tha edhe zoti Ulqini. Meqë ju zgjodhët procedurën e përshpejtuar, i keni menduar vetë që këto seanca t'i bëni brenda ditës. Tri seanca bëri dje ministria e Kulturës për shqyrtimin në parim të këtij projektligji dhe nuk iu përgjigj asnjë pyetjeje në asnjë komision. Unë nuk mora përgjigje për asnjë pyetje që i bëra dje ministres. Ministria shkoi në një komision, lexoi vetëm relacionin, pastaj shkoi te komisioni tjetër, pra shkoi si çingie nga një komision te tjetri, pa iu përgjigjur asnjë pyetjeje. A është kjo diçka serioze? Nëse ju nuk e keni seriozisht, sepse ju kanë urdhëruar të mbyllni sytë, të mbyllni veshët...

Fidel Ylli – Të lutem, zonja kryetare, kujdes me fjalorin, mos i thuaj çingie ministres, të lutem!

Bëni pjesën tuaj politike, por mos e fyeni ministren.

Albana Vokshi – Ajo që bëri dje ministrja, ishte krejtësisht karagjozllëk...

Fidel Ylli – Mos i thuaj çingie, se nuk e meriton ti thuash ministres së Kulturës një fjalë të tillë...

Albana Vokshi – Si çingie.

Fidel Ylli – Flisni siç është për të folur, se jeni kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Është turp...

Albana Vokshi – Po për çfarë arti flasim ne këtu?! As art dhe as kulturë! Hapni librat lexoni të paktën! Lexoni se çfarë është krahasimi, çfarë është metafora, çfarë është hiperbola...

Fidel Ylli – Dakord, mos bëni politikë, se e bëmë dje politikën! Kemi ardhur në momentin e shqyrtimit të projektligjit nen për nen...

Albana Vokshi - Lexoni pak se çfarë është absurdi...

Fidel Ylli - Këtu do të rrimë deri në 12 të natës dhe do ta kalojmë këtë projektligj. Nuk e bllokoni dot, harrojeni! Këtu do të na keni deri në 12 apo 1 të natës. Sipas Rregullores 2 ditë përpara do ta dërgojmë në parlament për votim...

Albana Vokshi – 48-orëshi ka kaluar...

Fidel Ylli – Nuk ka kaluar, se jemi në proces. Kemi që në mëngjes këtu, që merremi me këtë punë. Kërkuat medien, ja ku e keni; kërkuat zëvendësministren, ja ku e keni. Çfarë argumenti tjetër kërkon për ta penguar, se nuk po arrij ta kuptoj?

Albana Vokshi – Çfarë ke që nxelesh?

Fidel Ylli – Çfarë kërkon, që ta dimë?

Albana Vokshi – Çfarë ke që nxelesh?

Fidel Ylli – Nuk po nxehem fare, kam dy ditë pa folur fare dhe ju kam dëgjuar me vëmendje...

Albana Vokshi – Të lutem, mos ndërhy kur flas unë...

Fidel Ylli – Nuk mund t'i thuash ministres “çingie”, është e turpshme që një kryetare komisioni të përdorë një gjuhë të tillë. Nuk të lejohet as ty dhe asnjë deputeti të flasë...

Albana Vokshi – Ajo që unë thashë, ishte figurë letrare, por nëse ju nuk e kuptoni, po jua shpjegoj se çfarë do të thotë “si çingie”. Pra, ministrja shkoi nga një komision në një komision tjetër, lexoi relacionin, mori pyetjet dhe iku; erdhi te komisioni ynë, mori pyetjet dhe iku pa iu përgjigjur dhe tha “po ju lë stafin”; iku te komisioni tjetër, Shalsi e mbylli mbledhjen e komisionit

pa u dhënë të drejtë anëtarëve të opozitës të flisnin. Atëherë kjo është mënyra se si diskutohet një projektligj? Normalisht, një projektligj i tillë duhet të marrë 3-4 javë për t'u diskutuar ...

(Diskutime pa mikrofon.)

Mos i dilni për Zot sot, sepse jo në prokurori, por në burg do të shkojnë të gjithë ata që po bëjnë këtë krim...

Fidel Ylli – Nuk mund t'i thuash ministres çingie...

Albana Vokshi – Po rri, o Fidel, të lutem! Kryeministri juaj u ka thënë gjëra më të këqija dhe nuk keni reaguar as ti dhe as ajo! Kryeministri yt i ka thënë asaj dhe ju të tjerëve gjëra shumë herë më të këqija dhe ju nuk keni dalë për ta mbrojtur. Pse nuk e mbrojtët para Kryeministrit? Mbrojeni, pra...

(Diskutime pa mikrofon.)

Mos e bëj pra, lëre! Tregohuni seriozë...

(Diskutime pa mikrofon.)

A të ta shpjegoj edhe një herë? Në qoftë se dëshironi, i kthehem edhe një herë. Atëherë, ne dje nuk morëm asnjë informacion për këtë projektligj dhe sot, teksa jemi duke folur, nuk kemi asnjë informacion nga ministria, e cila duhet t'i sillte, sepse është ministria që e ka propozuar, nuk kemi asnjë projekt bashkëngjitur, nuk kemi asnjë studim bashkëngjitur, nuk kemi asnjë analizë bashkëngjitur. Ku është vlerësimi se sa kushton rikonstruksioni i Teatrit Kombëtar? Ku është analiza? Sa kushton rikonstruksioni? Ku e keni? Flasim njëherë për këtë, më pas vazhdojmë me të tjerat. Ku e keni studimin e kostove dhe benefitet prej tij?

Bujar Çela – Nuk e kuptoni që do të bëjmë një të ri?!

Albana Vokshi - Prandaj jemi këtu ne.

Ismet Beqiraj – Të lutem, zonja Albana, kërkoj fjalën për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja Albana, ju më thoni mua se e marr fjalën pa leje, por unë tani po të kërkoj leje për të marrë fjalën për procedurë.

Albana Vokshi - Ta dhashë fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi - A mund ta dëgjojmë zotin Ismet.

Ismet Beqiraj – Kolegë të nderuar, është gjëja më e lehtë të bëjmë zhurmuesin dhe t'i ndërhyjmë tjetrit kur merr fjalën. Ky është një zakon shqiptar, por jo i atyre që janë vërtet shqiptarë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju lutem, të mos hapim historitë e komunizmit tani!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, mos ndërhyini, sepse unë ju respektoj të gjithëve dhe nuk ju kam ndërhyrë ndonjëherë!

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi - Ju lutem, a mund ta dëgjojmë zotin Ismet?

Ismet Beqiraj – Zonja Albana, ne kemi marrë një vendim sot paradite...

Albana Vokshi - Po, e kemi marrë në shkelje të Rregullores.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Pra, ne morëm një vendim që në orën 14:30 minuta të fillojmë diskutimin nën për nen të projektligjit dhe shkak nxorëm mediet. Të gjithë u çuditëm pse nuk erdhën mediet në kohë, sepse punonjësja e shërbimit të Kuvendit tha se i kishte njoftuar disa herë. Unë nuk dua të paragjykoj asgjë, por, zonja kryetare, unë kam hije dyshimi se mosardhja e medieve në kohë është bërë e qëllimshme. Ne kemi 6-7 muaj...

Albana Vokshi - Këto janë teori konspirative.

Ismet Beqiraj – Ju si drejtuese e këtij komisioni nuk ju shpëton asgjë, jo më prezenca e medies!

Albana Vokshi - Pse unë e lajmëroj median?! Ti nuk i di procedurat, çfarë të mësoj unë ty!

Ismet Beqiraj – Do t'i mësoj procedurat, se ti je e vjetër këtu, të kanë dalë thinjat.

Albana Vokshi - Mësoji pra!

Ismet Beqiraj – Prandaj e bëtë lëmsh këtë punë ju. Unë do t'i mësoj procedurat ...

Albana Vokshi - Nuk i bëj unë procedurat.

Ismet Beqiraj - Të lutem, që të mos xhirojmë në boshllëk, por të futemi te diskutimi nën për nen, sepse diskutimi në parim është bërë. Pra, të futemi te diskutimi, duke analizuar çdo nen dhe kush të dojë le të bëjë edhe diskutime politike për nene përkatëse, që të mos zvarritemi më shumë. Nëse deri në orën 24:00 të natës do të mbetemi te diskutimi në parim, atëherë unë propozoj, sipas Rregullores, ta hedhim në votim projektligjin.

Albana Vokshi - Për çfarë votimi po flisni?! A e dini ju se çfarë thotë Rregullorja?

Ismet Beqiraj – Ju lutem, mos bëni deklaratë politike, por filloni me diskutimin nën për nen.

Albana Vokshi - Çfarë propozimi po bëni? Lexojeni njëherë Rregulloren!

Ismet Beqiraj – Ju lutem, mos më tregoni mua Rregulloren!

Albana Vokshi – Lexojeni Rregulloren, sepse po bëni një propozim pa sens.

Ismet Beqiraj – Ju lutem, filloni me diskutimin nën për nen!

Albana Vokshi – Unë do të filloj, kur ta mbarosh ti dhe çdo njeri tjetër fjalën. Kur të mbarojnë të gjithë fjalën për procedurë, atëherë do të fillojmë me diskutimin nën për nen. Në qoftë se ju të gjithë e merrni fjalën njëri pas tjetrit, atëherë çfarë të bëj unë?

A ka ndonjë tjetër që do të flasë për procedurë? Në rregull!

Atëherë, fillojmë me diskutimin nën për nen të projektligjit “Për caktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”.

Neni 1 “Objekti”. “Ky ligj ka për objekt përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, duke përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar”.

Kush ka komente apo diskutime? Po, zoti Boçi.

Luçiano Boçi – Në fakt, kam një pyetje për përfaqësuesit e ministrisë lidhur me këtë nen. Çfarë keni pasur në konsideratë kur keni përcaktuar në projektligj nocionin “zona e Teatrit Kombëtar”? Çfarë përcaktimi është ky, juridik, gjeografik apo ligjor? Për shembull, unë nuk jam nga Tirana dhe nuk e kuptoj se ku bie zona e Teatrit Kombëtar. Pra, nga cila terminologji jeni nisur për ta përcaktuar këtë gjë? Ky projektligj në qëllimin e tij nuk është i qartë, jo se nuk keni koordinatat e caktuara, por ju po kërkon të fshini pikërisht mënyrën e ndërhyrjes. Kjo është e paqartë dhe qëllimisht është bërë kështu. Cila është zona e Teatrit Kombëtar? A mund ta përcaktoni këtë gjë, sepse ne nuk kemi dijeni?

Oltjon Muzaka – Të neni 3, pika 4...

Luçiano Boçi – Jo te neni 3, por te neni 1.

Oltjon Muzaka – Po ju jap përgjigje.

Në nenin 3, pika 4, thuhet: “Projekti, ndërtimi i godinës së re të Teatrit Kombëtar dhe zhvillimi i zonës ndërmjet rrugëve “Abdi Toptani” dhe “Murat Toptani”, sipas propozimit të paraqitur nga partneri privat”.

Albana Vokshi – Pra, aty përcaktohet në çfarëdolloj fushe.

Luçiano Boçi – Lexojeni edhe një herë nenin 3, sepse mua më del pa pika, kurse ty të dilka me pika.

(Diskutime pa mikrofon.)

Edhe njëherë si i referohet?

Milva Ekonomi – Pra, zona e Teatrit është zona ndërmjet rrugëve “Abdi Toptani” dhe “Murat Toptani”.

Albana Vokshi – Sipas projektit të përcaktuar nga privati.

Luçiano Boçi – Pra, edhe njëherë: këtë përcaktim e bën privati apo studimi i zonës nga Bashkia e Tiranës? Unë po të ndihmoj, sepse përcaktimin e territorit duhet ta përdorësh sipas studimit zonal të Bashkisë së Tiranës.

Oltjon Muzaka – Përgjigjja ime ishte për nenin 3, pika 4, se cila është zona përreth Teatrit Kombëtar.

Albana Vokshi – Na e përcakto: cila është zona?

Oltjon Muzaka – Unë jua dhashë përgjigjen.

Albana Vokshi – Na e lexoni edhe një herë pikën 4.

Oltjon Muzaka – Është te neni 3 “Përkufizime”.

Albana Vokshi – Po lexoj pikën 4 të nenit 3: “Projekti, ndërtimi i godinës së re të Teatrit Kombëtar dhe zhvillimi i zonës ndërmjet rrugëve “Abdi Toptani” dhe “Murat Toptani”, sipas propozimit të paraqitur nga partneri privat”.

Pra, ma përcakto pak se cili është propozimi, sepse në ligj është krejtësisht gabim dhe nuk vendoset kështu.

Oltjon Muzaka – Po ta lexojmë të gjithë ligjin, komisioni i negocimit do të shqyrtojë projektin final, i cili do të vijë sërish këtu, megjithatë zona është e përcaktuar shumë qartë: ndërmjet rrugëve “Abdi Toptani” dhe “Murat Toptani”.

Milva Ekonomi – Replika që bëhet është se kjo zonë, që ti ke definuar këtu për Teatrin, a është konform zonës që ka përcaktuar bashkia? Kjo është pyetja që po ju bëhet.

Oltjon Muzaka – Po.

(Diskutime pa mikrofon.)

Luçiano Boçi - Edhe te neni 2 është po e njëjta gjë. Këtu jemi në Komisionin e Medies dhe i referohemi terminologjisë ligjore, kurse kur flitet me terminologji logjike, flitet me saktësi.

Ne po flasim për qendrën historike të Tiranës dhe për zonën e mbrojtur. Që në fillim të këtij projektligji duhej të thuhej se ndërtimi do të bëhet në zonën e mbrojtur, sepse këtu lindin detyrimet e firmës, të projektit, të respektimit të lartësive, të respektimit të parametrave e të tjerë, dhe se zona e mbrojtur është vazhdim i qendrës historike. Pra, projektligji nuk mund të nisë në këtë lloj forme, sepse është kakofoni e zgjedhur me qëllim për të krijuar pikërisht këtë mjegullën dhe, më pas, për t'i dhënë firmës të drejtën që në projektin e saj të bëjë çfarë të dojë. Në nenin 1 duhej të shënohej se kjo është zonë e mbrojtur, sepse realisht është zonë e mbrojtur, nuk mund ta shmangni dot ju dhe është në përputhje me ligjin e trashëgimisë kulturore. Pra, kjo duhet shënuar në mënyrë absolute, sepse pas kësaj lindin detyrimet.

Në nenin 2 ju bëni më shumë gabim kur thoni "zhvillim urban", sepse zona në fjalë nuk është zonë urbane. Zona tjetër, përtej zonës së mbrojtur, është zonë urbane, prandaj ky ligj bie. Mos na sillni paçavure të tilla në komision, sepse ne jemi komisioni që përgjigjemi për këtë gjë. Pra, që në fillim ky ligj nuk qëndron, sepse qëllimi i tij është diabolik dhe besoj se edhe ju jeni pjesë e diabolizmit. Sigurisht, ju jeni pjesë e administratës dhe mund t'ju përdorin, por nuk mund të vini këtu, para këtij komisioni, duke përdorur terminologji antiligjore. Teatri ndodhet në zonën e mbrojtur të Tiranës dhe kjo nuk shmanget dot, ndaj duhet patjetër ta saktësoni, sepse këto dy nene sjellin rrjedhimisht edhe nenet e tjera. Nuk mund të ketë liri firma projektuese që të bëjë 15 kate, sepse nuk i bën dot, pasi ligji e përcakton që në zonën e mbrojtur mund të bëhet një ndërtim i ri, por nuk mund të shkatërrohet asgjë. Pra, vetëm mund të restaurohet dhe kjo është në VKM-në nr. 325, që e keni miratuar ju. Kështu që këtu jepni sqarime shumë të sakta dhe bëni një ligj, që t'i ngjajë vërtet qëllimit tuaj, por duhet t'i ngjajë edhe kuadrit ligjor, që të paktën justifikimin ta keni të bukur, sepse këtu po sillni ligje shumë të trasha.

Këtu është thënë: "Do t'ju dënojë historia", por është pak të thuhet kështu, sepse të gjithë ju do të mbani përgjegjësi ligjore për këtë çështje, sepse nuk mund të kalohet kaq thjeshtë dhe ju e dini shumë mirë. Nuk mund të vini me të tilla përcaktime ligjore që i shmangen terminologjisë kryesore.

Edmond Ahmeti - Zoti Boçi, në lidhje me pyetjen tuaj, dua të them se parashikimi ligjor në titullin e projektligjit në nenet 1 dhe 2, që kanë të bëjnë me qëllimin dhe objektin, jo detyrimisht cenojnë apo bien ndesh me parashikimet e ligjit "Për trashëgiminë kulturore". Ne nuk themi se e përkufizojmë zonën historike të Tiranës apo koncepte të tjera që janë të rregulluara me ligje të tjera, sikundër ju pretenduat me ligjin "Për trashëgiminë kulturore", si dhe aktet nënligjore që i

rregullojnë ato. Për sa u përket zonave historike, nuk do të thotë se ne këtu respektojmë vetëm këtë ligj, pra ne nuk i cenojmë ligjet e tjera. Ky ligj parashikon një propozim që ka ardhur për të filluar një negociatë, sepse kufijtë janë të përcaktuara.

Albana Vokshi – Cilët janë kufijtë? Cila është kjo zonë, që ju pranoni të bëhet zhvillimi urban, sepse duhet t'i referohesh, në mënyrë që të jetë pjesë e ligjit edhe kjo, apo jo? Pra, duhet të jetë bashkëngjitur ...

Luçiano Boçi – Po, sepse është e domosdoshme.

Nora Malaj – Se si mbështetet dhe se si realizohet ligji i trashëgimisë kulturore ne e kaluam në mbështetje të zhvillimit të kësaj zone, duke u përcaktuar qartësisht dhe ligjërisht te nenet 1 dhe 2, të cilat përcaktojnë rrjedhojën e kësaj gjëje.

Albana Vokshi – Që u përket referencave ligjore.

Nora Malaj – Pra, ligjet në vetvete përputhen dhe kombinohen me njëri –tjetrin për t'u respektuar në referencën ligjore. Nëse flasim për një zonë të mbrojtur apo për trashëgimi kulturore, ka tjetër interpretim në raport me zhvillimin e zonës urbane. Prandaj, ne që duam art, duam të dimë se ku janë dhe si janë referencat që ta qartësojmë këtë punë.

Oltjon Muzaka - Interesi i Ministrisë së Kulturës është shprehur qartë te neni 4, paragrafi 2, ku thuhet: “Sipërfaqja që përbën pronën e Teatrit Kombëtar do të jetë po ajo edhe pas përfundimit të ndërtimit të Teatrit të ri Kombëtar.”

Albana Vokshi – A do të përgjigjeni seriozisht, apo jo? Për çfarë keni ardhur këtu? Ne po flasim për zonën e Teatrit Kombëtar dhe për të gjithë projektligjin , kurse ju po i referoheni...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E keni të përcaktuar te neni 3, pika 4: “Sipas propozimit të paraqitur nga partneri privat.” Ku e keni propozimin që do t'ia vendosni ligjit?

Milva Ekonomi - A mund ta marr fjalën për procedurë ?

Albana Vokshi – Duroni, zonja Milva, sa të mbaroj unë fjalën dhe më pas merreni ju.

Pra, ku e keni propozimin, sepse të bësh një ligj duhet të kesh një hartë të saktë bashkëngjitur, duhet të kesh projektin bashkëngjitur me projektligjin të cilit po i referoheni.

Milva Ekonomi - A mund ta marr fjalën për procedurë?

Albana Vokshi – Po.

Milva Ekonomi - Ne duhet të kemi një gjë të qartë: këtu jemi duke diskutuar një projektligj, i cili merr në shqyrtim një projektpropozim të ardhur nga një investitor privat.

Albana Vokshi – Ku është pra?

Milva Ekonomi - Ja, se do t’jua them unë. Ky projektpropozim është ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Bashkisë së Tiranës, është një dokument voluminoz që e kanë të dyja këto ente publike, ndërkohë që në projektpropozim nuk thuhet se ky projekt do të bëhet. Në projektpropozim thuhet se janë në lojë disa institucione dhe secili institucion ka interesin e tij. Në këtë propozim investimi që ka ardhur, Bashkia e Tiranës ka nevojë për zyra, Ministria e Kulturës ka nevojë për një Teatër, Ministria e Financave ka nevojë për taksa, Ministria e Infrastrukturës ka nevojë për rregullim urban. Pra, të gjitha këto institucione kanë nevojë të rikonceptohen së bashku, nëpërmjet ngritjes së një komisioni, që është ky projektligj, dhe nuk bëhen në kundërshtim as me Rregulloren, as me Kushtetutën. Kryetari i Këshillit të Ministrave, sipas nenit 83 të Kushtetutës, ka të drejtë të sjellë një projektligj të përshpejtuar, i cili duhet marrë në konsideratë nga Kuvendi dhe Kuvendi e merr në konsideratë sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni të Kushtetutës.

Ne këtu po diskutojmë që ky komision të negociojë pikërisht këtë projektpropozim. Kjo nuk do të thotë se projektpropozimi që ka ardhur do të jetë projekti i zbatimit. Në këtë komision do të vijë edhe një herë një kontratë dhe një projekt propozim, për të kaluar ose jo në Kuvendin e Shqipërisë. Pra, duhet pasur parasysh se si po veprohet me procedurën. Kemi një privat që ka sjellë një projektpropozim dhe do të ngrihet një komision për ta parë nëse është i mirë apo i keq. Po kështu, ka qenë edhe me projektin e Pacollit për Divjakën: projektpropozimi erdhi në Kuvend, nuk ishte i mirë dhe nuk u mor në konsideratë. Në Shqipëri histori të tilla ka plot. Kjo është një histori e këtij lloji, ka ardhur një projektpropozim, po ngrihet një komision...

Albana Vokshi – Ku janë plot?

Milva Ekonomi – Kemi “*China Construction*”, kemi Divjakën...

Albana Vokshi – Keni 3 modele të dështuara, që u jeni referuar për të bërë të katërtin. Ju thoni Karpeni, por ai është korruptiv dhe i dështuar; ju thoni aeroporti i Vlorës, që nuk e di se ku...

Milva Ekonomi – Nuk të ka ardhur akoma.

Albana Vokshi – Po ju i referoheni!

Milva Ekonomi – Nuk është fare, as në procesverbal dhe as në korrelacionin e ligjit. Kjo është ajo që ne duhet të kuptojmë dhe të mos e kërkojmë tani projektin, sepse nuk ka një projekt final.

Albana Vokshi – Fjalën e ka Nora.

Nora Malaj – Nuk kemi punë me procedura dhe as me historira të tipit “tralala zura një gale”.

Kemi kapur historinë e Teatrit, që është pjesa e dukshme e ajsbergut. Në fakt, ky është një ligj shumë komplementar, të dashur kolegë, që vjen nga ministria juaj, ndërkohë që nuk duhet të ishte në kompetencë të ministrisë tuaj, nëse flasim për këtë ligj, dhe vjen këtu me porosi nga Këshilli i Ministrave, me zëvendëskryeministren. Pra, që këtu shikohet tendenca e sjelljes së ligjit, i cili ka probleme të jashtëzakonshme.

Vjen modeli i parë, se nuk kemi modele të tjera, sepse të gjitha modelet kanë qenë të dështuara dhe kapemi te historia e teatrit, që, në fakt, është shumë e rëndë. Le t’i themi disa gjëra të vërteta përpara të gjithëve, sepse ajo që më shqetëson më shumë është fyerja në inteligjencë e të gjithëve këtu, që na shesin një gjë sikur kjo është e mrekullueshme. Është një provë që po bëhet për interesa që nuk e di se ku dhe si flenë. Ky lloj modeli duhet të shkojë në Gjykatë Kushtetuese, po qe nevoja edhe në Strasburg, sepse është histori me pronë publike dhe unë në ndërgjegjen time nuk dua të marr përsipër një krim, sepse ky është me të vërtetë një krim. Po diskutojmë dhe po themi se ku është kjo apo ajo, por ne nga institucioni i Ministrisë së Kulturës, që nga fillimi dhe deri në fund, nuk kemi marrë asnjë dokument të qartë, të saktë, transparent dhe të vërtetë. Bëjeni transparente dhe thoni: po, o njerëz të nderuar, ne do ta prishim këtë, sepse nuk është funksionale dhe do të ndërtojmë një gjë shumë të bukur, do t’i japim përfitime edhe privatit, sepse është shqiptar, kësaj gjëje dhe kësaj tjetre. Pra, le të jetë një herë qeveria transparente dhe e vërtetë. Ne kemi hyrë në një qerthull dhe themi si, qysh dhe tek, sepse të gjitha gjërat e shkruara janë me pikëpyetje, që nga neni i parë deri tek i fundit. Atëherë, si mund të themi që gjërat mund të funksionojnë?

Luçiano Boçi – Në lidhje me nenin 1, meqenëse lidhet me nenin 2, përcaktimi ligjor, aq më tepër që ju e mbroni përcaktimin ligjor, duhet të niset me termat e ligjit të trashëgimisë kulturore dhe nuk mund të jepet si justifikim që ai i referohet, por në ndonjë rast nuk i referohet. Ky është ligji bazë për objektet e trashëgimisë kulturore, jemi në zonën që i përket trashëgimisë kulturore, dhe referenca e ligjit, në territorin ku do të ndërtohet, duhet të jetë e saktë brenda ligjit, sepse nuk po e ndërtojmë teatrin e ri në Kashar, por në zonën e mbrojtur historike të Tiranës. Kjo zonë ka specifika zhvillimore dhe ka kufizime të përcaktuara, që janë kufizime që përcillen nga projekti që është virtual, sepse ne nuk e kemi, por e keni ju në kokat tuaja. Nuk e di a e keni parë apo jo? Ne po diskutojmë për një projekt virtual, që do të vijë të negociohet, sepse është voluminoz

dhe bashkia e gjuan si top futbollit te Ministria e Kulturës dhe ministria ia gjuan Kryeministrit dhe ne rrimë e shohim projektin pa pasur në dorë. Ne po vendosim, se qeveria na e ka hedhur topin në parlament dhe vetë nuk mban asnjë përgjegjësi, sepse firmosin zëvendësministrat, këtë e tha edhe Nora, edhe Tabaku, dhe ecim me terma qorrë. Kjo punë e qorrizmit të këtij ligji është për qëllime të caktuara dhe këtë e dimë, por ju, si Ministri Kulturë, përse nuk i pasqyroni të sakta termat e referencave?

Zoti Shalsi, të lutem mos më ndërprit. Kjo ishte edhe pyetja e parë.

Pyetja tjetër, Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit të Shqipërisë ka një kushtëzim ligjor taksativ, zoti sekretar, ku thuhet: “Të gjitha kontratat publike realizohen me konkurrim dhe duhet të sigurohet transparenca dhe ndershmëria”, pra asnjë kontratë nuk mund të bëhet me negociim, kjo është pikë që Shqipëria e ka firmosur në këtë marrëveshje. A jeni në dijeni ju dhe sa e keni pasqyruar këtë në projektligj?

Oltjon Muzaka – Sikurse e kemi pasqyruar edhe te korrespondencat e tjera, nuk është i vetmi projektligj ku negociohet me një kontratë ose me një operator drejtpërsëdrejti. Mund t’ju citoj ligjin nr. 41/2015 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë, për negociimin dhe lidhjen e kontratës koncesionare me objekt ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Rrugës së Arbrit” apo...

Albana Vokshi – Cila është? Me kë? Po ku i ke kinezët?

Oltjon Muzaka – Po e citoj: “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës ndërmjet shtetit shqiptar dhe kompanisë “**Start Great Report Development Limited**”, me objekt projektimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen...” e kështu me radhë. Pra, ligji nr. 4/2018

Albana Vokshi – Çfarë reference është? A e kuptoni se çfarë po flisni, sepse e keni të dështuar?!

Luçiano Boçi – Edhe një herë tjetër po ju pyes për një kontratë...

Oltjon Muzaka – A mund të shkoj te komisioni tjetër dhe të lë drejtorin e koncesioneve së bashku me zëvendësministrin si përfaqësues politik?

Albana Vokshi – Kush është përfaqësues politik?

Oltjon Muzaka – Meqenëse kërkuat përfaqësues politik, po ju lë zëvendësministren dhe drejtorin e koncesioneve, i cili është marrë me ligjin, sikurse edhe ne, me propozimin e Ministrisë së Financave.

Ablana Vokshi – A jeni dakord?

Luciano Boçi – Një minutë, ta bëj edhe një herë pyetjen, zotit sekretar. Në relacion ju përcaktoni që ky ligj nuk është në përputhje me ligjin “Për partneritetin publik privat”, prandaj duhej një ligj i ri. Këtë e keni thënë në relacion, po si mundeni që këtë kundërgument të shkruar të ma jepni mua si argument?

Oltjon Muzaka – Pyetja juaj ishte se si mund të negociohet me një operator dhe unë ju citova.

Luçiano Boçi – Jo nuk është operator, por është kontratë publike. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit e detyron Shqipërinë që të gjitha kontratat publike t’i bëjë me konkurrim dhe në mënyrë të ndershme, kjo është e përcaktuar, dhe jo me vendosje gishti. Ndërsa ti më thua: kontratë me partneritet public. Jo, nuk është kjo! Kjo është një marrëveshje dhe një projektligj i veçantë. Ato pjesërisht i ngjajnë, por nuk është e njëjta gjë. Ju e kundërshtoni dhe e thoni këtë në relacion.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë dua përgjigjen e pyetjes që të bëra dhe jo përgjigjen që ke në kokë, sepse problemi është te përgjigjja jote dhe jo te pyetja ime.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ju lutem, mbani qetësi. Fjala për ju, zoti Fadil.

Fadil Nasufi – Në lidhje me nenin 1, që t’i qëndrojmë korrekt dhe teknikës ligjore dhe qëllimit të projektligjit, në fjalinë ku thuhet: “Lidhja e kontratës me objekt realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar”, unë mendoj që të shtohen fjalët “që përfshihet në zonën kadastrale x dhe y-pilon (në zonën kadastrale përkatëse) dhe në studimin pjesor të planit të përgjithshëm vendor të Tiranës”. Këto janë koncepte urbanistike dhe ky ligj këtë koncept ka, sepse bëhet fjalë për ndërtim. Kjo mund të shtohet, sepse nuk ka as orientim gjeografik, as trashëgimie dhe as komente të tjera që u bënë. Këto janë të domosdoshme për t’u përfshirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Është e vërtetë që zona kadastrale ka kuotë, por shqetësimi i Norës dhe yni është se herën e fundit që ministria ka qenë në këtë komision, kur e kemi pyetur për zonën ku ndodhet Teatri Kombëtar, ka thënë: “Teatri është hequr nga monument kulture, por është në zonën e mbrojtur”. Këtë ka cituar.

Nora Malaj – Dhe zona e mbrojtur e ka të përcaktuar mënyrën se si do të menaxhohet, atëherë ta përcaktojmë që tani bashkë, ne jemi shumë dakord, nëse është zonë e mbrojtur, të përcaktohen të gjitha detyrimet që ka zona e mbrojtur, në referencë të ligjit që diskutuam këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Edhe të ligjit “Për mbrojtjen e monumenteve të kulturës”.

Nora Malaj – Ligji “Për urbanistikën dhe zhvillimin pjesor” interferohet me ligjin “Për zhvillimin e trashëgimisë kulturore”, duke i përcaktuar, sepse në të kundërt nuk funksionojnë. Është shumë e rëndësishme të citohet, sepse mbi bazën e kësaj do të gjykohet edhe kontrata se si do të realizohet, do të vazhdohet edhe ideja tjetër, e cila nuk thuhet, e ndërtimeve të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Valentina Duka – Nenet 1 dhe 2 janë objekti me qëllimin, të cilët kundërshtojnë njeri-tjetrin, se, po të shikosh qëllimin, nuk përcaktohet zona, por thuhet: “Për zhvillim të një zone urbane të Tiranës”. Eja ta marrësh vesh se ku është kjo zonë, është në Babrru apo në qendër! Këto janë dy nenet më të përçartura të ligjit, por, në fakt, janë tharmi i ligjit. Nëse ne do t’i pranojmë këto nene siç janë, atëherë ne si opozitë kot që marrim pjesë në këtë diskutim, sepse pjesa tjetër është në shërbim të këtyre dy neneve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Duke përcaktuar se është zonë e mbrojtur, e thamë mendimin tonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fjalën e ka zoti Baçi.

Luan Baçi – Po diskutojmë projektligjin nen për nen. Në fakt zoti Ismet bëri një propozim shumë të mençur, që të shtojmë diçka për nenet 1 dhe 2 për ta rregulluar, që të ecim më tej me nenet e tjera, por kjo i bie që ne të bëhemi palë me ju dhe unë nuk jam fare dakord, madje unë nuk isha dakord që të merrnim pjesë në këtë komision dhe ta diskutonim nen për nen. Me vjen keq, zonja kryetare, dhe ju kërkoj ndjesë, por qëndrimi ynë si opozitë më duket pak pardoksal, sepse që në fillim jemi kundër këtij ligji. Gjatë gjithë muajit kemi sjellë të gjitha faktet, si ardhjen e ligjit me procedurë e përshpejtuar, si ligj i kontestuar dhe për shembjen e teatrit, javë për javë dhe faktet janë kokëfortë, vijmë tani dhe diskutojmë nen për nen, ku në fakt nuk kemi se çfarë të diskutojmë, sepse ne e kemi diskutuar një herë dhe kemi sjellë argumentet bindëse, kemi bërë dëgjesa me artistë, me grupe interesi, me sindikatat dhe me qytetarë, kemi mbledhur firma dhe kemi bërë peticione, pra i kemi kaluar të gjitha shkallët.

Maxhoranca është e vendosur në punën e vet dhe do ta çojë deri në fund për ta realizuar. Singerisht, jam shumë dakord me kolegët e maxhorancës, kur thonë: të mbarojmë punë shpejt që të ikim, sepse ne e kemi mbyllur këtë punë. Diskutimet tona vlejné, në një farë mënyre, që publiku të dëgjojë këtë që po gatuhet në këto tavolina dhe tryeza, por nuk ia vlen të biem pre e ndonjë provokimi të lezetshëm siç bëri edhe zoti Beqiraj, që thotë që ne të japim ndonjë mendim për ndonjë nen që të futemi dhe të bëhemi pjesë.

Ismet Beqiraj – Luan, unë bëj provokim dhe ti e ha provokimin tim? Më vjen keq që përdor këtë gjuhë dhe këtë intimidim në këtë komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është shaka e radhës kjo që po bën?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Fidel, nëse nuk ju pëlqen, atëherë mund të ikësh.

Fidel Ylli – Unë nuk iki, jam këtu deri në 12 të natës. Mediet ja ku i keni, ejani dhe ta votojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – E kanë hequr nga ky komision në shkelje të Rregullores, sepse nuk donin që të kalonte nga ky komision dhe thanë: ta heqim dhe ta çojmë te Shalsi, sepse atje e bëjmë siç e duam ne. Në këtë komision nuk mund të bëni siç e doni ju, prandaj e hoqët që të mos bëhej ky debat.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shalsi e mbylli dje.

Fidel Ylli – Nuk e lëshon ti mikrofonin. Penalltinë do ta gjuaj unë, sepse topi është imi, kështu thua ti.

Albana Vokshi – Shko gjuaje penalltinë te stadiumi që të ka bërë Kryeministri.

Fidel Ylli – Nuk ka rregulla loje për ty, ti je kryetare, ti fyen komisionin dhe ti na thërret kur të duash. Jemi bërë si ushtarët tuaj.

Ne jemi të barabartë, zonja Albana. Unë të respektoj si kryetare, por jo deri në këtë pikë.

Albana Vokshi – E ka Rregullorja.

Fidel Ylli – Nuk mund të bësh si të duash me ne, të na mbledhësh kur do ti, se kemi edhe detyrime të tjera.

Teatri do të bëhet dhe të jeni të sigurt për këtë...

Albana Vokshi – Bravo të qoftë!

Fidel Ylli – ...por qeveria duhet të jetë transparente. Të na thotë: “Ka 5000 metra tokë, 2000 metra në ndërtim, sa do të fitojë...”

Albana Vokshi – Ju do të mbeteni në histori për këtë që po i bëni Tiranës.

Fidel Ylli – Këto ka ky komision.

S’kemi pse të fshihemi. Unë e kam thënë që ditën e parë që jam pro ndërtimit të një teatri të ri... Unë nuk mohoj çfarë kam thënë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Më fal, por po flet shoku yt! Çfarë të bëjmë tani? Ngrijeni dorën sa të doni...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Për mendim tim, teatri i ri duhet të bëhet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi - Çfarë vote do të hedhësh? Çfarë do të hedhësh me votë?

Bujar Çela – Mundem për procedurë?

Albana Vokshi - E merr fjalën ai për procedurë? Të vazhdojë për procedurë. Nuk kam ç’t’i bëj unë.

Vazhdo, Bujar, për procedurë!

Bujar Çela – Gjej rastin të falënderoj kolegun Baçi, se tha një të vërtetë shumë të madhe! Ne kemi marrë përsipër të ndërtojmë, të qeverisim. Forca e kartonit është forca që na jep populli. Ju nuk keni votuar në parim...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem!

Albana Vokshi – Po vrisni teatrin! Po vrisni kulturën në emër të popullit, sikur të ishte gjallë Enver Hoxha!

Bujar Çela – Jo, nuk tha njeri...

A ka mundësi të dëgjosh?

Albana Vokshi – Ju na keni sjellë Enver Hoxhën në këtë komision dhe në këtë parlament.

Ju po vrisni në emër të popullit, o vëlla!

Boll tani me ato kartonë! E tmerrshme!

Bujar Çela – Lërinis përgjegjësitë tona! Ju, që në momentin...

Albana Vokshi – A keni ju moral? A ju ka mbetur një fije dinjitet? Po si mundet?.. Shkatërrojini të gjitha...

Bujar Çela – A ka mundësi...? Se duket sikur po zihemi te gardhi!

O Kryetare, se po zihemi si te gardhi! A ka mundësi të më dëgjosh?

Albana Vokshi – Pse nuk e shkatërroni piramidën? Apo sepse ishte i ati i Kryeministrit ai që kishte bërë atë skulpturën aty? Prandaj nuk e shkatërroni?

Bujar Çela – A ka mundësi të dëgjosh këtë që po them tani?

Ju, si opozitë, jeni shprehur kundër në parim. Edhe nen për nen do të trazoni të njëjtën gjë. Pse na pengoni të ndërtojmë?

Ju lutem, a mund ta hedhim në votim nen për nen dhe të shpreheni me votë?

Faleminderit!

Albana Vokshi – Ma the një herë dhe mos e merr më fjalën për të përsëritur të njëjtën gjë! Adelina...

Adelina Rista – Faleminderit, zonja kryetare!

Faktikisht, këtu te ne po shkelet Rregullorja sekondë pas sekonde.

Mua më duhet t'ju kujtoj...

Albana Vokshi – A e keni lexuar Rregulloren?

Adelina Rista – Po.

Albana Vokshi – Cili nen po shkelet? Ma thuaj pak.

Lexoje nenin e Rregullores!

Adelina Rista - ...se në bazë të Rregullores, në momentin që fillon votimi nen për nen, diskutimi nen për nen, nuk merret më fjala për procedurë, zonja Kryetare!

Albana Vokshi - Cili nen?

Po ti, për çfarë e more fjalën?

Adelina Rista – Edhe një herë, më duhet t'jua kujtoj. Në momentin kur kalohet te votimi nen për nen, ku ne kemi kaluar, fjala për procedurë nuk merret më.

Albana Vokshi – Ku e ke?

Adelina Rista – Ne jemi te votimi nen për nen, zonja Kryetare!

Mos e kaloni më fjalën për procedurë! Kjo është Rregullorja. Lexojeni mirë dhe mos e kaloni më fjalën për procedurë! Jemi te nen për nen. Vazhdojmë në bazë të Rregullores.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Fjala për procedurë merret në çdo moment. Lexoni pak, se është turp! Çfarë flisni?!

Adelina Rista – Ti dhe unë e kemi eksperiencën nga radha e kaluar. Në momentin kur jemi në diskutimin nen për nen, nuk kalohet më për procedurë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Do të dëgjoni?

(Diskutime pa mikrofon.)

O Ismet...

Ismet Beqiraj –Të lutem, nuk ka kaluar... E kemi thënë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi - Ne argumentet tona do t'i themi, nuk na pengoni dot t'i themi. Nuk e kuptoni këtë?

Ismet Beqiraj – Unë të thashë: “Jep mendimin...” Nuk të thashë të shprehesh si të dua unë dhe maxhoranca. Jepeni mendimin, si ta keni!

(Diskutime pa mikrofon.)

Nora Malaj – Për të riardhur te diskutimi nen për nen.

Që në krye të herës, kur hyri ky projektligj, përpara se të kalonte këtu, ju e dini shumë mire, në seancën e kaluar, hyri në mënyrë jotransparente.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Aman, o Milva, ta dëgjojmë njëri-tjetrin!

Nora Malaj – Dakord! Mendimi im është që hyri në mënyrë jotransparente dhe u përdorën truke kushtetuese, Rregullore apo hapësira ligjore, për t'u quajtur pjesë e debateve dhe diskutimit.

U kalua në debatin e parë dhe vendosëm... Nuk arritëm ta mbyllnim dje debatin, për arsye të moskorrektesës dhe të mosprofesionalizimit të Ministrisë së Kulturës, të përfaqësimit të saj.

Ministria e Kulturës ka bërë përfaqësimin më të dobët në mbrojtje të një ligji të ardhur në këtë format, i llojit të veçantë, i mënyrës së veçantë dhe i qasjes së veçantë, sepse ka shumë probleme brenda dhe, me të drejtë, specialistët nuk mund të marrin të gjitha fajet, sepse nesër do t'i vënë në pikëpyetje edhe për diplomat që kanë marrë dhe do të thonë: “I kanë marrë realisht apo nuk i kanë marrë?”.

E treta, që është shumë e rëndësishme, e diskutuam në parim dhe thamë: “Ne jemi kundër”, por kjo nuk do të thotë që kolegët tanë t’i lëmë të vazhdojnë dhe të bëjnë gabimin që nesër do të kthehet në faj.

Po themi të gjitha mendimet tona, duke argumentuar pse diskutuam kundër. Jo se jemi kundër ndërtimit, rrjetëzimit të trashëgimisë, rregullimit të Teatrit, por asnjëherë nuk e kuptuam: a do të shembet, a do të ndërtohet, a do të rindërtohet, a do të quhet zonë e mbrojtur, a do të quhet e zhvillimit të zonës urbane? Çfarë fitimi ka ky individ që do të japë këtë kontribut? Çfarë përfitimi ka kjo pronë e shqiptarëve nga taksapaguesit shqiptarë? Në fund të ditës, të gjithë të dalim të qartë përpara kësaj gjëje. Pra, në këto diskutime që po bëjmë...

Milva Ekonomi – Nuk i merr dot këto përgjigje tani.

Nora Malaj – Më lër të them mendimin tim. Le të jetë “mendim budalla”, nuk ka gjë.

Unë do të them shqetësimin dhe mendimin tim, sepse më ka sjellë ai popull, që është shumë i ndjeshëm, por që nuk ka më mundësi të dalë, se është lodhur dhe më thotë: “Ti, o zonjë, që ke shkuar aty në parlament, çfarë bën? Pse nuk e thua shqetësimin tonë?”. Qoftë ky shqetësimi më naiv i mundshëm, i një qytetari, i një qytetareje, i një fëmijë, i një burri, i një gruaje, i një njeriu që hipën në taksì, qoftë edhe i këtyre zotërinjve që janë aty, që, në fund të ditës, kur dalin mbas orës 16:00, janë qytetarë, që kanë shkuar në teatër, që kanë marrë emocione, që kalojnë te Pedonalja, që dikur e shihnin sportin te Pedonalja të gjithë bashkë, tani e shohin te sheshi dhe bëjnë ndonjë terapi në grup.

Nuk ka arsye të bëhet çdo gjë me vrap, vrap, vrap... Pse vrap? Pse frikë? Pse të mos i themi gjërat siç janë?

Fidel Ylli – Hidheni me votë! Nuk na imponon dot ti ne!

Nora Malaj – Më dëgjo...

Fidel Ylli – Nuk na imponon dot me argumente. Dakord, ne e kemi gabim, sipas jush. Na lini të gabojmë. Vazhdo procedurën...! O Nora, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nora Malaj – I dashur miku im, Fidel, personalisht kam shumë inat t’i imponohem dikujt dhe respektoj mendimin e çdo individi, deri kur më cenohet e drejta ime.

Në qoftë se unë vij këtu dhe flas, flas me një përgjegjshmëri shumë të madhe, edhe profesionale, edhe intelektuale, edhe qytetare. E kam hequr politikën në këtë moment. Pra, në qoftë se ne diskutojmë, unë të them që në momentin e parë: “Miku im, Fidel, tek objekti nuk është e

qartë gjëja. Hajdeni, ta rregulloni ju, jo unë, që nesër të mos ju thuhet: “Mirë që nuk ditët ta lexonit, por si e votuat kështu?!” Kaq ishte e gjithë gjëja.

Nuk doni ju? Nen për nen e kalojmë në votim tani dhe mbaron...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ti thua: “Unë dua të eci me Ferrari te rrugica këtu.” Nuk ke as mundësinë dhe as hapësirë për ta bërë. Unë të them: “Hajde të bëjmë rrugën, hajde të ndërtojmë qendrën e Ferrarit dhe hajde të bësh Ferrarin.” Ne nuk jemi kundër... Ne po themi se nuk bëhet kështu. Me këtë format nuk e bën dot, as ti, askush. Nesër...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po ta them unë, nuk bëhet. Duhet të zhbëhet një gjë tjetër. Kaq po ju them.

Albana Vokshi – Nora, nuk e kuptojnë ose nuk duan ta kuptojnë.

Nora Malaj – Si të duan. Personalisht, e ndiej si përgjegjshmëri qytetare.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Bujar, të pëlqen, rri. Nuk të pëlqen, ik, more burrë!

Do të kalojmë në diskutimin nen për nen. Ju pëlqen, s’ju pëlqen...

Të njëjtin diskutim e ke thënë tri herë...

Do të shqyrtohet çdo nen, ju pëlqen apo nuk ju pëlqen juve! Kujt nuk i pëlqen, ja ku e ka derën, të ikë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, mos e merr më fjalën, mos përsërit të njëjtën gjë! Nuk i kemi mbaruar akoma diskutimet për nenin 1.

Pyetja ime për zëvendësministren: Më jepni një arsye të vetme, pse është kaq emergjent ky projektligj?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Te neni 1.

Lexojeni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sa ta lexoni ju, e ka kuptuar zëvendësministrja.

(Diskutime pa mikrofon.)

Më sqaroni...

E ke në titull.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...Një arsye, pse ky projekt është kaq emergjent? Pse e keni sjellë me procedurë të përshpejtuar? Një arsye të vetme më jepni.

(Diskutime pa mikrofon.)

O Ismet...

Bëni zhurmë sa të doni, mua nuk më shqetësoni fare. Po i bëj pyetje zëvendësministres...

(Diskutime pa mikrofon.)

A do të rrini...? Sepse unë mund ta mbyll dhe mund ta hap prapë më vonë, nëse ju do të vazhdoni të bëni rrëmujë.

Të lutem, ki respekt për zëvendësministren!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E mbyll, që çke me të!

Ki respekt për zëvendësministren!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Tani, mos të vazhdojmë kështu “jo mbyllet, jo hapet”. Do ta mbyllim, të votojmë. Do ta hapim, të votojmë.

Albana Vokshi – Mbani rregull atëherë, mos bëni zhurmë.

Unë nuk mund të bëj mbledhje, kur ju të gjithë bëni zhurmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Musa, të lutem, lërë tani!

Ju lutem...

Do ta kaloni me votë, ë?

Fidel Ylli – Mbyllet me votë ai...

Pse, ç’kujtove ti, se ke mikrofonin dhe mund ta hapesh e ta mbyllësh mbledhjen kur të duash?!

Albana Vokshi - Mua nuk më shqetësoni fare. Kam të drejtën time... E kuptoj që jeni shumë të shqetësuar, se po vidhni...

Fidel Ylli – Do ta shikojmë, mos u mërzitni!

Kalojmë te projektligji, të lutem!

Albana Vokshi – Te projektligji jam, por s’po më lini.

Fidel Ylli – Por çfarë nuk po të lëmë?! Ju po flisni në parim! Vazhdoni nen për nen.

Albana Vokshi – Më thoni një argument, pse e sillni projektligjin me procedurë të përshpejtuar? Cila është emergjenca? Një argument të vetëm...

Pse me procedurë të veçantë?

Pse nuk jeni bazuar te ligji për koncesionet dhe ligji për...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A do të më lini të mbaroj apo do ta zgjasim pa fund?

Pse nuk jeni bazuar te ligji nr. 125/2013, për partneritetin publik-privat, i cili e parashikon ngritjen e komisioneve? Nuk kishit pse të ngrinit këtë komision, pra një projektligj të veçantë për një komision, që e parashikon ligji i koncesioneve dhe i PPP-ve!

(Diskutime pa mikrofon.)

Valbona Shujaku – Meqenëse pyetja juaj ka të bëjë me elemente procedurale, përgjigjen do ta përcjell te kolegu.

Edmond Ahmeti – Mund t’ju kthej përgjigje për pyetjen?

(Diskutime pa mikrofon)

Në lidhje me pyetjen e adresuar, se përse përdoret procedura e përshpejtuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Albana Vokshi – Ta dëgjojmë!

Të lutem, vazhdo!

Edmond Ahmeti – Në momentin kur na bëni pyetje, kini durimin të përgjigjemi...

Albana Vokshi – Të lutem, mos komento se çfarë bëjnë deputetët, por përgjigjuni për atë që zonja nuk e dinte!

Edmond Ahmeti - Zonja zëvendësministre... Duke qenë se ka elemente procedurale, mund t’ju jap një përgjigje më të plotë...

Albana Vokshi – Të lutem, mos u fut në debat! Çfarë është kjo punë?! Të lutem, përgjigju!

Edmond Ahmeti – Në lidhje me pyetjen tuaj, mund t’ju them se procedurën e përshpejtuar e parashikon Kushtetuta. Është votuar nga Kuvendi i Shqipërisë inicimi i kësaj procedure dhe ne zbatojmë pikërisht këtë procedurë. Nuk është në tagrin tonë të përcaktojmë në këtë moment se cilat janë arsyet që zgjodhëm njërën procedurë dhe jo tjetrën. Ne zbatojmë vullnetin e Kuvendit të Shqipërisë, i cili ka përzgjedhur procedurën kushtetuese të miratuar, me arsyet përkatëse, që edhe ato janë miratuar dhe ne jemi këtu pikërisht për zbatim, jo vetëm pala jonë, por të gjitha palët e tjera të përfshira në këtë diskutim.

Albana Vokshi – Ju jeni propozuesi i projektligjit. Ju si ministri pse zgjodhët një procedurë të veçantë?

Nora Malaj – Më falni, a jeni ju ministria që ka bërë propozimin?

Edmond Ahmeti – Bashkëpropozimin.

Nora Malaj – Atëherë cili ka qenë objekti që ju keni vendosur të bëni këtë lloj bashkëpropozimi?

Edmond Ahmeti – Sipas relacionit bashkëlidhur projektligjit.

Nora Malaj – Sipas relacionit bashkëlidhur projektligjit thuhet se në projektligj kërkesën nuk e ka bërë ministria, por dy subjekte dhe ministria ka ardhur për ta bërë këtë gjë. Ku jeni mbështetur ju që e bëni këtë propozim të përsheptuar?

Edmond Ahmeti – Ministria e Kulturës është bashkëpropozuese në këtë projektligj, duke qenë se ka një tërësi institucionesh që preken, sepse Ministria e Kulturës del përtej fushës së veprimit të saj dhe, duke qenë pjesë e një grupi pune për përcaktimin e objektit të këtij projektligji, kemi sjellë formatin e përcaktuar sipas variantit që keni përpara.

Nora Malaj – Pse e keni marrë përsipër ta bëni ju këtë gjë, kur nuk është vetëm teatri objekt, por ka edhe objekte të tjera?

Edmond Ahmeti – Pikërisht, edhe komisioni i negocimit është ndërinstitucional.

Nora Malaj – Del mbi kompetencat tuaja. Pse duhet ta marrë ministria juaj dhe nuk ia jepni një ministrie tjetër që ka kompetenca? Ju mund të argumentoni duke thënë se e keni marrë, sepse Teatri dhe zona përreth është zonë e mbrojtur e monumenteve të kulturës dhe mbi bazën e kësaj u keni bërë këtë gjë, se kjo lehtëson radhën e punës.

Edmond Ahmeti – Zonja Malaj, unë mund t’ju them se, duke qenë që edhe Ministria e Kulturës ka pjesën e saj përkatëse në administrimin e zonës së Teatrit Kombëtar dhe interesin përkatës, pra, fushë veprimi dhe administrimin e Teatrit Kombëtar si institucion, do të thotë se jemi pjesë e një grupi ndërinstitucional. Komisioni i negocimit, i cili është parashikuar në këtë projektligj për shqyrtimin e gjithë projektpropozimit, për sa i takon pjesës së secilës prej tyre, duke përfshirë edhe Avokaturën e Shtetit për rolin që ka, do të shqyrtojë këtë projektpropozim. Pra, ne jemi një ndër aktorët, por...

Albana Vokshi – Pse zgjodhët procedurë të veçantë?

Fidel Ylli – Ia bëtë dje këtë pyetje ministres dhe ju sqaroi, se nuk e pengon Kushtetuta. Kjo është e kotë.

Albana Vokshi – Pse nuk u bazuat te ligji i PPP-ve, që përcakton fare qartë në nenet 4, 5, 6, mund edhe t’jua lexoj, se kur vjen një propozim nga një privat procedura është shumë e qartë: ngrihet komisioni ndërinstytucional, i cili e merr në shqyrtim, hap garë, bën edhe vlerësimet etj. Pse nuk e kaluat me ligjin e PPP-ve? Vetëm këtë dua unë, se e ke te fjalja e parë e nenit 1.

Fidel, të lutem, se po bërtasim të gjithë!

Edmond Ahmeti – Zonja kryetare, lidhur me pyetjen tuaj se përse është përzgjedhur kjo procedurë e veçantë dhe jo një tjetër e parashikuar në ligjin e PPP-ve, arsyeja është shumë e thjeshtë dhe e kemi parashikuar edhe në relacion. Ligji për koncesionet parashikon që për realizimin e punëve apo shërbimeve përkatëse nga institucioni joshtetëror, të paguhet, dhe propozimi i ardhur në këtë rast nuk përfshin fondet publike.

Albana Vokshi – Jo, nuk është ashtu, ju po gënjeni!

Edmond Ahmeti – Më lejoni ta mbaroj!

Albana Vokshi – Jo, nuk është ashtu, sepse ka koncesione dhe partneritete ku shteti nuk paguan; ka sa të duash, me qindra.

Edmond Ahmeti – Pagan vlerën e konvertuar në shfrytëzimin e pasurisë publike që ndërtohet nga subjekti ndërtues. A jam gabim këtu?

Albana Vokshi – Me falni, a po e jepni pronën ju?

Edmond Ahmeti – Zonja kryetare, ne nuk japim pronë, por iniciojmë një procedurë për një propozim të ardhur. Është parashikuar ngritja e një komisioni...

Albana Vokshi – Pse nuk e futët me PPP-të?

Edmond Ahmeti – Është e pamundur, për arsye se, qoftë ligji për PPP-të, qoftë ligji për prokurimin publik parashikojnë kosto dhe shfrytëzim të këtij objekti.

Me sa di unë, kjo pyetje u sqarua dje shumë mirë nga zonja minister, që kjo pronë pas përfundimit, në rast se do të rezultojë e suksesshme, do të jetë tërësisht në shfrytëzim të Teatrit Kombëtar.

Albana Vokshi – Nuk keni lekë? Hapni procedurë dhe aty mund të ketë shumë kompani të tjera private, që mund të mos kenë as zyrë, qoftë edhe 8 metra katrorë, dhe të japin një propozim shumë herë më të mirë se ky që ka dhënë kompania “Fusha”. Pse nuk e hapët, pse e shmangni garën, e cila mund të kishte interes publik shumë herë më të lartë?

Edmond Ahmeti – Zonja kryetare, ne nuk jemi duke shkelur ndonjë ligj dhe nuk po e pengojmë garën, por po themi që procedura e veçantë është për të filluar një negociatë të depozituar

dhe, për shkak të specifikave që paraqet në projektpropozim, është e pamundur të respektohen ligjet e tjera.

Albana Vokshi – Ju po shkelni ligjin për PPP-të, konkretisht nenet 4, 5, 6, 7, 8 dhe 13 e kështu me radhë. E keni detyrim ligjor që, në momentin kur vjen një propozim nga një kompani private, jeni të detyruar automatikisht të hapni garë.

Edmond Ahmeti – Zonja kryetare, mund t’ju parashikoj edhe shembuj të tjerë.

Albana Vokshi – Mos ma ndërprisni fjalën mua!

E ke me detyrim ligjor. Hapet gara, ngrihet një komision dhe aty ka një sërë procedurash. Ju po e shkelni ligjin me të dyja këmbët. Po jua lexoj nenet që të bindeni.

Edmond Ahmeti – Zonja kryetare, unë jam drejtori përkatës, që e ka këtë fushë veprimi të lidhur me atë legjislacion.

Albana Vokshi – Ka shumë mundësi që shefja jote të mos shkojë në burg, por ju më të vegjlit do ta pësoni, prandaj kini kujdes se çfarë po firmosni! Mos u bëni bashkëfajtorë, se ata do të shpëtojnë, kurse ju mund ta pësoni! Kini kujdes me ato që propozoni dhe firmat që hidhni, sepse kjo është antiligjore dhe antikushtetuese dhe ju e dini më mirë se unë nëse keni bërë edhe herë të tjera procedura të tilla koncesionare. I kam këtu, i keni shkruar precedentët, nuk kam nevojë të m’i thoni, i keni të gjitha të dështuara.

Edmond Ahmeti – Doja t’ju thosha një precedent tjetër për ligjin për ndërtimin e kompleksit parlamentar.

Albana Vokshi – Nuk ka nevojë, sepse lexoj relacionin. Më keni thënë China, që nuk ekziston, më keni dhënë Vlorën, më korruptivi që akoma nuk dihet se çfarë është, më keni dhënë Karpenin. Ju e keni shkruar relacionin dhe m’i keni dhënë.

Milva Ekonomi - Ju kujtohen kullat te bulevardi i ri? Erdhi një propozim i pakërkuar nga një sheik arab dhe u ngrit komisioni i negocimit. Ka ardhur me ligj, pastaj u hodh poshtë, se kur u negociaua, u pa që ne nuk i plotësonim dot kushtet që kërkonte ai projektpropozim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është fat të të vijë një propozim.

Kur vjen një propozim dhe do shihet i gjithë legjislacioni, ka shumë agjenci që marrin pjesë në këtë zgjidhje, sepse duhet të shohin legjislacionin, tarifat, spostimet, shpronësimet, shihet kostoja në para, pra çfarë vlere ka kostoja e parasë nga ky projektpropozim. Ka shumë punë për të bërë, kjo është gjëja që po diskutohet tani.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se e ka të drejtën Kryeministri, ia ka dhënë Kushtetuta. Ndërkohë, këtu vjen një komision që do ta negociojë këtë projektpropozim. Ka pasur raste kur projektpropozimet kanë qenë të mira dhe kanë ecur përpara, ka pasur raste kur nuk kanë qenë të mira dhe kontrata nuk është bërë. Ne po u themi këtyre të ulen e të hartojnë një kontratë dhe të shohin nëse ia vlen ky propozim. Në këtë fazë jemi tani.

Nora Malaj – Atëherë pse ngrihet gjithë ky shqetësim? Vërtet Kryeministri ka të drejtën të bëjë propozimin, dhe shumë mirë që e ka, por nuk thotë “e dua baba, e dua tani dhe e dua me këtë model!”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po më lër, more, ta them, se nuk po e paragjykoj! Unë thjesht po pyes se janë gjithë ata njerëz që kanë 4 muaj që flasin. Në fillim nuk u tha asnjë fjalë, pastaj u hodh për dëgjuesë. Kanë 4 muaj njerëzit aty që u shqyen.

Fidel Ylli – A ka ndonjë aktor sot? Nuk ka, kanë ikur, se kanë rënë dakord se duan një teatër të ri, por duan negociata të sinqerta me qeverinë. Atëherë ngrihet komisioni, që të mos i mbajmë varur. Të ngrihet komisioni, pastaj kërkojmë llogari.

Edmond Ahmeti – Zonja Malaj, te neni 5, pika 3 janë dy përfaqësues nga komuniteti i artistëve.

Albana Vokshi – Zoti drejtor, mbani shënim!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mua më vjen keq se je dhe artist, sepse ata kanë bërë një aleancë për mbrojtjen e teatrit dhe janë sindikatat e artistëve, janë qytetarët, është shoqëria civile, pra të gjitha palët ishin aty. Çfarë të shpjegoj më shumë unë, kur aty është një aleancë e tërë e cila del aty çdo pasdite?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, çfarë lidhje ka teatri me aktorët? Ka lidhje me ne, sepse teatri...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do t'i kthehem edhe Turbinës, se keni vjedhur pronën private aty, ju po rrëmbeni një pronë private, ia keni dhënë me ligj privatit.

Fidel Ylli – Ishte SHQUP-i që u mori pronarëve pronën private dhe e bëtë seli për PD-në me dhunë. Këtë keni bërë ju.

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi - Të vëmë pak rregull!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A është e mundur të kthehemi në diskutim normal, se po çirrem dhe nuk po dëgjohet gjë!

Ky projektligj bie haptazi në kundërshtim me ligjin nr. 125 të vitit 2013, me nenet 4, 5, 6 dhe me nenin 8, ku ndiqen të gjitha fazat për procedurat që parashikon ligji nr. 125, i vitit 2013. Me anë të këtij ligji ju thjesht shmangni garën. Neni 25 i ligjit nr. 125, i vitit 2013, thotë: “Autoriteti kontraktues autorizohet të shqyrtojë dhe të pranojë propozimet e pakërkua”, sikurse është rasti në fjalë i kompanisë “Fusha”, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 25 të këtij ligji, me kusht që këto propozime të mos kenë të bëjnë me një projekt, për të cilin procedurat e përzgjedhjes, kanë nisur apo janë shpallur.

Ju bini në kundërshtim më çdo fjalë të këtij neni, nëse propozimi i pakërkuar konsiderohet i pranueshëm pas vlerësimit paraprak, autoriteti kontraktues mund të ndërmarrë veprimet për dhënien e koncesionit. Nuk do të pranohen propozimet e pakërkua të shoqëruara me studim të formës minimale. Ne akoma nuk kemi studimin, projektin, ju nuk na e jepni, na thoni që është ende duke u diskutuar etj.. Propozuesit i jepet bonusi, atij që e propozon i pari. Qeveria e ka marrë përsipër, që meqenëse e bëri e para, i jep edhe bonusin nga 2, 4, 6 pikë dhe 10 pikë, apo jo? Pra, merr bonusin dhe mund ta fitojë garën. Pse po shmangni të gjithë legjislacionin, kur edhe me këtë, kompaninë “Fusha”, e kishit paracaktuar dhe mund t’ia jepnit? Pse po e bëni në mënyrë kaq arrogante? Mund ta kishit bërë më bukur, pa shkelur 100 ligje, pasi edhe me bonus ia kishit dhënë “Fushas”-s.

Edmond Ahmeti - Zonja kryetare, në vijim të pyetjes suaj, pse shmanget ligji nr.125 “Për koncesionet dhe partneritetet”, më duhet t’ju them se nëse citojmë nenin 3 të këtij ligji, jemi komplet jashtë objektit të këtij ligji. Është e pamundur që me propozimin përkatës dhe me objektin e këtij ligji, të mund të ishim në një rrugë simetrike. Nuk jemi aspak në kushtet e shmangies, sepse neni 3 parashikon: “Koncesioni i punëve publike është një marrëveshje me interes financiar, e lidhur me shkrim ndërmjet autoriteteve kontraktuese, në këtë rast ministritë përkatëse dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, objekt i së cilës është kryerja e punimeve, ku shpërblimi për punimet që duhet të kryhen përbëhet nga e drejta për të shfrytëzuar veprat që janë objekt i kontratës”. Si i tillë ky propozim i pakërkuar i subjektit propozues nuk përbën fushë objekti të këtij ligji për arsye se propozimi i pakërkuar nuk parashikon që objekti, godina e Teatrit Kombëtar në këtë rast, nuk do të shfrytëzohet sipas afateve deri në 35 vjet, sipas afatit të kontratës përkatëse

publike, por do të jetë tërësisht, që në momentin e dorëzimit në rast se negociata konsiderohet apo shpallet e suksesshme nga grupi institucional, në funksion të Teatrit Kombëtar dhe institucionit përkatës. Si i tillë, ky ligj, objekti i këtij ligji, nëse shikoni edhe elementet e tjera, germën “a” të nenit 3, ku thuhet: “ E drejta për të nxjerrë të ardhura, ku subjekti përkatës duhet ta shfrytëzojë këtë objekt në mënyrë që të kompensojë të ardhurat e investimit të kryer”, ky ligj ashtu si edhe ligji “ Për prokurimet publike...

Albana Vokshi - Pse nuk hapni garë? Hapni garë! Mund të vijë tjetri! Hapni garë dhe vjen një tjetër! Jep një propozim!

Neni 25, ta kushtëzon.

E dyta, aty është, nuk e di se cili nen, edhe për fushën e kulturës, të artit dhe të sportit, por institucioni, i cili është përgjegjës për të financuar të gjithë aktivitetin në këto fusha është Ministria e Kulturës, nëse do t’u referohemi edhe ligjeve të tjera, apo nuk është kështu?!

Ti i referohesh vetëm një neni dhe nuk më kundërshton mua pjesën tjetër. Ti bie ndesh me nenet 4, 5, 8 dhe 25. Ti po shmang garën. Ju qëllimisht po shmangni garën, duke shkelur të gjitha nenet e këtij projektligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Jemi kundër për të gjitha nenet nga i pari deri në fund. Do të japim të gjitha argumentet. Mënyra se si e keni bërë përshkrimin e neneve 1, 2 shkelet ligji, Kushtetuta. Ju i thoni “ Fusha”-s, hajde bëj çfarë të duash, me projektin tënd dhe unë do ta pranoj, sepse pika 4 e nenit 3, thotë se çfarë do privati.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Zoti Luan, ju jeni kundër, ne jemi pro.

Albana Vokshi - Luani e ka shumë të qartë. Ti shko andej nga ke ardhur, nëse mërzitesh, ose qëndro këtu dhe dëgjo diskutimet!

Ismet Beqiraj - Nga të shkoj, të lutem?

Albana Vokshi - Andej nga ke ardhur. A ke ardhur nga Fieri? Nëse po bezdisesh, shko atje! Do të kalojmë në shqyrtimin nen për nen.

Ismet Beqiraj - E kam krenari që jam nga Fieri.

Albana Vokshi - Nëse bezdisesh, shko në shtëpi.

Ismet Beqiraj – Nga Mallakastra, jam edhe nga Tirana, ti nuk më bën dot mua biografinë.

Albana Vokshi- Atëherë, qëndro këtu. Mos e prish mbledhjen! E ke thënë 100 herë.

Ismet Beqiraj - Të lutem! Mos më trego Fierin! Çfarë janë Fieri, Vlora, Shkodra?! Nuk po e prish fare mbledhjen!

Albana Vokshi - Ne do të sqarojmë të gjitha shkeljet që bëni në çdo nen, nëse nuk të pëlqen shko andej nga ke ardhur, po ta përsëris edhe një herë!

Ismet Beqiraj - Mos më fyej në inteligjencë, por edhe se çfarë përfaqësoj. Më vjen keq për Luanin që nuk flet.

Albana Vokshi - Neni 2 “Qëllimi”. “Qëllimi i këtij ligji është realizimi i projektit për zhvillimin e një zone urbane në qytetin e Tiranës për ndërtimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar me partnerë privatë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pyetja është për zëvendësministren.

Valbona Shujaku –Është element procedural dhe teknik dhe fjalën ia lë kolegut tim.

Edmond Ahmeti—A mund të përgjigjem?

Zonja Duka në lidhje me përcaktimin e elementeve kufitarë neni 4, parashikon pjesën ku presupozohet të zhvillohet ky projekt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pika 4, neni 3.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Valentina Duka - Pse nuk e përcaktoni që këtu, por e lini te kufizimet? Kufizimet janë tjetër gjë. Shpjegimet për kufizimet janë të tmerrshme, por te qëllimi duhet të përcaktoni se cila është zona urbane që do të zhvillohet. Qëllimi, e mbrojtur, e pambrojtur, si dhe ku.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Arbiola Halimi - Më habisin ndonjëherë kolegët me këtë mënyrë sjelljeje.

Albana Vokshi – Nuk duan ta diskutojnë, sepse i ka dhënë urdhër vetëm që ta votojnë.

Arbiola Halimi - Kryeministri ka qaq kohë që thotë, të bëhet një dialog midis pozitës dhe opozitës. Ne po japim konstruktivitet për të thënë: njerëz kjo që po bëhet, nuk ka logjikë, sepse nuk i keni shkruar mirë gjërat. Ose shkruajini mirë, që nesër të mos lini evazivitete. Pse shqetësoheni?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nora Malaj- Pse nuk bien kambanat? Se nuk ka kambana.

Arbiola Halimi - Duke parë edhe përgjigjet që po japin, ose më mirë të them përgjigjet që nuk po jep ministria, nëni 1 vlen sa 2-shi, 3-shi apo 12-ta, pak rëndësi ka, sepse në fund ministria, roli i saj është vetëm noterizimi dhe marrja pjesë si noter i këtij akti të turpshëm që ka sjellë Kryeministri, ministrja dhe kryetari i bashkisë. Në fund të fundit, ky është një projektligj që na serviret në shkelje flagrante të Kushtetutës, të të gjitha ligjeve, qoftë ligjit “Për qeverisjen vendore”, qoftë ligjit “Për partneritetit publik –privat” apo të ligjit për koncesionet. E kuptoj nxitimin e maxhorancës që kërkon ta kalojnë sa më shpejt, sepse urdhri është që ditën e enjte u fut në formën e përshpejtuar dhe po ditën e enjte duhet të kalojë. Në diskutimet dhe fjalën kemi, nuk kemi gjë tjetër. Po të kishte Gjykatë Kushtetuese, do të shkonim në Gjykatën Kushtetuese. Ju e dini shumë mirë që e keni asgjësuar Gjykatën Kushtetuese, e dini shumë mirë që e keni paralizuar dhe është në kolaps i gjithë sistemi i drejtësisë, sepse e dini që nuk kemi ku të trokasim.

Në do të diskutojmë, do të debatojmë, sepse kemi qytetarët që po na ndjekin, kemi një interes publik që po na shikon. Këtu nuk bëhet fjalë për ndërtim, për zhvillim. 6 kullat në qendër të Tiranës, duke shkatërruar një monument, identitetin kombëtar, trashëgiminë kulturore dhe historike, ju i quani zhvillim urban? Votojeni, forcën e kartonit e keni. Do ta kaloni më tej dhe në parlament. Të premten do t’i vini minat dhe ja, u krijua edhe Teatri. Fatkeqësia e këtij Teatri është që ndodhet në vendin e gabuar, në monentin e gabuar dhe në duart e njerëzve dhe të qeverisë së gabuar. Kjo është e gjitha. Ne si opozitë nuk bëhemi palë me ju. Ju bëjuni noterë të këtij akti korruptiv, të kësaj marrëveshjeje korruptive. Në fakt, ju nuk jeni asgjë tjetër, por po ju fusin të bëheni bashkëfajtorë dhe të merrni pjesë në një krim, por mos harroni se nesër nuk do të shkojë çdo gjë lisho siç jeni sot, pasi nesër do të ketë Gjykatë Kushtetuese, prokurori të pakapur dhe ju do të jeni objekt të procedimit penal nga i pari deri tek i fundit.

U bëj thirrje prokurores së Përgjithshme dhe prokurorit, cilido që ta marrë çështjen në dorë, shpresoj të jetë objektiv dhe i drejtë që kushdo që firmos, duke e parë se Kryeministri e ka hedhur topin te zëvendëskryeministrja, kryetari i bashkisë, te zëvendëskryetari i bashkisë dhe kështu me radhë, të mbajnë përgjegjësi penale dhe ligjore, të mbajnë edhe përgjegjësi morale, pasi nesër nuk do të kemi se çfarë t’u tregojmë brezave, fëmijëve tanë, se ku është historia, trashëgimia kulturore, trashëgimia historike, sepse ju po shkatërroni çdo gjë të bukur që ju del përpara, ashtu siç shkatërruat edhe një ëndërr 28-vjeçare të shqiptarëve që ishte ajo e integritetit europian. Ky nuk është modeli që i servirni shqiptarëve, ky nuk është modeli i Europës, kështu ne nuk shkojmë në asnjë vend. Do të mbetemi hapa mbrapa dhe çdo ditë e më shumë po bëjmë nga një hap pas.

Unë nuk ju ftoj ta votoni, ju e keni këtë urdhër, do ta kaloni me forcën e kartonëve, por nuk funksionon kështu. Të jeni të bindur se do të mbani përgjegjësi penale, ligjore dhe, mbi të gjitha, përgjegjësi morale për këtë akt të shëmtuar që po bëni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Albana Vokshi -Nuk i kemi mbaruar ende diskutimet!

Vilma, ju intereson se çfarë po diskutohet? Çfarë të intereson ty, për shembull, cila pjesë? Të intereson Teatri i Tiranës? Nuk të intereson, se po të ishte kështu, do ta kishe ngritur zërin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dhe shkatërrohet e gjithë historia.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Rroftë Edi Rama!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pyetja ime është: a bie ndesh me ligjin “Për mbrojtjen e monumenteve të kulturës”? Pra, ky nen me VKM-në nr. 325 “Për zonat e mbrojtura”?

Edmond Ahmeti - Jo!

Albana Vokshi - Je i sigurt? Po pjesën e zhvillimit urban të kryeqytetit, e dini që e ka kompetencë këshilli bashkiak?

Edmond Ahmeti - Ky ligj parashikon nisjen e një negociate për propozim dhe nuk parashikon cenimin apo kufizimin e ligjeve të tjera për t’i dhënë mbifuqi ligjore këtij ligji, duke anashkaluar ligjet e tjera. Në momentin që finalizohet një negociatë e suksesshme...

Albana Vokshi - Më falni! Nëse në nenin 3 ju i jepni autoritet të plotë kryetarit të bashkisë dhe grupit negociator për tjetërsimin e pronave, a bie kjo ndesh me legjislacionin në fuqi, me nenet 13,113 dhe 116 të Kushtetutës, ku përcaktohet fare qartë autonomia vendore? A po i merrni ju kompetencat e këshillit bashkiak?

Edmond Ahmeti - Cilën kompetencë?

Albana Vokshi – Për tjetërsimin e pronave.

Edmond Ahmeti - Ligji për tjetërsimin e pronave është i cituar në nenin 4...

Albana Vokshi – Unë po të flas për Kushtetutën, ti më flet për ligjin e pronave! A e shkel nenin 13 të Kushtetutës që përcakton autonominë vendore?

Edmond Ahmeti - Jo, nuk e shkel.

Albana Vokshi - A po i merr ti kompetencat këshillit bashkiak?

Edmond Ahmeti - Cilën kompetencë?

Albana Vokshi - Ta thashë një herë, tjetërsimin e pronës. A më dëgjon se çfarë po të them apo jo? Ti në nenin 3 autorizon kryetarin e bashkisë dhe grupin negociator që të bëjnë vlerësimin e të gjitha pronave, u jep autoritet që të bëjë edhe tjetërsimin e tyre dhe dhënien e tyre në shfrytëzim.

Edmond Ahmeti - Zonja kryetare, ky ligj parashikon nisjen e negociatave dhe ligjit tjetër për përfundimin e draftkontratës dhe projekti final i përket objektit të një ligji tjetër.

Albana Vokshi – Neni 3 “Autorizimi i komisionit të negocimit”, dhe dëgjoje mirë: “tagri që gëzon komisioni i negocimit për të përfaqësuar pronarin-shtet me të drejta të plota, për të vlerësuar e tjetërsuar pronat në pronësi të pushtetit qendror apo vetëqeverisjes vendore.”

A e kupton se çfarë do të thotë kjo? Pra, a ia jep tagrin, a e autorizon, që ky komision të tjetërsojë pronat?

Edmond Ahmeti – Zonja kryetare, në momentin kur negociata shpallet e suksesshme, edhe tagri për të tjetërsuar pronat që janë në qeverisjen vendore do të jetë objekt i një ligji tjetër.

Albana Vokshi – Si qenka kjo? Po ia ke dhënë! Me këtë ligj po i jep tagrin! Po lexoje çfarë ke sjellë, çfarë ke shkruar! Çfarë po flisni? Unë e kuptoj që gjendeni në siklet, sepse s’e mbroni dot, por më mirë hesht dhe thuaj: nuk e mbroj dot. Mos mbroj një gjë që s’është e mbrojtshme!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po e ke të shkruar qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ke në pikën 1.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pika 2: Autorizimi i kryetarit të bashkisë: “Tagri që gëzon kryetari i bashkisë, personi i autorizuar prej tij për të përfaqësuar pronarin-shtet me të drejta të plota për të nënshkruar kontratën me partnerin privat për zhvillimin e projektit sipas parashikimeve, i jep tagrin kryetarit të bashkisë që të vendosë vlerësimin e aseteve e pronave, tjetërsimin e pronave apo dhënien e tyre”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ja, e autorizon, e autorizon në emër të pronarit-shtet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ka pronësi-shtet, ka pronësi – bashki. Kemi dëgjuar deri tani tri palë pronësish.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Pika 7: Tjetërsim: “Vendosja në dispozicion e pronës shtetërore në shkëmbim të procesit të projektit.”

Janë shumë të qarta. I ka bërë të qarta.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E shkëmbimit, sepse merr pronën.

Pika 4: “Projekti i ndërtimit të godinës së re te Teatrit Kombëtar dhe zhvillimi i zonës ndërmjet rrugëve “Abdi Toptani” e “Murat Toptani”, sipas propozimit të paraqitur nga partneri privat.”

Nuk ka garë. “Fusha” vendos: “E dua që këtu e deri këtu. Dua kaq kulla. I dua kaq të larta, me kaq koeficient shfrytëzimi”.

Milva Ekonomi – “Fusha” propozon, nuk vendos.

Albana Vokshi – Sipas propozimit të paraqitur...

Milva Ekonomi – Po, por nuk e vendos dot “Fusha”.

Albana Vokshi – Po e ke edhe në fund: Sipas termave të propozuara nga “Fusha”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Valentina Duka – E para, njëherë, pika 7 e nenit 3: Tjetërsim: “Vendosja në dispozicion e pronës shtetërore në shkëmbim të zhvillimit të projektit”.

Pse s’e thoni shqip: kalimi i pronës publike te privati. Çfarë kuptimi kanë termat “tjetërsim”, “vendosja në dispozicion”. Ç’është kjo kakofoni fjalësh?

Milva Ekonomi – Sepse, ndërkohë, ata marrin mbrapsht një të mirë publike, që është teatri; japin pronën, marrin teatrin.

Valentina Duka – Po thuaje, pra!

Këtu thotë: “Vendosja në dispozicion...”

Milva Ekonomi – Kjo është ajo që ndodhet në kontratë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Mund të hiqet edhe teatri. Mos e ki merak!

Pika 4: “Nuk mund të marrin pjesë në komisionin e negocimit personat që kanë konflikt interesi me partnerin privat.”

A ka Erion Veliaj konflikt interesi me partnerin privat?

Unë mendoj se Erion Veliaj ka shumë konflikt interesi me partnerin privat, sepse ky privati i ka mbyllur çështjen e Ardit Gjoklajt në prokurori.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po e ke të caktuar, e ke këtu në ligj. E ke të përcaktuar me ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne po themi se çdo nen, çdo pikë është shkelje flagrante e ligjit dhe e Kushtetutës. Për këtë arsye ne jemi kundër. Ta marrin mbrapsht prapë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, pra, ta marrin mbrapsht, këtë po them!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shumë dakord, pra!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nora Malaj – Propozimi im, me gjithë këto probleme që kemi, është që të rishqyrtohet, që të mos na ndodhë e njëjta histori si me atë të arsimit të lartë, kur thamë se do ta kalonim pas gjithë debateve, që do të negociojmë për të bërë amendime, por që sot se kësaj dite mbetëm në mosrealizimin e gjërave. Prandaj duhen bërë të qarta këto gjëra, që të mos ketë fare ekuivoke.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ky është një ligj i shkruar tmerrësisht keq. Unë nuk e di kush e ka shkruar, nuk e kuptoj kush jua ka shkruar, sepse s’e besoj kurrë që këtë e keni shkruar ju. Realisht nuk e besoj kurrë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Hoxhaj – Është neni 5, ligji për pushtetin vendor thotë se bashkia përfaqësohet nga këshilli, pra, bashkia nuk përfaqësohet nga kryetari.

Neni 5 thotë: “Bashkia përfaqësohet prej përfaqësuesit të përcaktuar nga bashkia e Tiranës”, që do të thotë: përfaqësuesi i caktuar prej këshillit të bashkisë; që do të thotë: mund të mos jetë Erion Veliaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Atëherë, përse i ka bërë negociatat Erion Veliaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pse është futur në negociata Erion Veliaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E para, mos merr në mbrojtje Erion Veliajn, ti!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të gjitha mbledhjet e konsultimit i ka bërë Erion Veliaj. Ka bërë konsultimin e ligjit Erion Veliaj. Është kështu apo jo? Erion Veliaj ka përçarë të gjithë artistët. Erion Veliaj është i interesuari i parë në këtë marrëveshje. Atëherë, mos merrni në mbrojtje diçka që s'ju takon!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kam lexuar atë, e kam lexuar shumë mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Hoxhaj – Një ligj që hartohet, nuk merr për referencë një ligj tjetër. Është e rëndësishme që ligji që hartohet, të mos konfundohej me ligjin tjetër.

Albana Vokshi – Jo more! Atëherë, a bie ndesh ky ligj me ligjin e vetëqeverisjes vendore, me nenin 54?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Hoxhaj – Absolutisht jo.

Albana Vokshi – Jo? A ta lexoj nenin 54, që për tjetërsimin e pronës që i takon bashkisë, është vetëm këshilli bashkiak ai që vendos?

Fatmir Hoxhaj – Po, është e vërtetë.

Albana Vokshi – Pra, a bie ndesh kjo?

Fatmir Hoxhaj – Në asnjë pikë të këtij ligji nuk thuhet se 2100 metra, në mos gabo, nga 8465 që janë pronë shtetërore, 2100 janë të bashkisë.

Albana Vokshi – Po të kujt janë? Na e ka thënë ministrja. A ishit këtu dje, kur tha ministrja?

Fatmir Hoxhaj – Atëherë, këto 2000 metra që ka bashkia, askush nuk e thotë se do t'i kalojnë partnerit, i cili do të jetë zhvilluesi i zonës.

Albana Vokshi – E ke këtu, e ke në relacion.

Fatmir Hoxhaj – Absolutisht jo!

Albana Vokshi – E ke në relacion: “Do të vihen në dispozicion 8467 metra”, është s'gabo.

Fatmir Hoxhaj – Është edhe pjesa tjetër, se këtu flitet për negociata, që do të thotë se deri në këtë moment që po flasim, jemi në pikën zero. Do të vazhdojmë, është rrugë e gjatë deri në përfundim të negociatave, sepse ne mund të dalim me një rezultat, që nëse nuk përmbushen kushtet...

Albana Vokshi – A e ke lexuar relacionin? Më fal, që po ju pyes.

Fatmir Hoxhaj – E kam lexuar.

Albana Vokshi – Atëherë, lexoni relacionin, lexoni paragrafin se sa metra katrorë tokë publike i vihen në dispozicion këtij projekti nga Ministria e Kulturës dhe nga bashkia, për t’ia dhënë kompanisë “Fusha”, për të bërë zhvillimin e zonës. Pra, nëse ti më thua se 5522 metra janë tokë e Ministrisë së Kulturës.

Fatmir Hoxhaj – E shtetit shqiptar.

Albana Vokshi – E Ministrisë së Kulturës. E teatrit. Është shkruar aty: e Teatrit Kombëtar.
(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I përkasin, thuaj si të duash, pronarit – shtet.

Fatmir Hoxhaj – Po.

Albana Vokshi – Atëherë më sqaro pak: nga kjo pjesa tjetër, nga 8467 metra hiq këto, kujt i përkasin?

Fatmir Hoxhaj – 8465 metra janë pronë-shtet, sipërfaqe e përgjithshme. Nga këto, e thamë se 1200 metra janë ndërtim, që përkon me Teatrin Kombëtar, gjë që do të thotë se pjesa tjetër, jashtë 1200 metrave, është pjesë funksionale e godinës, gjithashtu pronë-shtet. Nga 8000 metra, 2100 metra, në mos gaboj, janë të bashkisë. Në asnjë vend nuk thuhet se kjo pronë do t’i merret bashkisë me forcë nga qeveria qendrore, për t’iu dhënë partnerit. Ishim te ligji për PPP-të dhe ligji për komisionet.

Albana Vokshi – Më fal, më fal! Ma shpjego pak tani, se ju po bini në kontradiktë me veten tuaj!

Fatmir Hoxhaj – S’ka kontradiktë fare, është shumë e thjeshtë.

Albana Vokshi – Ta përsëris edhe një herë pyetjen, të lutem?

Në relacion thuhet se 8465 apo 8467 metra katrorë i vihen në dispozicion kompanisë private “Fusha”, për të bërë zhvillimin e zonës. Ia jep pronari shtet në këmbim, e ke edhe në kllapa madje...

Fatmir Hoxhaj – Për ta zhvilluar, jo për t’ia falur.

Albana Vokshi – ...në këmbim... E ke aty: zyra e kompanisë “Fusha”, meqë është kufitare. Nuk e ka dhënë fare se sa ka kompania “Fusha”. E pyetëm dje, por nuk na dhanë përgjigje. Kompania “Fusha” vinte në dispozicion selinë, zyrën... Apo s’është kështu?

Atëherë, si do t'ia vësh në dispozicion? A mund të më thoni se cilat janë format që i vihen në dispozicion një kompanie private? Sepse këtu thotë: e “tjetëron”.

Fatmir Hoxhaj – Është e mirëshpjeguar në relacion. Për mendimin tim, edhe ministrja e ka shpjeguar dje shumë qartë.

Albana Vokshi – Unë nuk e kam kuptuar. A mund të ma shpjegoni edhe një herë?

Fatmir Hoxhaj – Edhe Kodi Civil e parashikon nga neni 756 deri te neni 760 shkëmbimin e pronave. Është fjala për Kodin Civil, i cili prevalon mbi të gjitha ligjet, sepse është i miratuar me 85 vota. Pra, shkëmbimi i pronave njihet jo vetëm në jurisprudencën tonë, jo vetëm në të drejtën civile shqiptare, por në të gjitha të drejtat civile në botë. Është krejt normale që, kundrejt një të mire publike që do marrë shteti shqiptar...

Albana Vokshi – Po pse, ligji i vetëqeverisjes vendore me sa vota është miratuar?

Fatmir Hoxhaj – Me 85 vota, sigurisht.

Albana Vokshi – Atëherë? Pse prevalon?

Fatmir Hoxhaj – Sepse absolutisht nuk cenohen kompetencat e pushtetit vendor. Pushteti vendor do të jetë pjesë e negocimit. Mundet që komisioni ndërinstitucional, që do të krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në funksion të këtij ligji, në funksion të këtij projekti, në funksion të këtij zhvillimi, mund të dalë me konkluzionin se partneri privat, ai që ka ofruar, propozuar dhe shprehur interesin për ta ndërtuar këtë, kundrejt një shpërblimi, sepse në kapitalizëm nuk punohet falas, ai ka thënë: unë e bëj këtë ndërtim falas, në këmbim të kësaj, përveç komisionit janë ekspertët. Ky komision ka të drejtën ligjore, gjithashtu, që për çështje të caktuara, të cilat i kupton ose që nuk përfshihen në fushën e edukimit të tyre, merr specialistë dhe ekspertë me njohuri të posaçme, për ta shpjeguar çështjen, cilado qoftë ajo.

Pra, kjo do të vlerësohet me ekspertë. Përveçse nga komisioni, do të ketë edhe ekspertë të tjerë, të cilët do të thirren nga ky komision, për të vlerësuar se sa do të jetë përfitimi i palës – shtet në këtë zhvillim që do të realizohet nga ofertuesi.

Albana Vokshi – Mund të ma sqaroni pak se cili nen i Kodit Civil dhe cili nen i ligjit për pronat?

Fatmir Hoxhaj – Kodi Civil e thotë nga neni 756 deri në nenin 760. Këtu shpjegon në lidhje me shkëmbimin e pronave, që në këtë rast është pronari – shtet, ndërsa partneri tjetër është privat. Mund të jetë midis dy privatëve, mund të jetë mes dy qeverive, kjo nuk ka rëndësi, por e

njuh të drejtën e shkëmbimit të pronave dhe të drejtën e kalimit të pronësisë nga një pronar te tjetri. Pra, e ka ligji, dhe këtu nuk ka asnjë shkelje.

Sa i takon ligjit për PPP-të, nuk mund të funksiononte në këtë rast, për shkak të vlerave të theksuara ose të një interesi të theksuar publik që ka teatri, nuk mund t'i jepej partnerit. Nëse partneri do ta merrte me ligjin për PPP-të apo me ligjin për koncesionet, ai mund ta përdorte për ta dhënë vetë këtë shërbim, kundrejt shfrytëzimit, derisa të merrte investimin që ka realizuar.

Për shkak të rëndësisë dhe interesit të theksuar publik që ka teatri, kjo nuk mund të ndodhte. Rruga më e mirë që u gjet ishte kjo: që ai ta ndërtonte pas asnjë investim nga buxheti i shtetit, pa asnjë investim nga taksapaguesi i Shqipërisë, por ta bënte teatrin kundrejt një pjese të pronës – shtet. Këtu nuk ka asnjë shkelje të ligjit apo të Kushtetutës.

Albana Vokshi – E thoni me seriozitet këtë?! Po e thoni me përgjegjësi të plotë këtë?! Kjo regjistrohet, të lutem! Ju e thoni me përgjegjësi të plotë këtë?

Fatmir Hoxhaj – Në asnjë vend nuk është vendosur dhe ligji nuk e thotë.

Albana Vokshi – Më thuaj një vend të botës, në të cilin bëhet pikërisht kjo që po bëni ju! Më përmendni një vend të botës, që ia fal tokën privatit, një vend të botës që ia fal tokën publike privatit!

Fatmir Hoxhaj – Nuk ka falje këtu.

Albana Vokshi – Më thuaj një vend të botës!

Fatmir Hoxhaj – As këtu nuk thuhet se falet, por shkëmbehet.

Albana Vokshi – Po çfarë është shkëmbimi? Shkëmbimi është tjetërsim!

Fatmir Hoxhaj – Janë dy koncepte juridike të ndryshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Çfarë thua, more?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E ka përgjegjësi shteti ta ndërtojë teatrin? E ka shteti përgjegjësinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Normal, pra, se s'ke shtet, shumë mirë e the.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E the shumë mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Se ka njëzet e shtatë vjet që bëhet kjo katrahurë, që s’ka teatër, s’ka stadiume, se vetëm vidhet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë të gjejmë një formë, që ne të kemi mundësi ta zhvillojmë këtë vend. Janë forma që i kanë partneritetet publike - private. Shkëmbimet i ka edhe bota, sepse nuk i kemi shpikur ne.

Fatmir Hoxhaj – Gjithandej ka.

Fidel Ylli – I japim tokën dhe i themi: 25 % jemi ne, 75 % ti, dhe merr një stadium prej 100 milionë eurosh, që ti si shtet nuk ke mundësi ta bësh, dhe rri aty me ata gurët e “Qemal Stafës”! Ja pra, kjo është logjika.

Nora Malaj – Përpara se të arrinim te ky model, shteti i shteroi të gjitha mundësitë dhe burimet? Pra, nevoja e ardhjes te ky model nuk erdhi nga Ministria e Kulturës, që tha: kam nevojë ta ndërtoj teatrin, megjithëse ishte emergjente, por erdhi për t’u ndërtuar nga një subjekt dhe ministria e kishte në prioritet këtë gjë. Pra, pyetja e parë ishte: A e ka shteruar deri në fund ministria mundësinë që këtë objekt, që është objekt kombëtar, ta investonte shteti, qeveria me paratë e saj? Cilat kanë qenë format dhe rrugët që ka shteruar dhe kur pa që ishte e pamundur zgjedhi këtë lloj modeli?

Edmond Ahmeti – Zonja Malaj, Ministria e Kulturës, këtë përgjigje dha edhe dje zonja minister, i ka shteruar të gjitha mundësitë dhe ka kapacitetet buxhetore që ka...

Albana Vokshi – Cilat? Dy Bunk’Artet ishin prioritare, apo “Shtëpia e Gjetheve”?

Edmond Ahmeti – Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit...

Albana Vokshi - Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit, ju, që jeni aty drejtor, e dini shumë mirë që ka marrë fondet e teatrit. 2,5 milionë të fondit grek qëllimisht ia keni çuar Teatrit të Operës dhe Baletit. Atëherë, pse nuk qenka teatri prioritar, por qenka “Shtëpia e Gjetheve”? Pse Bunk’Arti është prioritar? Pse bunkerët qenkan prioritet?

Edmond Ahmeti – Zonja kryetare, ju jeni vetë drejtuese e këtij komisioni që merret, pikërisht, me çështjet e fushës së veprimit dhe të kulturës, dhe mund të propozoni që të ketë një shtim buxhetor, dhe mund t’i bëjmë të gjitha.

Albana Vokshi – Patjetër që po.

Edmond Ahmeti – Këto janë përtej mundësive tona.

Zonja ministre dje tha se emergjenca e përcaktuar për Teatrin Kombëtar...

Albana Vokshi – Cila është emergjente këtu?

Edmond Ahmeti – Gjendja e godinës, situata e krijuar, kushtet e të tjera, kanë krijuar nevojën që çdo propozim që vjen, duhet të merret në shqyrtim. A kualifikohet, a i përmbush kushtet ose jo, është çështje e komisionit të negocimit.

Albana Vokshi – Jam shumë dakord. A e inauguroi të famshmen “arTurbina” mbrëmë Kryeministri?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edmond Ahmeti – Zonja kryetare, nuk mund të përgjigjem për pyetje që dalin jashtë tagrave të mi.

Albana Vokshi – Nuk e dini ju?! Duhet ta dini që inauguroi “Turbinën”, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, lëre teatrin, lëri hapësirë teatrit që të restaurohet dhe përdor “Turbinën” për aq kohë sa të restaurohet. Nuk ka asnjë nxitim “Turbina”. Nxitimi është...

Edmond Ahmeti – Zonja kryetare, ka një relacion, ku thuhet se është e pamundur të bëhet kjo ndërhyrje...

Albana Vokshi – Ku është?!

Edmond Ahmeti – Nga specialistët e IMK-së dhe të Institutit të Ndërtimit, të cilët janë pjesë e relacionit.

Albana Vokshi – Së pari, mos e fut IMK-në, sepse në relacion ke shkruar “nuk është monument culture”, sepse ju bini në kundërshtim me veten tuaj. Ju nuk dini çfarë shkruani, jo ju, ata që e kanë shkruar. Atëherë, IMK-ja nuk ka punë fare këtu, në qoftë se ju e keni hequr nga monument kulture.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ta sqaroj unë Institutin e Ndërtimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet do të dëgjosh tani, apo jo?

Instituti i Ndërtimit e ka bërë, mbasi Kryeministri ka thënë se do të shembet Teatri. Kur ka dalë aty dhe ka thënë se Teatri do të shembet, Kryeministri ka urdhëruar ministren që të urdhërojë Institutin e Ndërtimit të bëjë këtë paçavure, që na kanë sjellë, ku thonë se nuk restaurohet, kur shumë arkitektë të tjerë dhe inxhinierë thonë: “Po, restaurohet”. Keni edhe një propozim, që kurrë nuk është marrë parasysh, që me ca millionë euro mund të restaurohet ndërtesa. Mos e bëni teatër, bëjeni muze, se ka vlera pa fund aty. Lexoni vetëm shkrimin e fundit që kishte bërë dje, nëse nuk

gabo, Aurel Plasari, se kishte një historik të teatrit dhe të vlerave të tetarit, fantastike. Merreni, dhe vetëm lexojeni atë. Shpresoj shumë që në ndërgjegjen tuaj të paktën të fillojë të lëvizë diçka. Meqenëse nuk restaurohet, mos e bëni teatër, bëjeni muze, sepse të gjithë kemi pak nga jeta jonë aty. Për të mos përmendur të gjithë emrat e mëdhenj që e kanë nisur atje veprimtarinë e tyre politike, artistike dhe kulturore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, mire, një pjesë kanë vdekur, nuk ekzistojnë më. Të marr t'i lexoj emrat që kanë nisur...

Fidel Ylli – Albana, teatri nuk është i aktorëve, është i publikut.

Albana Vokshi – Unë po them historinë. Është injorancë e madhe të thuash *dopo lavoro*. Është injorancë!

Fidel Ylli – Do të jetë një teatër, që ju do të mahniteni kur të mbarojë. Prisni se është shpejt, sepse do të vijë edhe stadium; do të vini me mua vitin tjetër në stadium dhe do ta shikoni. Më i bukuri në Europë. Ka ikur ajo, nuk e ka më kohën.

Albana Vokshi – Sigurisht, ka ikur.

Fidel Ylli – Unë jam dakord për transparencë. Ministrja të japë shpjegime.

Albana Vokshi – Ku e ke ministren?! Zëvendësministrja nuk di asgjë.

Fidel Ylli – Do të vijë në parlament, nuk do të kalojë kjo punë. Kjo është ngritja e komisionit.

Albana Vokshi – Ja ku e keni Ernest Koliqin, në përrurimin e ambienteve shtesë të rrethit “Skënderbeg”. Kjo është historia. Këtë po themi ne.

Fidel Ylli – Çfarë historie?! Ajo po rrënohet!

Albana Vokshi – Pikërisht, bëjeni muze, në qoftë se ti nuk do që ta bësh teatër. Bëjeni muze.

Fidel Ylli – Pse muze?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Pra, e do “Fusha”.

Fidel Ylli – Nuk e do “Fusha”. Pse nuk dhatë ju një ofertë kur morët vesh se “Fusha” ka hyrë? Dërgonit edhe ju një.

Albana Vokshi – Nuk ia dhatë asnjërit mundësinë.

Fidel Ylli – Pse nuk e çuat ju?!

Albana Vokshi – Po si ta çojmë ne?! Çfarë po thua?!

Fidel Ylli - “Fusha” u vetofrua!

Albana Vokshi – “Fusha” bëri pazarin me Edi Ramën. I tha Edi Rama dorëzo...

Fidel Ylli - Pse nuk vetofruat edhe ju një, dhe të thoshit kemi edhe ne një?...

Albana Vokshi – Kush është ju?!

Fidel Ylli – Ju, biznesmenët e djathtë. Pse nuk ofruat një, sepse ky që po e bën, nuk është në rregull, sepse po të kisha unë milionat, nuk do e merrja përsipër për të bërë 30 milionë euro një teatër.

Albana Vokshi – (tregon foto) Ja ku e keni, Instituti i Promovimit të Kulturës së shqiptarëve, shfaqje me valle dhe kostume popullore shqiptare në vitin 1940. Ia ku e keni historinë e teatrit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli - Pse nuk çuat edhe ju një dosje, sepse thirri Sali Berisha një firmë nga Spanja për të bërë stadiumin. Erdhi këtu dhe nuk e mori përsipër. Jo, tha nuk bëhet. “Të hedh unë 100 milionë euro me këto kushte!”. Jo! U detyrua hyri një shqiptar dhe po e bën.

Albana Vokshi – Fidel, shiko...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli - Pse nuk folët ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I mbyllëm ne?! Tek pullë erdhi një spanjoll. Pse nuk dhatë ju një ofertë? Pse nuk shkuaat ju dhe miqtë tuaj biznesmenë të?...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ishte garë që mbyllëm, ishte një propozim, e cila ka 6 muaj që ka dalë. E çonit një ju, vetëm për kunj t’ia çonit bashkisë, t’i thoshit “ja ku e ke”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju doni të bëni show!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Mendoni ta kishim shkatërruar, t’i kishit futur ruspën atje në Berat. Të dhemb ty Berati, edhe ne na dhemb Tirana; siç e ke t’i zemër, edhe ne e kemi, prandaj po luftojmë.

Ismet Beqiraj – Albana, nuk kisha ndër mend t’i nxirrja, por jam i shkencës ekzakte si puna jote, se Kimi ke mbaruar edhe ti...

Albana Vokshi - Nuk kam mbaruar për Kimi.

Ismet Beqiraj – Edhe media që më rri nga pas ta shikojë pak këtë teatër. Dakord që ta bëjmë muze dhe ta ruajmë. Ja tek është salla e komandimit elektrik e kohës së babaqemos.

Albana Vokshi – Çfarë po tregon?

Ismet Beqiraj – Të lutem, nuk të ndërhyra!

Albana Vokshi - Më ke ndërhyrë gjithë ato herë!

Ismet Beqiraj - Ti u ndërhysh të gjithëve. Ja dhoma e zhveshjes, ...

Valentina Duka– Zoti Ismet, aktor je ti?

Ismet Beqiraj - Aktor jam!

Valentina Duka – I dimë këto të gjitha, pse na i tregon?

Ismet Beqiraj – T’i dini. Ja pse duhet nga themelet. Dëgjoni. Ironia më e madhe, vëllezër....

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për sigurinë e aktorëve.

Valentina Duka – O Ismet, ke qenë ndonjëherë vetë atje?

Ismet Beqiraj - Të lutem, mos ndërhysh! Duroni! Është ende sistemi i mbrojtjes, ku thuhet: “50-vjetori i shpalljes së pavarësisë të Shqipërisë”.

Albana Vokshi – Po. Edhe?!

Ismet Beqiraj – Ja, në këto rrënoja

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Valentina Duka – Ismet, nuk janë rrënoja ato, janë pjesë e trashëgimisë historike.

Ismet Beqiraj – Ja pjesa nën skenë.

Albana Vokshi – Ismet, ku i keni çuar 2,5 milionë eurot e grantit grek?

Ismet Beqiraj – Atje ku i keni çuar ju ato 4 milionë eurot këtu te Piramida, pas kurrizit tone.

Albana Vokshi – E ke recituar shumë bukur. Çfarë bëri ministrja për 5 vjet?

Ismet Beqiraj – Ja ku e ke skemën.

Albana Vokshi - E pamë si doktor Adhamudhi “prijë që të shpëtosh”.

Ismet Beqiraj – Siguria, standardet, ja këto mure që mbajnë jashtë mase, ja si është situata! Ja ku e ke situatën e mureve.

Albana Vokshi - E ke treguar, e tregoi edhe inxhinieri, badigardi i Erionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Unë shpreh dhe mbështes mendimin e specialistëve, nuk dua të bëjmë politikë. Kujt i dhemb më shumë arti dhe kujt i dhemb më pak. Të gjithëve na dhemb arti, të gjithë e duam artin, por unë mbështes mendimin e specialistëve, inxhinierëve, arkitektëve dhe të specialistëve të Institutit të Ndërtimit, të Inspektoratit të Monumenteve të Kulturës.

Albana Vokshi – (tregon foto) Ta tregoj përsëri, e ke opera në vitin 1941?

Shikojeni pak. Ja mbyllja e një koncerti, shikojeni pak shfaqjen me valle kostumesh në '40. Ja për këtë flasim ne. Ja ku e ke Ernest Koliqin në '42, për përrurimin e ambienteve.

Ismet Beqiraj – Ne nuk duam të mbetemi në një rrënojë jashtë standardeve dhe konfortit, që duhet të plotësojë dhe, mbi të gjitha, të sigurisë.

Albana Vokshi - Në qoftë se ju nuk e doni historinë e Tiranës, ne e duam, se këtu jemi rritur.

Ismet Beqiraj – Ty nuk të dhemb fare, se në qoftë se të dhembnin pronat e Tiranës, nuk krijonit zona informale!

Albana Vokshi - Siç të dhemb ty Mallakastra, mua më dhemb Tirana.

Ismet Beqiraj – Mua më dhemb Mallakastra, Shqipëria, edhe vendburimet e naftës, edhe të mineraleve.

Albana Vokshi - Mua më dhembin të gjitha ato figura të shquara, që e kanë nisur këtu aktivitetin.

Ismet Beqiraj – Albana, është hera e parë që diskutohet një marrëveshje dhe që në fillim ka negociim dhe lidhje kontrate. Ky është objekti. Është shitur pasuria, janë dhënë koncesionet dhe ju e dini shumë mirë, të gjitha të dështuara, të pasurisë kombëtare. Kujt i ka dhembur?! Asnjërit. Unë po flas edhe për koncesionet e naftës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonjë, janë një pasuri prej miliarda dollarësh, që ju nuk i keni llogaritur ndonjëherë. Moj zonjë, pse paragjykon?!

Albana Vokshi – Pse nuk i prishe? Se me atë erdhe në qeveri, prishi pra!

Ismet Beqiraj - Ai që është për t'u prishur, do të priset dhe duhet të priset në këtë situatë që është, sepse do të zëri fëmijët tanë.

Albana Vokshi – Çfarë po thoni?!

Ismet Beqiraj – Ju, si kryetare, do të jeni e para, që do të merrni gocat dhe do të vini atje kur të bëhet teatri i ri, ashtu siç do të shkoni te stadiumi.

Albana Vokshi – Kam shkuar me vajzat e mia dhe do të shkoj, sepse nuk e prishni dot kollaj ju, kushdo që t’ju urdhërojë, sado fitim që të ketë aty, nuk e prishni dot kollaj. Vetëm duke kaluar mbi trupat e qytetarëve mund ta prishni, sado ti me votën tënde, të votosh për shkatërrimin.

Ismet Beqiraj – Ju doni “Suden” dhe VEFA-n!

Milva Ekonomi – A do të vazhdojmë për procedurë?

Albana Vokshi – Ne flasim për art dhe kulturë, ti flet për “Suden”!

Musa Ulqini – Zonja kryetare, për sa kohë që ju u shprehët shumë qartë, që jeni kundër, është e drejta juaj që të jeni 100% kundër me projektin. Ndërkohë, te çështja e procedurës, ju përsëri ngatërroni diskutimin në parim me shqyrtimin nën për nën. Në bazë të precedentëve dhe në bazë të kësaj Rregulloreje, kur ju jeni kundër, ju keni të drejtë të paraqisni një alternative. Ka raste kur opozita ka të drejtën e saj, është kundër buxhetit të shtetit, por paraqet një projekt alternativ.

Albana Vokshi – E paraqitëm, por nuk ishte këtu ti, Musa. Ti po flet, kur ke dy orë që nuk ke qenë fare këtu dhe nuk e di çfarë kemi diskutuar.

Musa Ulqini – Këtu mungon projekti alternativ. Ju thjesht jeni kundër.

Albana Vokshi – Ne e kemi pasur shumë konstruktive. Më vjen keq, por ti nuk paragjykon dot.

Musa Ulqini – Unë nuk paragjykoj asgjë.

Albana Vokshi – Po të ishte këtu i vëmendshëm, do t’i kishe dëgjuar.

Musa Ulqini - Pra, një variant është kur ne diskutojmë edhe për çështje të caktuara, që janë nga këto gabimet ortografike, për të cilën ish-kryetari i komisionit shkëlqen, dhe është kontribut i tij i padiskutueshëm në historinë e parlamentarizmit ose kur ka gjëra teknike, ka mirëkuptim, rregullohen nene të caktuara e të tjera. Ky është një diskutim normal. Ky diskutim normal nuk është në këtë rast. Flas gjithmonë për procedurë.

Varianti tjetër është kur opozita ka të drejtën e saj, që për një çështje të caktuar, për një projektligj, qoftë edhe për buxhetin e shtetit, paraqet projektin e saj alternativ. Në këtë rast nuk jemi, nuk ekziston një rast alternativ. Ju jeni te rasti që jeni totalisht kundër, është e drejta juaj të bëni komentet tuaja, nuk kam asnjë koment nga këto që bëni ju. Keni 5 ditë që e hidhni poshtë, kuptohet në emër të interesit publik, dhe ne, në emër të interesit publik, e mbrojmë. Ky rasti i tretë, kur edhe jeni kundër, edhe do ta votoni kundër, edhe nuk keni alternativë...

Albana Vokshi – Çfarë ju shqetëson juve? Ne po diskutojmë nen për nen. Edhe këtë do të na i ndaloni?

Musa Ulqini – Në këtë rast ligjvënësit, përvoja parlamentare, e ka zgjidhur në këtë mënyrë në Shqipëri dhe në të gjithë botën, e ka zgjidhur që vazhdohet të respektohet ajo që thotë Rregullorja. Domethënë, hidhen nenet në votim, mbaron diskutimi, pra ka shqyrtim.

Albana Vokshi - Ne po diskutonim nen për nen, por nuk ishte këtu. Ishim te neni 2 dhe 3.

Musa Ulqini – Ju keni të drejtë edhe të veproni në këtë mënyrë, por thjesht nga pikëpamja procedurale, procedurat parlamentare këto njohin.

Albana Vokshi – Nuk e di se çfarë njeh ti, por vazhdojmë diskutimin nen për nen.

Musa Ulqini – Unë njoh procedurat parlamentare. Kjo që po bëni ju, nuk ka lidhje fare me procedurën parlamentare.

Albana Vokshi – Ju keni 2 orë që nuk jeni fare në këtë sallë dhe nuk e dini fare se çfarë kemi diskutuar. Të vini pas 2 orësh, që nuk jeni fare, dhe të thoni “nuk po ndiqni procedurën”?!

Musa Ulqini - Unë kam qenë pas derës, sepse kam një hall timin familjar dhe çdo njeri ka halle. Uroj që të mos e kesh ti, por kam qenë aty pas dere dhe kam dëgjuar çdo gjë.

Albana Vokshi – Duhet të kishe dëgjuar që i kemi diskutuar nen për nen.

Musa Ulqini – Për t’ju respektuar ju, kam dalë atje që të mos bëja zhurmë. Nuk dua të bëj komente dhe debat për këto gjëra. Jam i distancuar nga ky lloj debati, thjesht po flas për procedurë, sepse ju nuk jeni kontribues për projektin në fjalë dhe nuk keni alternativë, por jeni vetëm kundër. Kur ju jeni kundër, e shprehni shumë qartë dhe keni argumentet tuaja, për të cilat unë ju respektoj, pavarësisht se nuk bie fare dakord as për argumentet dhe as për mënyrën se si i shprehni. Rregullorja e ka rregulluar këtë dhe neni atje respektohet saktësisht, shqyrtohet dhe votohet. Kaq.

Albana Vokshi – Ne jemi te fjala “Shqyrtim nen për nen.” Nëse t’i e definon ndryshe fjalën “shqyrtim”, hajde...

Po, zoti Pollo.

Genc Pollo – Meqë kolegu parafolës më përmendi indirekt, unë dua t’i them dy-tri gjëra. Nëse keni durimin të më dëgjoni si joanëtar i këtij komisioni, sepse çështja, përtej humorit që bëhet herë pas here, i detyruar nga mbledhjet e gjata, në thelb është shumë e rëndësishme. Me të drejtë kolegu kërkon që opozita, e cila në këtë rast mund të mos bjerë dakord, të paraqesë një alternativë tjetër. Mendoj se kolegët e opozitës e kanë bërë këtë, por unë do të përpiqem ta formuloj sipas mënyrës sime pse nuk bie dakord. Unë kam dy arsye kryesore.

Së pari, sepse çdo shoqëri, çdo popull, çdo komb ka një histori të veten, e cila formon identitetin dhe ndihmon të hapë rrugën përpara, duke e orientuar vetë dhe duke ruajtur trashëgiminë kulturore, që është thelb i identitetit. Shumëkush mund të ketë thënë se ato dy godina janë pavlerë. Në fakt, informacioni nuk është i tillë, pasi ato janë të rëndësishme për historinë shqiptare, por unë e pranoj që, edhe pse pretendoja që dija shumë, kam mësuar shumë më tepër nga leximi i një artikulli të botuar dje nga profesor Aurel Plasari, që pasuroi njohuritë e mia dhe të çdokujt që e ka lexuar ose që do ta lexojë, për rëndësinë që kanë Teatri Kombëtar dhe Teatri Eksperimental për historinë e Shqipërisë, për historinë politike, kulturore dhe historinë e kërkimit shkencor. E pranoj që nuk e dija se aty ishte zhvilluar një pjesë e mirë e jetës politike, kulturore dhe e kërkimit shkencor në periudhën e Zogut, gjatë viteve '30, në periudhën e luftës, në periudhën e komunizmit dhe më vonë. Aty ka edhe aspekte negative të periudhës së pushtimit nazifashist dhe të periudhës së komunizmit. Gjatë periudhës së parë, asaj nazifashiste, shohim adhurimet e papranueshme në parim për fashizmin. Gjatë periudhës së dytë, asaj komuniste, janë gjyqet që janë bërë ndaj figurave politike të rëndësishme, por në mënyrë të paduhur. Këtu kujtoj edhe kinema “17 Nëntorin”, që duhet të ishte ruajtur për historinë që përfaqëson. Çdo vend ka pjesët e ndritura dhe të errëta të historisë, por që brezat të njohin të dyja anët e historisë dhe të orientohen nga ana e duhur, duhet të ruhen, duhet të kultivohen, të shpjegohen, të përfshihen në kurrikula shkolle dhe të bëhen objekte vizitash, që shoqëria të ndërgjegjësohet për të mirën dhe për të keqen. Duke i shkatërruar këto dy godina, Shqipërisë dhe shoqërisë shqiptare i mohohet një pasuri materiale në kuptimin e thelbit historik. E thashë dhe po e përsëris për të tretën herë, që në ato dy godina është zhvilluar një pjesë shumë më e rëndësishme se ç’kujtoja unë e jetës politike, e jetës kulturore dhe e kërkimit shkencor. Kjo është arsyeja e parë pse opozita e kundërshton.

Diskutimi i kolegut tonë të Grupit të PD-së, Hekuran Hoxhollit, më ndihmoi shumë për të kuptuar anën korruptive. Ne flasim shumë për korrupsion, por shifrat konkrete janë të nevojshme për të na sqaruar. Këtu, në një mënyrë ose në një tjetër, me ligj të veçantë, por edhe po të ishte ligji i koncesioneve, edhe sikur të interpretohej në mënyrë të leverdisshme Kodi Civil, kemi të bëjmë me një transferim të pronës publike në administrim të qeverisë qendrore ose në administrim të bashkisë ndaj një kompanie të paracaktuar në zëmër të Tiranës, ku çmimi i tregut sot është 2500 euro për metër katrorë për apartamentet dhe, me sa kam lexuar, rreth 6000 euro për dyqanet. Vendimi i qeverisë ia jep kësaj kompanie private me çmimin 470 euro.

Kolegu Hekuran Hoxholli, si ndërtues me përvojë, bëri llogarinë dhe nxori si konkluzion se pas shitjeve dhe para taksave, kompania, emri i të cilës figuron në projektligj, fiton 205 milionë euro. Se çfarë do të bëjë me këto para, si do t'i investojë, ku do t'i ndajë, do të shkojnë për vota apo për gjëra të tjera, ne mund t'i marrim me mend, por nuk i themi dot. Pra, me një akt zyrtar, jo me punë, jo me biznes, jo në kushtet e konkurrencës, jo me investim vetjak apo me kredi bankare, por thjesht me një akt shtetëror, mund të ishte urdhër i kryetarit të bashkisë, mund të ishte VKM, por për fatin tonë të keq, për turpin e kolegëve që do ta votojnë dhe për turpin e atyre që s'do të mund ta ndalojnë dot, ky është një akt i pastër që transferon nga prona publike, me vlerë potenciale, kur të zhvillohet, 205 milionë para taksimit, të cilat i merr privati i paracaktuar. Kjo është arsyeja e dytë madhore pse e refuzoj këtë projektligj.

Tani të kalojmë tek alternativa se si duhet të zhvillohet teatri. Ndoshta edhe formulimi i opozitës nuk ka qenë i qartë, sepse debati nuk është akoma shterues, por, në qoftë se përmendim teatrin “Turbina”, që u mundësua nga fondi i palës greke, i cili i është dhuruar ministrisë së Arsimit, por pati procedura të gjata dhe, me sa jam informuar unë, u ndërtua dhe u inaugurua para dy ditësh, nuk më rezulton se ajo është një sallë teatrore me parametrat dhe standardet që ka teatri, por, me sa pashë në televizor, ajo është një sallë moderne për tubime të ndryshme artistike, muzikore, ndoshta edhe teatrale, pa përmbushur kushtet e Teatrit Kombëtar. Nuk mund të kritikojë apriori njeri pse u bë ky investim, sepse Tirana nuk duhet të ketë vetëm tri salla, por në një vend, ku popullsia e të cilës po rritet çdo ditë dhe me pretendimet artistike që duhet të ketë një qytet, ajo ka nevojë edhe për shumë salla të tjera.

Propozimi im konkret është që të mos biem te dy gabimet e para, tek akti i madh korruptiv dhe shkatërrimi i një prone të rëndësishme për kujtesën kombëtare dhe trashëgiminë kulturore. Ato dy salla, që dikush nga ju tha se janë të parestaurueshme, mund të restaurohen, sepse, po të pyesësh teknikë seriozë, nuk rezulton kështu. Unë e di që restaurimi i sallave ka shpenzimet e veta, por pse nuk gjenden 20, 25 milionë lekë për restaurim, në mënyrë që të ruhen trajtat e godinave ekzistuese për vlerat historike që ata kanë? Në atë sipërfaqe mund të ndërtohet një godinë e tretë me standarde teknike më të larta se “Turbina”. Po të hapet një garë midis urbanistëve, arkitektëve dhe specialistëve, mund të dalin me propozime edhe më të mira se këto që thashë unë, por unë bëra vetëm një tentativë. Në qoftë se kërkon alternativë nga opozita, mos kërkon detajim teknik të saj, por shikoni përcaktimin parimor, i cili me paratë e buxhetit, ku ne do të ishim dakord edhe që ta rrisim pak taksën, të bëhet një zgjidhje dhe të ruhen këto dy godina, të ndërtohet një e tretë me

sallë të përshtatshme për shfaqje teatrale. Përderisa ka hapësirë për dy salla, besoj se mund të ketë edhe për një të tretë, duke shtuar “Turbinën” dhe në të ardhmen edhe një sallë tjetër. Argumentimi ynë, që të gjitha gjërat po i përqendrojmë te sheshi “Skenderbej” dhe sheshi “Nënë Tereza” qëndron. Për fat të mirë po hapet edhe pjesa tjetër e Tiranës, nga ish-stacioni i trenit në drejtim të Veriut, ku mund të ketë nevojë dhe hapësirë për godina kulturore, si, për shembull, teatrot që mund të ndërtohen. Në qoftë se s’ka buxheti fonde për ndërtimin e këtyre godinave, mund të merren hua dhe mund të gjendet një zgjidhje, por mjafton të biem dakord në parim që t’i ruajmë këto, të mos biem në vepra, që për shkak të shifrave që unë përmenda, janë qartazi korruptive dhe, pastaj, me dëshirën e mirë për të krijuar ambientet për teatrin dhe për artin e skenës bashkëkohore, mund të gjendet një zgjidhje kudo në Tiranë. Këto kisha unë.

Faleminderit, zonja kryetare!

Musa Ulqini – Zonja kryetare, faleminderit!

Shumë faleminderit, zoti Pollo, që për gjithçka që unë kam thënë këto tri herë, të më aprovosh edhe një herë.

Në gjykimin tim, jo për çështje nostalgjie, por ky ishte diskutimi më i mirë që unë kam dëgjuar nga opozita për këtë çështje në parim. Ky ishte një diskutim pa fyerje dhe që lidhet me thelbin e çështjes. Ju shtruat argumentet tuajat, disa të tjera i morët nga njerëz të fushës dhe, në këndvështrimin tim, ky është një diskutim i shkëlqyer dhe i respektuar nga ana e opozitës. Edhe pse unë jam kundër argumenteve tuaja, dua të them se ka një përpjekje nga ana juaj për të paraqitur një alternativë, por kjo është një çështje që diskutohet në parim. Kur unë dhashë një alternativë, ishte në pikëpamje të këtij projektligji. Procedura që duhet të ndjekim për një projektligj është që të dyja palët të bëjnë më të mirën, ose njëra palë e hedh kundër dhe paraqet një alternativë tjetër dhe nuk ka rrugë tjetër.

Diskutimi juaj është një diskutim i shkëlqyer i opozitës. Unë jam totalisht kundër, por ju sollët fakte dhe argumente të konsultuara dhe nuk kishte asgjë që të na irritojë ne si palë tjetër, përkundrazi, diskutimi juaj më pëlqeu shumë, por i përket diskutimit në parim. Tani jemi te shqyrtimi nen për nen, që i përket një çështjeje tjetër dhe i gjithë diskutimi që bëri opozita në emër të interesit public, nuk i përket kësaj situatë ku jemi tani.

Gjatë viteve 1992, 1994, 1996, 1997 dhe 1998 ky komision ka kaluar situata të rënda dhe është përdorur ky mekanizëm, por për shkak të mungesës së përvojës parlamentare, gjërat ishin parashikuar deri në detaje për të zgjidhur këto ngërçe.

Ne marrim përgjegjësitë që kemi dhe i kemi shprehur edhe në diskutimet në parim.

Albana Vokshi – Zoti Ulqini, i jeni referuar Rregullores 20 herë dhe ju siguroj se nuk është shkelur asnjë germë e Rregullores, por po vazhdojmë me shqyrtimin nen për nen. Jua thashë edhe një herë, që kemi lexuar nenin 2, e kemi diskutuar, madje zonja Malaj dha një sugjerim se si mund të ndryshojë, pavarësisht se ishte kundër. Ne kemi diskutuar edhe për nenet 1, 2, 3...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atë po bëj, shqyrtimin e ligjit. Nuk e kuptoj se çfarë quan shqyrtim?! Me këto ndërhyrje që po bëni ju, po na pengoni edhe më shumë dhe po kthehemi në pikën fillestare. Ne po diskutonim çdo përkufizim nëse bie ndesh ose jo me Kushtetutën dhe me ligjet, dhe për çdo përkufizim kemi pyetur drejtorët. Ky është shqyrtimi që i bëhet çdo pike të nenit, por, në qoftë se nuk ju pëlqen, më vjen keq! E di që ju bezdis fakti që po ju marrim kohë, por na keni lënë vetëm dy ditë për të shqyrtuar këtë projektligj. Në shkelje të Rregullores e keni futur në seancë plenare, e keni miratuar vetëm me forcën e kartonit dhe do të marrim kohën e duhur për të shteruar problemet që ne kemi. Ne e dimë shumë mirë se si janë punët, por kjo është për të sqaruar publikun se ku janë shkeljet ligjore që ju po bëni. Të caktoni vlerën e një trualli në mes të Tiranës me 470 euro metri katrorë, nuk e di se çfarë është kjo.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Cili ligj e ka? Cila VKM? Aty nuk ka vlerë të caktuar.

Fidel Ylli – Në qendër të Tiranës aq është.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Këtu jemi në rregull. Kur je ti në rregull, që ti thua se ke ardhur thjesht për të më respektuar, se nuk je anëtar i komisionit, atëherë...

Ne e kemi për detyrë dhe këtë punë kemi sot deri në orën 12 të natës.

Albana Vokshi – Atëherë, meqenëse kishim debatin me drejtorin, dua t'u rikthehem kompetencave që ky ligj, në shkelje të Kushtetutës, neneve 13 dhe 113, i merr pushtetit vendor, si dhe nenit 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak”. Po ia lexoj drejtorit, meqenëse tha se nuk shkelet.

“Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak”: “Këshilli bashkiak miraton tjetërsimin dhe dhënien në përdorim të pronave të të tretëve”, gjë që ky ligj ia merr.

Kalojmë më poshtë.

Neni 55 thotë: “Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit” dhe në rastin konkret, te germa “e” e nenit 54, ju ia rrëmbeni këtë kompetencë, në shkelje të neneve 13 dhe 113 të Kushtetutës. Ia merrni kompetencat këshillit bashkiak! Pra, ju po ia merrni pronën këshillit bashkiak dhe po ia jepni një kompanie, që ju thoni kompanisë “Fusha sh.p.k”, që është në kufi, madje që nuk dihet edhe sa jep!

Shqetësimi ynë është që ju, me të dyja këmbët, po shkelni Kushtetutën! Ju, me të dyja këmbët, po shkelni nenet që unë po ju citoj!

Për më tepër, ju shkelni edhe nenin që flet për truallin shtetëror, sepse as nuk mund ta tjetërsosh, as ta shesësh. Nuk të lejon ligji në këtë rast!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne po ju themi: tërhiqeni, mos i shkoni më tej kësaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si “nëse”?

(Deputetja Xhembulla flet pa mikrofon.)

E ke të caktuar, Almira, e ke të shkruar e zeza mbi të bardhë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Almira, çfarë do të shpjegosh? Ia heq kompetencën këshillit bashkiak dhe i thotë komisionit të negocimit, që nuk është këshill bashkiak: “merre ti në dorë, merr asetet, merr pronën publike, qoftë të qeverisjes qendrore, qoftë të qeverisjes lokale...”

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...dhe komisionit të negocimit i thotë: “Ti ke të drejtë ta tjetërsosh këtë, në shkelje”...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sapo jua lexova. Doni t’jua lexoj edhe një herë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, Jorida.

Milva Ekonomi – Ta dëgjojmë edhe një herë djalin të japë përgjigje, sepse kam përshtypjen që ai na e shpjegon dhe ne nuk duam ta kuptojmë?!

Albana Vokshi – Fjalën do ta marrë Jorida, se atë djalin e dëgjuam.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jorida Tabaku – Po ju ndiqja *live* dhe nuk rrija dot në shtëpi, kur dëgjoja një makabritet të tillë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, nuk ka pse t'ju shpëtoj unë, por të them të paktën mendimin tim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe në nenin 3...

Albana Vokshi – Meqenëse ju keni qenë kryetar, zonja Tabaku ka qenë nënkryetare bashkie, por meqenëse ju nuk flisni për shkeljen e kompetencave të këshillit bashkiak, flasin...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jorida Tabaku – Një sekondë, të mbaroj!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Lëreni tani zonjën Tabaku të flasë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jorida Tabaku – Edhe në nenin 3, edhe në nenin 4, kur flisni për pronën, vendosni në dispozicion pasuritë e paluajtshme në pronësi shtet, që janë edhe të Bashkisë së Tiranës, edhe të Ministrisë së Kulturës, që administrohen nga drejtoria përkatëse e Ministrisë së Ekonomisë.

Përpara se të vendosen në dispozicion, duhet të japë autorizim këshilli bashkiak me tre të pestat. Nuk mund ta jepni në dispozicion, të cenoni autoritetin e këshillit bashkiak dhe të merrni...

Milva Ekonomi – Lexo pak më poshtë.

Jorida Tabaku – Po, po.

Albana Vokshi – Një sekondë, zonja Ekonomi!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – ...se nuk është pjesë-pjesë ajo.

Jorida Tabaku – Një sekondë!

Albana Vokshi – Jemi te neni 3, Milva!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Lëre, se po flet për nenin 3!

Milva Ekonomi – Më poshtë e ke se si shkon...

Albana Vokshi – Zonja Ekonomi...!

Jorida Tabaku – Unë nuk ju ndërpres asnjëherë.

(Deputetet Ekonomi dhe Tabaku flasin njëkohësisht.)

Milva Ekonomi – Është një argument që përsëritet, është i stërthënë, i stërdiskutuar...

Jorida Tabaku – I stërthënë është...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva, edhe planifikimi urban është cenim i autonomisë vendore.

Albana Vokshi – Po, është cenim i autoritetit.

Jorida Tabaku – Edhe vënia në dispozicion e pronës është cenim i autonomisë vendore.

(Diskutime në sallë.)

Albana Vokshi – Qetësi, ju lutem!

Jorida Tabaku – Ka vendime të Gjykatës Kushtetuese për këtë.

Në qoftë se doni ta bëni me patjetër kështu siç e keni bërë, merrni autorizim nga këshilli bashkiak i Tiranës dhe silleni. Vetëm atëherë keni të drejtë ta vendosni në dispozicion, por pa marrë autorizimin nga këshilli bashkiak i Tiranës, nuk mund të cenoni autonominë e tyre vendore.

E keni miratuar vetë ligjin. Ne nuk ishim dakord, ne kishim kundërshtitë tona, ndërkohë që ju e keni miratuar vetë!

Edhe planifikimi urban, edhe zhvillimi urban është në dorë të këshillit bashkiak të Tiranës. Kur ato t’ju autorizojnë, silleni këtu!

Kështu siç e keni sjellë, shkel Kushtetutën dhe një ligj me shumicë të cilësuar!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Po.

Fatmir Hoxhaj – ...10%, ndoshta 2100 metra nga 8000 metra janë të bashkisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ky ligj nuk përplasit në asnjë dispozitë me ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”, sepse komisioni ndërministror, që do të ngrihet me vendim të Këshillit të Ministrave, do të jetë me kryesimin e Bashkisë së Tiranës, pra do të caktohet nga këshilli bashkiak, sepse bashkia përfaqësohet nga këshilli, jo nga kryetari. Kryetari autorizohet nga këshilli dhe ky i fundit mund të vendosë të autorizojë kryetarin e bashkisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...ose një person tjetër nga Bashkia e Tiranës.

Jorida Tabaku – Këshilli ka marrë vendim për këtë pronë?

Fatmir Hoxhaj – Një sekondë, t’jua shpjegoj!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Nuk është kështu siç duket.

Fatmir Hoxhaj – Ta lexoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Albana Vokshi – Juve po ju dëgjojmë me shumë kujdes.

Fatmir Hoxhaj – Nuk i hyj pjesës nëse duhet ose jo të shembet, statusit, se nuk e di këtë...

Albana Vokshi – Jo, jo, nuk jeni për atë punë juve, ju na sqaroni këtë pjesën!

Fatmir Hoxhaj – Çfarë ndodh? Do të vihen në dispozicion të zhvillimit të kësaj zone tetëmijë metra katrorë ose tetëmijë e ca metra.

Albana Vokshi – Është 8500 e ca metra.

Fatmir Hoxhaj – Kjo do të thotë se partnerit privat nuk do t'i jepet e gjithë pjesa apo i gjithë territori, por do t'i jepet në raport me atë çfarë do t'i japë shtetit partneri privat pas ndërtimit dhe dorëzimit të çelësave të Teatrit; do të marrë pjesë nga territori.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, duke u vlerësuar nga ekspertë me njohuri të posaçme në këtë fushë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ndodh kjo.

Nëse ky territor i përket territorit që është pronë e bashkisë, atëherë do të jetë Bashkia e Tiranës, këshilli bashkiak efektivisht, që do ta marrë vendimin nëse do t'ia japë këtë truall, këtë pjesë, partnerit privat ose jo.

Albana Vokshi – Më falni, ju e keni parë projektin e “Fusha”-s? A e keni parë ju projektin? A jeni pjesë e grupit të punës?

Fatmir Hoxhaj – Personalisht nuk jam pjesë e grupit të punës. Unë përfaqësoj Ministrinë e Financave për shkak të të qenit përfaqësues i pronarit të pronës shtetërore.

Albana Vokshi – Po.

Fatmir Hoxhaj – Pra, Ministria e Financave e ka tagrin me ligj...

Albana Vokshi – Tani ju po thoni që ne po ia lëmë një herë në dispozicion edhe tokën e bashkisë...

Fatmir Hoxhaj – Për ta zhvilluar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Albana Vokshi – Po pra, pa marrë autorizimin...

Fatmir Hoxhaj – Është bashkia që administron territorin, që e lejon atë.

Albana Vokshi – ...e këshillit bashkiak, unë po ia vë në dispozicion...

Milva Ekonomi – Jo, nuk po thotë këtë gjë.

Albana Vokshi – Atë tha, pra!

Fatmir Hoxhaj – Pjesën e shtetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Të lutem tani, Milva!

Po ia përkthej dhe...

Fatmir Hoxhaj – Për ta zhvilluar, thamë, jo për ta shkëmbyer.

Albana Vokshi – Ju po ia vini në dispozicion privatit...

Fatmir Hoxhaj – Për zhvillim.

Albana Vokshi – Dakord, por pa marrë autorizimin e këshillit bashkiak...

Fatmir Hoxhaj – Zonja kryetare...

Albana Vokshi – ...duke thënë: “Prit, se do të ndërtohet një herë teatri dhe mund të mos ia jap unë këto 2500 metrat e këshillit bashkiak”. Këtë po thua? Që ta kuptoj unë mirë.

Fatmir Hoxhaj – Duhet të vendosë këshilli bashkiak nëse do t’ia japë ose jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sepse është këshilli bashkiak ai që do të vendosë për territorin që e ka në pronësi.

Albana Vokshi – Po pra, e ke pasur këtu në nen, por e ke hequr.

Fatmir Hoxhaj – Kjo i përket një faze tjetër...

Albana Vokshi – Jo, nuk është.

Fatmir Hoxhaj – ...të mëvonshme.

Albana Vokshi – Jo pra, e ke pasur në variantin e parë!

Jorida Tabaku – Kjo nuk bëhet pa e autorizuar këshilli bashkiak.

Fatmir Hoxhaj – Po pra, e ka. Ja ku e ka neni 5 i ligjit: “Komisioni kryesohet nga përfaqësuesi i autorizuar nga bashkia”, që do të thotë nga këshilli, jo nga kryetari.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kryetari është autoritet nominal.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Edhe te neni 3, edhe te neni 4.

Jorida Tabaku – Po pra, ku e ke vendimin e këshillit bashkiak...?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Hoxhaj – E shpjegon. Do të vazhdojë historia, do të vazhdojnë negociatat.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Ja çfarë thotë neni 4, t’jua lexoj: “Në dispozicion të zhvillimit të projektit”...

(Deputeti në fjalë flet pa mikrofon.)

Jorida Tabaku – Me çfarë vendimi?

Ismet Beqiraj – Sipas ligjit, Kodit Civil, legjislaturës për pronat e paluajtshme...

(Deputetja Tabaku dhe zoti Hoxhaj flasin njëkohësisht edhe me mikrofon, edhe pa mikrofon.)

Pse nuk kap edhe këtë tjetrën, të lutem?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shumë mirë që të ka shqetësuar.

Jorida Tabaku – Legjislatura është vendimi i këshillit bashkiak.

Ismet Beqiraj – Sipërfaqja që përbën pronën e Teatrit Kombëtar do të jetë po ajo pas përfundimit të ndërtimit të Teatrit Kombëtar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pse nuk e lexon, të lutem?

Albana Vokshi – Ke nenin 3, autorizimin...

Ismet Beqiraj – Pse nuk lexon nenin 7 “Procedura e negocimit” për lidhjen e...?

Albana Vokshi – Lexo pikën 1 të nenit 3.

Ismet Beqiraj – Si?

Albana Vokshi – Autorizimi i komisionit të negocimit...

Ismet Beqiraj – Pika 1 e nenit 3 është përkufizim.

Albana Vokshi – Po, përkufizim. E, çfarë, nuk futen në ligj përkufizimet, apo hajde t’i heqim?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Lexoje pra!

Ismet Beqiraj – Përkufizimet janë terminologjia juridike që e përshkruan ligjin nga neni 1 deri te neni i fundit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – “Tagri që gëzon komisioni për të përfaqësuar...

Ismet Beqiraj – Është terminologji juridike, Albana, nga neni 1 deri tek i fundit!

Albana Vokshi – ...pronarin shtet me të drejta të plota për të vlerësuar dhe tjetërsuar pronat në pronësi...

Ismet Beqiraj – Ai është përkufizim.

Albana Vokshi – ...në pronësi të pushtetit qendror dhe vetëqeverisjes vendore për zhvillimin e këtij projekti”.

Dëgjo, tani!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Po mirë, ti bën edhe diellin, edhe shiun xhanëm, bëhesh specialiste për të gjitha gjërat! Jepi!

Albana Vokshi – E autorizon komisionin e negocimit që t’u bëjë vlerësimin aseteve të pronës që ka pushteti qendror dhe ai vendor, dhe i thotë t’i tjetërsojë.

Ismet Beqiraj – Albana, që te qëllimi i këtij ligji, ky përcakton procedurat për negocim.

(Deputetja Rista flet pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Nuk e bën dot përfaqësuesi i bashkisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Edhe kriteret për lidhjen e kontratës.

Adelina Rista – Prej tij kryesohet komisioni.

Albana Vokshi – Nuk e bën dot, pa autorizim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Më lër ta interpretoj unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po te përbërja e komisionit, që janë pesë institucione, janë edhe ekspertë, edhe dy përfaqësues të komunitetit të artistëve...

Albana Vokshi – Po edhe?

Ismet Beqiraj – ...dhe të aktorëve, urdhëro, këto pesë institucione: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Kulturës dhe Avokatura e Shtetit, mbrojnë tërësisht frymën e ligjit.

Albana Vokshi – Jo ore?!

Ismet Beqiraj – Po, po.

Albana Vokshi – Ku ka ligj këtu që mbron kjo? Kjo i shkel të gjitha ligjet!

Ti, shiko, prona shtetërore, prona e paluajtshme e shtetit, pushteti qendror dhe vendor që i vihet në dispozicion zhvillimi i këtij projekti, thotë dhe vazhdon: projekti është i propozuar nga kompania “Fusha”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – A mundem për procedurë?

Albana Vokshi – Projekti, ndërtimi i godinës së re të Teatrit Kombëtar, zhvillimi i zonës ndërmjet rrugëve “Abdi Toptani”, sipas propozimit të paraqitur nga privati.

Ismet Beqiraj – Ju e privatizuat!

(Deputetja Tabaku flet pa mikrofon.)

Kur keni dhënë koncesionin.

Shumë gabim!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Keni shkatërruar pasuritë kombëtare të popullit shqiptar!

Jorida Tabaku – Kam një propozim për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ju lutem!

Fjalën e ka zonja Tabaku.

Jorida Tabaku – Meqenëse zonja Ekonomi thotë se kemi pesë orë që diskutojmë të njëjtën gjë, propozimi nga ana jonë është...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të shtojmë diçka te neni 4, por edhe te pika 1 e nenit 3, përpara fjalëve “vendosjes në dispozicion” të shtojmë fjalët “marrjen e autorizimit nga këshilli bashkiak i Tiranës”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Çfarë të keqeje ka?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Të lutem!

Zonja Tabaku...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Jo, mor jo, propozimi është...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...komisioni i negocimit nuk ka asnjë tagër për tjetërsim prone, pikë, mbaroi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Edhe unë këtu, ua sugjerova kolegëve të mi, ndërsa këta që janë kundër thanë: ne kemi dhënë mendimet tona, nuk shtojmë asgjë, sepse bëhemi palë me ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ja, ky është një lajm pozitiv!

Jorida Tabaku – Zonja Ekonomi, të ndryshojë komplet filozofija, pra!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sepse kjo që po bëni ju, është e jashtëligjshme, apo jo, zonja Vokshi?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Problemi është të vazhdojmë të diskutojmë për nene dhe të votojmë nene, siç e...

Jorida Tabaku – Nuk e votoni dot, sepse që te neni 1 duhet ndryshuar përmbajtja.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është antikushtetues që te neni 3.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – E votuan antikushtetutshmërinë, pra!

Nenin 2, përsëri e votuan, në antikushtetutshmëri!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Komisioni i negocimit nuk mund të ketë tagër tjetërsimin!

Milva Ekonomi – Atëherë, të caktojmë një relator, që sikurse ju, edhe ne e kemi caktuar, por nuk e kemi shpallur herën e kaluar. Ne kemi caktuar zotin Fadil Nasufi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e di kë keni caktuar relator nga pala juaj.

(Deputeti Pollo flet pa mikrofon.)

Urdhëroni?

(Deputeti Pollo flet pa mikrofon.)

Po pra, po, ndërkohë problemi është që ne duhet ta hedhim në votim çdo nen!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E filluam këtë gjë dhe thamë që për çdo nen duhet të ketë një riformulim.

Por, ndërkohë që ne thoshim: formulimi im, formulimi juaj, hajde ta votojmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Paskëtaj, u shtrua problemi që meqenëse ju jeni kundër në parim, jeni kundër edhe nen për nen. Tani, ne vijmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kështu që tani jemi në një situatë, ku duhet të marrim një vendim se çfarë do të bëjmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Milva, ne po themi që ky nen po shkel këtë ligj, ndërsa ju thoni që jo. Ne po ju themi, me shumë qetësi, pa dashuri, se neni 2 shkel këtë ligj; neni 3... Po i marrim ligjet me radhë.

Milva Ekonomi – Ndërkohë, ju...

Albana Vokshi – Po marrim Kushtetutën e të tjerë me radhë, ndërsa ju thoni: Jo, jo, jo.

Milva Ekonomi – Jo.

Albana Vokshi – Ne po mundohemi t'ju çojmë në vijë të drejtë.

Milva Ekonomi – Ajo që ne po ju themi është se këtë ligj duhet ta lexojmë një herë në tërësi për ta kuptuar...

Albana Vokshi – E kemi lexuar, moj Milva!

Milva Ekonomi – Jo vetëm ne, jua thanë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Albana Vokshi – Dhe ato e vunë vulën, e? Hë, tani, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Jo, ata shpjeguan gjërat që ne i kishim të paqarta, madje na shpjeguan edhe historinë se si do të tjetërsohet prona.

Albana Vokshi – “Tjetërsim: vendosja në dispozicion...”

Milva Ekonomi – Po, pra, por...

Albana Vokshi – E ke e zezë mbi të bardhë.

Milva Ekonomi – Problemi është se do të duhet të zhvillosh një herë...

Albana Vokshi – “...e pronës shtetërore në shkëmbim të projektit të zhvillimit”.

Milva Ekonomi – Albana, ajo që duhet është se ky komision negocimi shikon zhvillimin e zonës. Zhvillohet zona, mendohet si do të bëhet. Kur të mendohet si do të bëhet dhe që Bashkia e Tiranës do të vërë në dispozicion kaq hapësirë për të marrë Teatrin, Ministria e Kulturës do të vërë kaq hapësirë për të marrë Teatrin, shkohet dhe merret leja për ta bërë këtë gjë nga këshilli bashkiak.

Avokatura e Shtetit cakton përfaqësuesin e saj, Ministria e Financave cakton përfaqësuesin e saj, sepse ashtu e keni në ligj, gjë të cilën e shpjegoi këtu përfaqësuesi i Ministrisë së Ekonomisë.

Tani, ne këtë pyetje e kemi bërë katër herë deri tani.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të vazhdojmë me ndonjë gjë tjetër, apo do të vazhdojmë të rrimë te kjo çështje? A do ta votojmë me votimin nën për nën me ndryshime, me riformulime, apo...

Albana Vokshi – Jemi te neni 3.

Milva Ekonomi – ...do të jemi kundër?

Albana Vokshi – Jemi ende te neni 3.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Po pra, por shkojmë te neni 3 dhe kthehemi përsëri....

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi - Por ajo që ne po themi është, se nuk mund një komision negocimi i tillë, siç është propozuar, të ketë tagrin të tjetërsojë pronën publike. Pikë mbaroi! Këtë po ju sqarojmë.

Milva Ekonomi – Po, ia ka dhënë tagrin për të bërë kontratën dhe kontrata nuk do të thotë tjetërsim prone.

Albana Vokshi – Lexoje, Milva!

“Për të vlerësuar dhe për të tjetërsuar pronën”, thuhet.

Milva Ekonomi - Edhe unë e kam lexuar

Albana Vokshi – Po si mund t’ia japësh këtë tagër?

Milva Ekonomi - Për të bërë zhvillimin, do të thotë se unë do të marr këtë sipërfaqe për të bërë këtë gjë.

Albana Vokshi - Nuk e tjetërsion dot pronën publike. Pikë!

Milva Ekonomi – Kush të tha se nuk bëhet kjo gjë? Kodi Civil ta jep këtë të drejtë.

Albana Vokshi – Jo, merreni dhe lexojeni Kodin! Lexojini ligjet!

Milva Ekonomi - Të lutem, hape Kodin Civil dhe lexoje me zë!

Albana Vokshi - Nuk lejohet. I ke dhënë tagër një komisioni nën pushtetin qendror, nën pushtetin vendor, të tjetërsojë pronën publike. Hiqeni këtë tagër, mos ia jepni këtë tagër! Nëse do, le ta analizojë projektin. Nuk mund të shkelni ju me 3 nenet e para disa ligje dhe disa nene të Kushtetutës! Po jua them një më një. Nuk mund t’ia jepni ju kompetencën për tjetërsimin e pronës locale!

E ka neni 54 i ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jorida Tabaku - Një pyetje zoti Ylli.

A ratë dakord që kjo procedurë është jashtëligjore dhe që ky nuk është një rast emergjence, që nuk e përfshin ligji për prokurimet?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, e keni shkelur Kushtetutën me të dyja këmbët.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi - Aty është shkelur neni 11, neni 13...

Jorida Tabaku - A ratë dakord që kjo është një procedurë jashtëligjore? A ratë dakord që duhet një tender i hapur ndërkombëtar?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, për çfarë po diskutoni?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Ju vendosni të votoni opsionet tuaja dhe ne do të votojmë opsionet tona. S'ka asgjë. Ne kemi seancën plenare, ku do të japim mendimet tona.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi - Po e shkelni Kushtetutën. Po shkelni nenin 11, nenin 13, nenin 113. Po i merrni kompetencat pushtetit vendor.

Milva Ekonomi – Absolutisht, nuk po marrim kompetenca.

Fadil Nasufi - Edhe një herë, është në thelb procedurë negociimi, që shprehet shumë qartë. Së pari, për statusin e pronës.

Së dyti, për unifikimin e pronave që janë aty. Këtu nuk devijohet asnjë kompetencë ligjore, as ajo e këshillit bashkiak. Personi i autorizuar, komisioni i negocimit, kur të marrë kompetenca me këtë ligj, do të shkojë në këshillin bashkiak, sepse e ka kusht nga ligji që të marrë edhe autorizimin e këshillit bashkiak. Ne këtu po hapim një procedurë.

Së treti, shprehet për ngritjen e komisionit.

Së katërti, shprehet për kompetencat e komisionit.

Albana Vokshi - Pse nuk e ke vënë që komisioni i negocimit do të shkojë në këshillin bashkiak?

Fadil Nasufi - Të lutem!

I ke të qarta.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Sigurisht.

Fadil Nasufi - Komisioni i autorizuar, kur të fillojë të shprehet për 2500 m² që është në pronësi të Bashkisë së Tiranës, do të shkojë te këshilli bashkiak, se e ka ligji. E jep me 3/5 e votave.

Albana Vokshi – Jo, nuk është kështu. Fadil, lexoje se e kupton mirë ti. Fadil, të lutem, ti e di shumë mirë, se ke qenë kryetar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fadil, lexoje, të lutem!

Fadil Nasufi – E kam lexuar. Ju në parim jeni kundër këtij ligji, që të na mbronin ne të mos vemi në burg. Ju në parim, mendoni se ne po humbasim vota me këtë ligj. Dakord. Ne do ta votojmë këtë, sepse ne kemi marrë votat për të marrë vendimin e duhur në emër të qytetarëve. Na jepni kompetencën që ta votojmë sipas Rregullores!

Albana Vokshi – Po te kartoni shkoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jorida Tabaku – Po themi të ndiqen procedurat normale të tenderimit dhe të prokurimit. Mos u bëni ju fasadë dhe komision tenderi! Po pati takat, le ta bëjë vetë kryetari i bashkisë dhe të mos t'ju përdorë juve, sepse nuk është procedurë e jashtëzakonshme. Këtë po themi ne. Ja ku është ligji, që i ka përcaktuar procedurat e jashtëzakonshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Fidel, është shkelur neni 11 dhe neni 13, që flet për pronën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Kur nuk biem dakord, hajdeni ta votojmë sipas Rregullores!

Albana Vokshi – Ajo që ne po themi është, se nuk mund të shkruash këtu që komisioni i negocimit të tjetërsojë pronën. Nuk e shkruan dot në një ligj një gjë të tillë. Nuk ia jep dot tjetërsimin e pronës me këtë ligj një komisioni negocimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e bën dot.

Fadil Nasufi – Le ta shikojmë çdo nen, çdo paragraf, zonja Albana. Do t'i shkruajmë të gjitha mendimet që kemi për çdo nen dhe për çdo paragraf.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne jemi komision që do të japim mendim. Përderisa do të japim mendim për çdo paragraf, për çdo nen dhe për çdo pikë, se edhe unë kam diku propozime, të jemi racionalë edhe në kohë, edhe në energjinë që po shpenzojmë, edhe në produktivitet. Të gjitha mendimet që keni, jepini!

Albana Vokshi - Po t'i them mendimet. Është antikushtetuese. Nuk e tjetërson dot pronën një komision negocimi. Këtë po them, sepse ty ta pengon neni 13 i Kushtetutës. Nuk ta jap këtë tagër, as ty që je deputet.

Fidel Ylli – Po kush jeni ju që dilni dhe thoni?

Albana Vokshi – Ta jep Kushtetuta.

Fidel Ylli – Po kush je ti që lexon Kushtetutën këtu?

Nuk je gjykata ti!

Albana Vokshi – Po të lexoj nenin 13 të Kushtetutës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gjykata Kushtetuese...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po ta lexoj vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Fadil Nasufi – Kryetare, do ta votojmë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli - Po na mbani kot këtu.

Albana Vokshi – Po a e përmendët vendimin e Gjykatës Kushtetuese? Ju i citoni, por i citoni gabim. Vendimi ka thënë se duhet të respektohet autonomia vendore, ndarja e pushteteve. Nuk ia merr dot ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e merr dot, se ia jep tagrin këtij komisioni. Ky komision, thuhet këtu, ka të drejtë të vlerësojë pronat dhe t'i tjetërsojë, pra bën çfarë të dojë.

Milva Ekonomi – Lexoje nenin!

Albana Vokshi – Milva, e kishe nenin dhe e hoqe me qëllim për ta shkelur...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ti po kalon një ligj me shumicë të thjeshtë dhe po shkel disa ligje me shumicë të cilësuar.

Milva Ekonomi - Neni 5, pika 1 thotë: “Komisioni i negocimit krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave, kryesohet nga përfaqësuesi i caktuar nga Bashkia e Tiranës dhe në përbërje të tij ka përfaqësues të institucioneve, ...”. Normale!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, nga bashkia e Tiranës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nora Malaj – Kisha një pyetje: Si do ta bëjë oponencën Avokati i Shtetit, duke qenë pjesë e komisionit? Kjo është shkelje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Boll tani! E meriton dashurinë, se këtu je në emër të popullit dhe jo në emrin tënd personal, sepse personalisht, nuk e di sa e meriton dashurinë. Mjaft tani!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Boll tani me histori të tilla!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, shumë gjëra janë bërë dhe po të mendoni se jeta është shumë e shkurtër, mirë është që secili nga ne të mendojë mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po. Një institucion që është i pavarur ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ti e vendos veten gjithmonë në pozicion të gabuar, sepse ti dhe unë kemi lindur në të njëjtin vend, flasim të njëjtën gjuhë, vijmë nga e njëjta origjinë dhe ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nëse ju nuk e meritoni, është e drejta juaj. Ne kemi mundësi t’ju japim me pashë, sepse jemi qytetarë, jemi shumë të dashuruar dhe japim dashuri.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A ka mundësi të jap një mendim?

Fidel Ylli – Unë të respektoj maksimalisht, por dua të them vetëm një gjë për procedurë. Ne do të flasim sa të doni ju, por nuk e pengoni dot, se nuk jemi komision përgjegjës, por jemi komision për dhënie mendimi. Çfarëdo të themi ne, ky ligj do të shkojë në parlament, sepse e ka kaluar Komisioni i Ligjeve. Tani, pse na mbani? Për të luajtur me nervat tona?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne do të rrimë dhe ju respektojmë, sepse ju kemi kolegë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Maksimalisht, por po diskutojmë në ajër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Njerëzit po na shohin dhe është turp i madh që po rrimë dhe po diskutojmë kot në ajër. Asgjë nuk kemi.

Nora Malaj – Fidel, të falënderoj shumë!

Sigurisht, ne nuk jemi komision përgjegjës, por jemi komision për dhënie mendimi. Për të shteruar të gjitha problemet tona, kur flasim për një...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Do të shkoj, por është detyra në radhë të parë. Mua nuk ma kanë dhënë votën, që të shkel Kushtetutën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nora Malaj - Mirë që na trajton Kuvendi si punonjës me orë, por të paktën edhe kur kemi vullnetin për ta thënë atë që kemi merak, nuk trajtohem as për ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kush të dojë nga pozita dhe nga opozita, mund të rrijë dhe kush të dojë mund të ikë.

Unë e di shumë mirë që ky ligj do të shkojë në parlament dhe do të votohet atje, sepse ju keni forcën e kartës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ja se çfarë kam, koleg i dashur, kam problemin e ndërgjegjes, që e kam më të madhe sesa problemin e asaj që themi, sepse kur ta shoh ndërgjegjen time në pasqyrë, nuk dua ta pështyj, por dua ta puth, siç kam bërë për të gjitha rastet, që ju i dini shumë mirë. Prandaj kjo prevalon mbi kohën dhe mbi nevojën. Dua t'i qartësoj të gjitha gjërat, megjithëse mund t'i kem totalisht të gabuara. Dua t'i sqaroj në mënyrë që edhe kolegët që janë aty, që marrin përgjegjësi ligjore, të kenë mundësi t'i rregullojnë, nëse ka vend për rregullim, që të mos ndodhë si me ligjin për arsimin e lartë dhe si historitë e tjera, miqtë e mi, që për 4 vjet nuk u bënë dot amendimet. Nuk dua të ndodhë si në historitë e tjera.

Unë po ju them thjesht 2 gjëra, që Avokati i Popullit s'mund të jetë pjesë e këtij komisioni, sepse është i pavarur. Çfarë problemi ka këtu?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Varet si i mbron, zotëri, si vendosesh ti, se pastaj je në konflikt.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Nora, meqenëse...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni!

Të qetësohemi pak!

Fakti që ka debate, do të thotë që kjo është një temë shumë e rëndësishme dhe sensitive jo vetëm për ne, por për të gjithë qytetarët.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të qetësohemi pak!

Milva Ekonomi – Edhe për procedurë, po bashkojmë dy momente. Momentin e diskutimit në parim e kaluam dje. Diskutuam dhe treguam që në parim, se duam t'i përsërisim gjërat shumë herë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet, të lutem ta mbaroj!

Tani jemi në diskutimin nen për nen. Është momenti i diskutimit nen për nen. Në nene ka gjëra konkrete dhe nuk janë më diskutime në parim, se ato kanë mbaruar. Dje ishte seanca e diskutimeve në parim. Sot kemi diskutimin nen për nen. Le t'u kthehemi diskutimeve nen për nen!

Albana Vokshi – Po, po diskutojmë nen për nen.

Nora Malaj - Këtë po them, që neni 5 duhet të rregullohet, duhet të hiqet, duhet të amendohet që të realizohet. Kaq!

Albana Vokshi – Më falni një sekondë!

E diskutuam nenin 1. Ju thamë që është në shkelje flagrante. Ju e votuat pro. Kaluam te neni 2. Ju thamë se e keni të papërcaktuar dhe bie ndesh me ligjin për mbrojtjen e monumenteve të kulturës edhe me ligjin tjetër, edhe me ligjin tjetër. Ju e votuat pro.

Kaluam te neni 3 dhe po marrim të gjitha përkufizimet një e nga një. Po ju themi se ka shkelje të Kushtetutës në këtë nen dhe në nene të tjera. Ka shkelje të ligjit për autonominë vendore dhe të ligjit për pronat. Meqenëse përmendët vendimin e Gjykatës Kushtetuese, t'jua lexoj vendimin e kësaj gjykate, sepse nuk mund t'i përmendni sa për të kaluar radhën.

Çfarë thotë jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese? “Thelbi i i nenit 13 të Kushtetutës së Shqipërisë është parimi i decentralizimit të pushtetit dhe të autonomisë vendore.” Për këtë po flasim në nenin 3, të përkufizimet.

Në të vërtetë ai që decentralizohet është ushtrimi i pushtetit në formën e ndarjes së kompetencave ndërmjet pushtetit qendror dhe vetëqeverisjes vendore, duke iu referuar rregullave të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore. Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë orientimet kryesore, që ajo përcjell te shtetet anëtare nënshkruese për një kuptim të drejtë të parimit të demokracisë dhe të decentralizimit të pushtetit.

Këtë po ju themi ne. Mos i jepni një komisioni, që ju e quani negocimi, tagrin që është i decentralizuar dhe pushteti që duhet ta ushtrojë është pushteti vendor nëpërmjet këshillit të tij bashkiak, i rregulluar me ligjin e qeverisjes vendore, neni 54, që u ...

Milva Ekonomi – Kur të arrijë komisioni në përfundim, do të shkojë në këshillin bashkiak; në këtë moment komisioni nuk kryen detyra përfundimtare.

Albana Vokshi – Milva, ia ke dhënë tagrin për të tjetërsuar pronën në nenet 3, 4, 5, ...

Milva Ekonomi – Jo. Komisioni hyn në negociata dhe përfundon në kontratë negocimi, e cila miratohet në Kuvend. Në momentin kur vjen në Kuvend, të gjitha pyetjet që bëni janë të ezauruara. Tani ne i japim tagrin e negocimit atij grupi.

Albana Vokshi – Hiqeni tagrin tjetër, pra. Këtë po themi. Jepi vetëm tagër negocimi.

Fidel Ylli – Sado që të shtyhet votimi, edhe sikur të mos votohet, nuk e pengojmë për të enjten në parlament. Prandaj, është e kotë. Sado që ne të shtyhem, se është afati 48 orë, nuk e pengojmë dot për në parlament.

Albana Vokshi – Fidel, është ...

Fidel Ylli – Nuk e pengojmë dot për në parlament.

Albana Vokshi – Ju këtë mendje keni dhe mua më vjen keq.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nen për nen po diskutojmë.

Ne po themi mos i jepni tagrin që të tjetërsojë pronat. A është nen për nen kjo? Ne po ju themi tërhiqeni, rishkruajeni dhe silleni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë po them edhe unë.

Kemi shumë vërejtje, sepse është i shkuar shumë keq. Tërhiqeni, rishkruajeni dhe silleni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Ismet, kanë relatorin e tyre këta. Nuk ka nevojë ...

Nora Malaj - Kryetari i komisionit, pasi bën diskutimin dhe shikon që nen për nen ka probleme, ka tagrin e tij që t'ia çojë ministrit përkatës. E ka Kushtetuta. T'i thotë, për 1, 2, 3, 4 gjëra, mbështetur mbi disa argumente, silleni të riformuluar dhe e kalojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli - Hidheni në votë propozimin dhe e votojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nora Malaj - Unë e hedh në votë këtë propozim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nora Malaj – Zonja kryetare, në kuadër të diskutimit të djeshëm dhe atij të sotëm, bashkëbisedimit që bëmë me ministren, e cila nuk arriti ta shteronte dhe ta bënte të qartë të gjithë këtë ligj, duke pasur parasysh që edhe përfaqësuesit, me gjithë dëshirën e mirë të tyre për të realizuar, vërejnë që ka shumë probleme që do ta bëjnë të vështirë dhe për të shkuar te amendimet, t'i japim propozimin dhe shansin ministrisë përkatëse ta rishikojë mbi vërejtjet tona, duke filluar nga neni i parë, objekti, që e hedh poshtë pastaj gjithë veprimtarinë dhe ta risjellin javën tjetër në parlament me procedurë të përshpejtuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Edhe unë jam shumë dakord që të rishkruhet dhe ta sjellin nesër që në mëngjes. A jeni dakord, Milva? Ta rishkruajmë, sepse ka probleme të mëdha.

Fidel Ylli - Hidhe në votim, sepse po regjistrohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ne kemi nevojë të votojmë.

Albana Vokshi – Nuk ke konsensus për ta rishkruar?

Milva Ekonomi – Jo!

Albana Vokshi - Kush është dakord që të riformulohet, sepse është shkruar shumë keq, jashtë teknikës legislative, që cenon ?...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka konsensus nënkryetarja.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva, je apo jo dakord?

Milva Ekonomi – Jo!

Albana Vokshi - Milva nuk do që të ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – I gjithë grupi kemi një mendim.

Nora Malaj - ... dhe nuk e dinë çfarë është ndjeshmëria e kulturës. Pastaj do të dalim të gjithë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, këtu ka intelektualë që dalin edhe mbi disiplinën partiake, për këtë jam e bindur, por ndoshta në këto momente mendojnë...

Almira Xhembulla – Në respekt të interesit të publikut, sensitivitetit të çështjes dhe të disa diskutimeve që u mbajtën këtu, mendoj që, për të gjitha arsyet që lidhen qoftë me procedurën, qoftë me etikën e funksionimit normal të një komisioni, pavarësisht si po shkon diskutimi, duhet të biem dakord, siç ndodh gjithmonë në procedurat normale të projektligjeve. Pavarësisht se ky projektligj ka ardhur me procedurë të përshpejtuar, kjo është shumë e qartë, nuk besoj që këtu ka ndonjë axhendë të fshehur në aspektin që është e shkruar dhe është një praktikë që ndodh për herë të parë në këto 26 vjet demokraci parlamentare. Kështu që, në këtë aspekt, duke iu referuar fjalës së Norës, këtu ka njerëz, që mbase nuk kanë aq eksperiencë direkt me monumentet e kulturës, por që kanë ndjeshmëri ndaj çështjes së Teatrit, kjo nuk ka asnjëllë diskutimi.

Ne nuk jemi aq aktivë në dhënien e argumenteve, sepse mendojmë që energjitë tona nuk duhet t'i shfrytëzojmë në momentin kur ky është një projektligj thjesht për hapjen e procedurave, por do t'i japim të gjitha argumentet tona si grup parlamentar në momentin kur do të vendoset dhe të jemi të gjithë të qartë për mënyrën se si do të vepohet dhe çfarë do të kemi konkretisht në tryezën e diskutimit. Kjo do të jetë një procedurë për të cilën ne do të kërkojmë transparencë që në hapin e parë.

Kështu që, në këtë moment, kryetare, kërkoj që të vazhdojmë siç kemi vazhduar gjithmonë me diskutimin nen për nen.

Abana Vokshi – Çfarë transparence po kërkon sot, Almira? Sot u kemi kërkuar projektin dhe s'e kanë sjellë, u kemi kërkuar informacionin, nuk e kanë sjellë. Çfarë transparence po i bën ti sot publikut?! Ia kemi kërkuar pesë muaj me radhë!

Almira Xhembulla – Për këtë që po thua, t'u dha përgjigjja nga përfaqësuesi i ministrisë.

Albana Vokshi – Ku ishte përgjigjja? A bëre transparencën sot, sepse e kishe për detyrë.

Almira Xhembulla – Çdo transparencë deri në këtë hap është e shkruar qoftë në projektligj, qoftë në relacionin shoqërues.

Albana Vokshi – Deri në këtë moment, Almira, kam kërkuar projektin ...

Almira Xhembulla – Kryetare, ju që keni eksperiencë me mënyrën se si funksionojnë axhendat e fshehura, ndoshta vini me atë paragjykim. Ne kemi përpara projektligjin, për të cilin ju thatë që është në shkelje të Kushtetutës. Ne si komision nuk biem dakord, sepse e dimë që gjithçka është e mbështetur në Kushtetutë, që në momentin që është hartuar projektligji. Kështu që, në këtë aspekt, besoj se jemi të gjithë të qartë. Duhet të vazhdojmë siç kemi vazhduar me çdo projektligj në procesin e diskutimit nën për nën. Kjo në respekt të gjithë atyre që na dëgjojnë.

Albana Vokshi – Në 27 vjet, ky parlament nuk ka kaluar ndonjëherë ndonjë projektligj si ky. Për këtë të siguroj. Gjithashtu, të siguroj që në të gjithë botën projektligj si ky nuk ka ardhur. Një projektligj që shkel në çdo germë Kushtetutën, nuk ka ardhur dhe s'ka për të ardhur ndonjëherë! Po marrim kaq shumë kohë për t'ju bindur juve të tërhiqeni, sepse nuk duhet ta votoni. Ne po ju kërkojmë të mos lejoni që të shkelet që në germën e parë. Që në nenin e parë ju keni shkelur një sërë ligjesh. Rishkruajeni dhe silleni. Çdo germë dhe nen i këtij ligji shkel Kushtetutën. Këtë po ju themi. Ky projektligj cenon legjislacionin në fuqi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk duan, Jorida.

Valentina Duka – Të më falë Nora, por unë në mënyrë kategorike jam kundër risjelljes, jo vetëm të ligjit që ka ardhur, të një ligji të ri, sepse personalisht, edhe në emër të opozitës dhe të Partisë Demokratike, jam për ruajtjen e godinës së Teatrit. Nëse godina e Teatrit do të ruhet, qeveria me para publike të bëjë rivitalizimin e saj.

Duke udhëtuar çdo javë në rrugën Korçë - Pogradec kam parë dy bunkerë të ndërtuar nga francezët që në kohën e Luftës së Parë Botërore. Për të ruajtur ata dy bunkerë është trefishuar kostoja e rrugës. Pse nuk është e njëjta qasje me Teatrin Kombëtar? Sepse te bunkerët nuk kanë mundësi të ndërtojnë kulla, kurse këtu duan të prishin Teatrin për të ndërtuar kulla. Pra, projekti, që kërkon tjetërsimin e pronës, jo vetëm shkatërron trashëgiminë tonë historike, por ndërkohë është një projekt totalisht korruptiv. Kështu që, ne nuk jemi për ardhjen e një ligji të ri, por për rivitalizimin e Teatrit me para publike.

Faleminderit!

Fidel Ylli – Sa për informacion Vali, Komisioni i Ligjeve, ku ju keni disa juristë të nderuar, e ka certifikuar brenda rregullave kushtetuese.

Albana Vokshi – Ju e keni certifikuar, jo ne.

Fidel Ylli – Zonjë, demokracia është shumicë. Pse nuk e votoni ju, nuk është në rregull me Kushtetutën?!

Valentina Duka – Unë fola në emrin tim dhe të opozitës, jo tuajin.

Albana Vokshi – Nuk e vidhni dot popullin në emër të popullit.

Fidel Ylli – Janë bërë debate dhe është brenda Kushtetutës. Nuk ka shkelje ligjore. Nëse do të ecim me institucione, mirë, në qoftë se do të ecim me ..

Në drekë, kur ministria nuk ishte prezente me zëvendësministrin, unë isha dakord me ju dhe bashkë me anëtarët e komisionit thamë që duhet të vij zëvendësministri, një përfaqësues zyrtar i ministrisë. Nuk treguam dhunë për ta kaluar se ikët ju, sepse i kishim votat.

Albana Vokshi – Nuk e bën dot.

Fidel Ylli - Erdhi zëvendësministri. Ne u treguam të përgjegjshëm dhe erdhëm këtu. Ju doni përgjigjet tuaja, ai u përgjigj sipas ligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Fidel, e keni përmendur punën e kartonëve qindra herë vetëm sot. Harrojeni që në emër të popullit do vidhni popullin dhe pronën publike! Nuk e kaloni dot kaq kollaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si mund të thoni që mua më ka votuar populli dhe në emër të tij unë do ta vjedh?!

Bujar Çelaj – Albana, e dini që ka një Komision Ligjesh?

Albana Vokshi – Nuk jua kanë dhënë votën që ju të shkatërroni çdo gjë dhe të vidhni sheshin e Tiranës.

Bujar Çela – Kryetare, kjo që po thoni ju do të bëhet për një sekondë.

Albana Vokshi – Edhe në Komisionin e Ligjeve po ju e keni votuar.

Bujar Çelaj - Komisioni i Ligjeve, që shikon anën ligjore, e ka votuar dhe certifikuar që nuk është në kundërshtim me Kushtetutën.

Albana Vokshi – E certifikon Gjykata Kushtetuese.

Ju nuk e keni lënë as Gjykatën Kushtetuese. Keni shkatërruar gjithçka. Ne po ju kërkojmë që ta rishkruani ...

Ismet Beqiraj – Për Gjykatën Kushtetuese ju vjen keq, sepse u bë vetingu? Për këtë ju vjen keq?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Mos iu fut vetingut, të lutem.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Të nderuar kolegë, ju bëj thirrje të ...

Ismet, ti mos fol për vetingun.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të nderuar kolegë të maxhorancës, ju bëj thirrje ta rishkruani dhe silleni, sepse neni 1 bie ndesh me legjislationin, neni 2 ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Me shumicë votash e kaluat, por është në kundërshtim me ligjin dhe Kushtetutën. Neni 3 bie ndesh me Kushtetutën, neni 4 bie ndesh me Kushtetutën, neni 5 bie ndesh me një sërë ligjesh dhe me Kushtetutën, neni 6 bie ndesh me Kushtetutën. Është vjedhje. Mos u bëni palë, por tërhiqeni. Po ju ofrojmë mundësinë ta rishkruani dhe nesër vijmë ... Mos u bëni palë, por tërhiqeni, sepse është vjedhje e madhe.

Milva Ekonomi – Do ta hedhim në votë. Ne nuk jemi gati ta rishkruajmë.

Bujar Çela – Kryetare, unë kam një pyetje: mos keni ngrënë gjë drekë ju dhe doni të na lodhni ne? Ne nuk kemi agjëruar, do ta bëjmë këtë muaj.

Albana Vokshi – Tërhiqni ligjin, mos e çoni deri në fund, sepse është pazar i madh. Ju mos u bëni palë. Tërhiqeni, sepse është i tmerrshëm. Është antikushtetues.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju nuk po pranoni asgjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Çfarë të hedh në votim?

Vilma Bello - Ligjin nen për nen.

Albana Vokshi – Jeni dakord që komisionit të negocimit t'i hiqni tagrin i tjetërsimit të pronës, që kryetarit të bashkisë t'i hiqet tagri i negocimit?

Fidel Ylli – Nuk jemi dakord.

Albana Vokshi – A jeni dakord që të mos i marrë ky komision negocimi ...?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Juve ju ka mbyllur sytë dhe veshët Edi Rama. Mua më vjen keq!

Fidel Ylli – Na i ka mbyllur Edi Rama sytë, veshët, mendjen.

Albana Vokshi - Ne mendojmë që ju ta ktheni ligjin dhe ta rishkruani, kurse ju nuk jeni dakord. Vazhdoni vetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është e turpshme kjo që po bëni. Sporti, arti, kultura, çfarë po votoni? Jeni lindur dhe rritur në Tiranë. Çfarë po votoni? Kemi 5 orë që mundohemi t’ju bindim.

Fidel Ylli - Është brenda çdo procedure.

(Opozita largohet nga mbledhja.)

Milva Ekonomi – Kolegë, mbani qetësi!

Bujar, Adelina, Fadil, Ismet, Nora, Vilma, Musa, Fidel, Fate, Almira nuk do të flisni?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne diskutuam projektligjin “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës, me objekt projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”. Ndërkohë, kemi diskutuar nenet 1, 2, 3 dhe i kemi votuar ato nene.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të hedh nenin 3 në votë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Neni 3: Përkufizime.

Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Neni 4: Pronat me pronësi shtet dhe statusi i tyre.

Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet.

Neni 5: Përbërja e komisionit të negocimit.

Pro? 10. Kundër? 1. Abstenim? 0. Miratohet.

Neni 6: Kompetencat e komisionit të negocimit.

Pro? 10. Kundër? 1. Abstenim? 0. Miratohet.

Neni 7: Procedura e negocimit për lidhjen e kontratës.

Pro? 10. Kundër? 1. Abstenim? 0. Miratohet.

Neni 8: Kontrata dhe përmbajtja e saj.

Pro? 10. Kundër? 1. Abstenim? 0. Miratohet.

Neni 9: Nënshkrimi i kontratës.

Pro? 10. Kundër? 1. Abstenim? 0. Miratohet.

Neni 10: Miratimi i kontratës.

Pro? 10. Kundër? 1. Abstenim? 0. Miratohet.

Neni 11: Nxjerrja e akteve nënligjore.

Pro? 10. Kundër? 1. Abstenim? 0. Miratohet.

Neni 12: Hyrja në fuqi.

Pro? 10. Kundër? 1. Abstenim? 0. Miratohet.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës, me objekt projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”?

Pro? 10. Kundër? 1. Abstenim? 0. Miratohet.

Dy gjëra duhet të mbajmë shënim nga kjo mbledhje. Ne, grupi i deputetëve socialistë, kemi caktuar me konsensus brenda nesh relatorin tonë për këtë projektligj, që është zoti Fadil Nasufi. Natyrisht, nuk është e hijshme që opozita nuk është e pranishme në momentin e votimit, por, në fakt, ne, deri tani bëmë përpjekjet maksimale për të qenë bashkë për të diskutuar për mendimin kundër dhe për mendimin pro.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në një farë mënyre ata e dhanë mendimin e tyre kundër që në fillim të seancës.

Kolegë, shumë faleminderit! Punë të mbarë në seancë për këtë projektligj!

Fadil, të lutem, do të punojmë bashkë për të bërë gati sot të gjithë relacionin për këtë projektligj.

MBYLLET MBLEDHJA

